

STANDARDET E TË NXËNIT DHE ARRITJEVE

1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

STANDARDET E TË NXËNIT DHE ARRITJEVE

1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar

Nr. 3186 Prot.

Tiranë, më 17 6 2013



MIRATOHET:

MINISTRI

Myqerem Tafa
MYQEREM TAJ

STANDARDET E TË NXËNIT

Tiranë, 2013



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

STANDARDET E TË NXËNIT DHE ARRITJEVE

1

Tirane, 2012

Standardet e të nxënit dhe të arritjes për arsimin bazë janë përgatitur nën kujdesin e IZHA, në bashkëautorësi me anëtarët e:

- Grupit të punës për rishikimin e kurrikulës në arsimin bazë.
- Grupeve lëndore të punës për rishikimin e kurrikulës në arsimin bazë.
- Grupeve mbështetëse të punës për rishikimin e kurrikulës në arsimin bazë.

© *Instituti i Zhvillimit të Arsimit*



Instituti i Zhvillimit të Arsimit

Rr: “Naim Frashëri” Nr.37, Tiranë - Shqipëri

Tel: +355 4 22 56 440 / 22 56 441.

Fax: +355 4 22 56 441

E-mail: sekretaria@izha.edu.al

<http://www.izha.edu.al>

Treguesi i lëndës

STANDARDET E TË NXËNIT

HYRJE	7
GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI	11
GJUHË E HUAJ	17
SHKENCA SHOQËRORE	25
EDUKIM PËR SIPËRMARRJEN	37
ARTE	41

STANDARDET E ARRITJEVE

PARATHËNIE	51
GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI	55
GJUHË E HUAJ	101
SHKENCA SHOQËRORE	111
EDUKIM PËR SIPËRMARRJEN	191
ARTE	211

STANDARDET E TË NXËNIT

HYRJE

Standardi përbën një sistem kërkesash ose parametrash të pranuar si normë shtetërore për arsimin në sektorë të ndryshëm.

Standardi krijon një marrëdhënie të caktuar ndërmjet shtetit dhe shoqërisë. Marrëdhënia është e bazuar në realizimin e politikës në fushën e arsimit dhe përmban në vetvete pranimin dhe zbatimin e detyrimit reciprok.

Standardet e të nxënit përcaktojnë çfarë duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit në fushën e njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve, pasi të kenë mbaruar një nivel (cikël) të caktuar shkollimi. Dokumenti i standardeve të të nxënit shoqërohet plotësohet edhe me nivelet e arritjes së nxënësve në përfundim të klasës së 6-të dhe në përfundim të klasës së 9-të.

Reforma e sistemit arsimor në tërësi dhe reforma e arsimit bazë në mënyrë të veçantë synon të sjellë ndryshime cilësore e të qëndrueshme, që të përfshijnë e të lëvizin sistemin në tërë gjerësinë dhe thellësinë e tij.

Ndryshimi i strukturës së arsimit bazë (1-6 dhe 7-9):

- nevoja për rritjen e efektivitetit të brendshëm dhe të jashtëm të sistemit arsimor;
- nevoja për të siguruar dhe për të rritur në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e shërbimit arsimor;
- nevoja për të mbikqyrur dhe për të vlerësuar cilësinë e arsimit;
- akreditimi dhe integrimi i arsimit shqiptar në familjen evropiane etj.

kërkojnë si domosdoshmëri, përveç të tjerash, edhe rishikimin e **standardeve të të nxënit**. Rishikimi i standardeve të të nxënit është një ndër objektivat më të rëndësishëm të reformës aktuale të arsimit bazë në Shqipëri.

Standardi **njëson pikat e referencës** për zhvillimin dhe vlerësimin e të gjithë sistemit arsimor, si dhe të marrëdhënieve të tij me shtetin dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi, veçanërisht në kushtet e *ritmeve dhe të përmasave të ndryshme të zhvillimeve që kanë pjesët e veçanta të sistemit arsimor, veçanërisht në vendin tonë.*

Standardet, nga vetë natyra e tyre, synojnë të vendosin një raport optimal ndërmjet objektivave të zyrtarizuar, të vendosur nga lart dhe hapësirës e fleksibilitetit që duhet të kenë faktorët e tjerë, që do t'i zbatojnë ato në kushtet e rrethanat e larmishme lokale.

Hartimi i standardeve të rishikuara) në nivel strategjik dhe afatgjatë:

- synon sigurimin dhe rritjen e cilësisë së tërë sistemit arsimor shqiptar, vënien e tij në funksion të kërkesave të reja aktuale dhe perspektive të shoqërisë, si dhe integrimin e tij në sistemet arsimore të vendeve të zhvilluara demokratike;
- krijon mundësinë e përcaktimit të cilësisë së sistemit arsimor, të monitorimit, të verifikimit dhe të vlerësimit të përmbajtjes së tij nga shoqëria dhe shteti;
- krijon dhe do siguron sistemin e referimit për ndryshimet graduale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në arsim;
- rrit shkallën e vlefshmërisë dhe të përdorimit të rrjedhëve të vlerësimit të sistemit arsimor.

Në këtë mënyrë, standardet, sidomos pjesa e niveleve të arritjes ofrojnë *kritere të njësuar* për vlerësimin e njohurive, të shkathtësive e shprehive të nxënësve, si dhe kritere të hollësishme për vlerësimin e nivelit të realizimit të objektivave. Ato mundësojnë edhe sigurimin e të dhënave më të plota e më të besueshme për vlerësimin dhe përmirësimin e të gjithë sistemit në tërësi.

Hartimi i standardeve është mbështetur në përvojën dhe traditën tonë më pozitive. Ato, në të njëjtën kohë, reflektojnë edhe përvojën bashkëkohore.

Hartimi i tyre është ndihmesë e rëndësishme për përcaktimin e *linjave themelore* të asaj se çfarë duhet të mësojnë dhe për çfarë duhet të jenë të aftë nxënësit në fushën përkatëse të dijes. Ato ndihmojnë shoqërinë të *njësiojë objektivat* në secilën fushë, duke siguruar drejtimin e duhur të organizimit të vetë procesit të të nxënësve dhe të mësimdhënies.

Standardet nuk janë konceptuar si statike dhe të pandryshueshme. Duke mbajtur vulën e kohës, ato mbartin, njëkohësisht, edhe mundësinë e ndryshimeve që vetë realiteti dhe shkolla diktojnë me dinamizmin e tyre.

Standardet në vetvete nuk mund të përmirësojnë në mënyrë mekanike arritjet e nxënësve ose të shkollës. Për të arritur këto standarde, nxënësve dhe shkollave duhet t'u sigurohen mundësi të tilla që nxënësit, nëpërmjet mësimin dhe aktiviteteve shkollore, të fitojnë njohuritë e domosdoshme dhe të formojnë shkathtësitë, shprehjet dhe qëndrimet e duhura për jetën, shkollimin e mëtejshëm, punën dhe pjesëmarrjen qytetare.

Standardet janë ndërtuar **në bazë ciklesh shkollimi**, pra ato përcaktojnë në mënyrë sintetike çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit në fund të klasës së nëntë.

Kjo zgjedhje lidhet me fleksibilitetin dhe hapësirat që standardet duhet t'u lejojnë përdoruesve të tyre në bazë të kërkesave të kohës dhe të hapësirës së zbatimit të tyre. Kjo zgjidhje u mendua e mjaftueshme për të njësuar arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, nga njëra anë, dhe për të krijuar fleksibilitetin e lejuar dhe të domosdoshëm, nga ana tjetër. Në këtë mënyrë, standardi shfaqet aq i përcaktuar, sa ta drejtojë procesin e edukimit drejt një objekti të qartë dhe aq i përgjithshëm dhe i pa përcaktuar, sa të mos cenojë larminë dhe gjerësinë e këtij procesi.

Kur flasim për standarde për nxënësin, në të vërtetë kemi parasysh *njohuritë, shkathtësitë e shprehjetë dhe qëndrimet* me të cilat ai duhet t'i zotërojë në nivele të ndryshme shkollimi.

Në zgjedhjen e njohurive standard në këtë draft kemi bërë kujdes që ato:

- të jenë në funksion të realizimit të qëllimeve kombëtare të arsimit;
- të burojnë nga kërkesat e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar;
- të jenë në funksion të synimeve të përgjithshme të lëndës;
- të jenë në përputhje me moshën;
- të marrin parasysh përvojat personale të nxënësve;
- të marrin parasysh dijet që nxënësit marrin nga lëndët e tjera.

Standardet janë organizuar në disa **linja kryesore**. Kjo u krijon hapësira përdoruesve të zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë e shprehjetë që duhet të zotërohen në varësi të kërkesave, në ndryshim, të jetës, të arsimimit të mëtejshëm e të punës.

Linjat përcillen te nxënësi në përputhje me nivelet e shkollimit, veçoritë specifike të nxënësve dhe kushtet në të cilat funksionon shkolla, duke krijuar mundësinë për lidhje ose integrim me lëndë të tjera.

Kjo zgjidhje, ndër të tjera, është bërë:

- për të krijuar fleksibilitet në arritjen e standardeve;
- për të krijuar hapësirat e domosdoshme për trajtimin e problemeve ekzistuese dhe të reja, që mund të përfshihen në to, sipas niveleve dhe viteve.

Standardet e të nxënit u ofrojnë jo vetëm shkollës, por të gjithë punonjësve të arsimit, vendimmarrësve, prindërve etj. elemente të rëndësishme për zhvillimin e arsimit.

Ato mund të përdoren:

nga vendimmarrësit në fushën e arsimit:

- për të parashikuar dhe për të projektuar ndryshimet në arsim;
- për të rishikuar dhe për të vlerësuar kurrikulën ekzistuese shtetërore;
- për të vlerësuar arritjet në nivel kombëtar.

nga pushteti lokal dhe shkollat:

- për të qenë bashkautorë në hartimin e kurrikulës dhe të programeve lëndore, në kuadrin e detajimeve dhe plotësimeve të tyre, sipas veçorive lokale;
- për të rishikuar dhe vlerësuar programet lëndore dhe veprimtaritë shkollore në përgjithësi;
- për të ofruar ide dhe alternativa zgjidhjesh për procesin e të mësuarit dhe të vlerësimit.

nga mësuesit:

- për të përcaktuar synimet dhe objektivat e orës së mësimit, të temës (kapitullit) ose të lëndës;
- për të unifikuar kriteret dhe nivelet e vlerësimit të nxënësve;
- për të vlerësuar praktikën e të mësuarit në shkollë e jashtë saj;
- për të zhvilluar ide për procesin e të mësuarit dhe të vlerësimit.

nga prindërit dhe anëtarët e komunitetit:

- për të kuptuar ndihmesën e lëndëve në realizimin e qëllimeve të përgjithshme të shkollimit;
- për të vlerësuar cilësinë e edukimit në shkollë e në nivel lokal;
- për të gjykuar për zhvillimin e fëmijëve të tyre në fushën përkatëse të njohurive, shkathtësive e shprehive.

nga trajnuesit:

- për të planifikuar, drejtuar, zhvilluar dhe vlerësuar veprimtaritë për trajnimin e studentëve dhe të mësuesve në shërbim.

STANDARDET E TË NXËNIT

Fusha:

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koordinatorë:

Erida KOLECI

Grupi i punës:

Ardian MARASHI

Alfred MULLA

Aljula JUBANI

Dhurata SHEHRI

Enkelejda KAPIA

Lindita AGURIDHI

Erida KOLECI

1. HYRJE

Zhvillimi gjuhësor dhe letrar është themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësve. Standardet e kësaj fushe synojnë aftësimin e nxënësve në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tyre personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës. Standardet tregojnë se çfarë nxënësit dinë dhe janë në gjendje të bëjnë në fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.

Arritjet e nxënësve në gjuhë shqipe dhe letërsi janë përcaktuese edhe për fushat e tjera të kurrikulës, pasi mësimi i gjuhës dhe letërsisë i aftëson nxënësit në përdorimin korrekt të gjuhës së folur dhe të shkruar, i domosdoshëm për të gjitha lëndët mësimore.

Fusha e gjuhës shqipe dhe e letërsisë synon që nxënësit:

- të zhvillojnë aftësitë për të lexuar, për të shkruar, për të folur dhe për të dëgjuar në mënyrë aktive tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe të kultivojnë nëpërmjet tyre mendimin kritik e krijues;
- të gjejnë, të krahasojnë, të analizojnë, të interpretojnë e të vlerësojnë informacione nga tekste të ndryshme, t'i përshtatin ato me qëllime dhe audienca të caktuara, si dhe t'i integrojnë ato me përvojat e tyre;
- të demonstrojnë kompetencat e tyre gjuhësore dhe letrare, për të marrë pjesë efektivisht në jetën e përditshme;
- të zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e të lexuarit për t'u bërë përdorues të pavarur dhe aktivë të gjuhës përgjatë gjithë jetës;
- të çmojnë dhe vlerësojnë letërsinë kombëtare e botërore, duke respektuar e mbrojtur identitetin kombëtar dhe duke vlerësuar

larminë kulturore, nëpërmjet studimit të veprave të shkrimtarëve, përfaqësues të periudhave të ndryshme të letërsisë shqiptare dhe botërore.

Standardet për fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë janë organizuar sipas linjave. Standardet e katër linjave të para u adresohen të dyja lëndëve të fushës. Më pas vijojnë standardet sipas lëndëve, pra të Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë.

Standardet e përbashkëta të fushës janë organizuar sipas linjave të mëposhtme:

- Të folurit
- Të dëgjuarit
- Të lexuarit
- Të shkruarit

Standardet e gjuhës shqipe janë organizuar në linjën:

- Njohuri rreth sistemit gjuhësor

Standardet e letërsisë janë organizuar sipas linjave të mëposhtme:

- Kuptimi, interpretimi, vlerësimi dhe reflektimi ndaj një teksti letrar.
- Gjinitë dhe llojet e ndryshme të tekstit letrar.

2. STANDARDET SIPAS LINJAVE

LINJA: Të folurit

Standardet

- Nxënësit flasin qartë, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, si dhe përshtasin të folurit në varësi të dëgjuesit, situatës dhe qëllimit që kanë.
- Nxënësit planifikojnë dhe paraqesin ide dhe informacione për qëllime të ndryshme, duke pranuar e respektuar edhe idetë dhe pikëpamjet e të tjerëve.

- Nxënësit flasin në mjedise të ndryshme komunikimi, në grupe të vogla, në grupe të gjera dhe në publik, si dhe ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi dhe ndërveprimi me të tjerët.
- Nxënësit përdorin njohuritë gjuhësore gjatë të folurit si edhe elementet joverbale (gjestet, mimikën, kontaktin me sy) për të komunikuar në mënyrë të efektshme.

LINJA: Të dëgjuarit

Standardet

- Nxënësit janë dëgjues aktivë në grupe formale dhe joformale, për të marrë informacion nga një shumëllojshmëri burimesh, në situata të ndryshme.
- Nxënësit shfaqin qëndrime dhe sjellje pozitive gjatë të dëgjuarit duke treguar vëmendje, respekt dhe mirëkuptim ndaj folësit ose ndaj teksteve që dëgjojnë në media të ndryshme.
- Nxënësit kuptojnë dhe vlerësojnë tekstin që dëgjojnë.

LINJA: Të lexuarit

Standardet

- Nxënësit zbatojnë njohuritë për shkronjat, tingujt, fjalët, fjalitë dhe tekstin për të lexuar në mënyrë të pavarur, për të marrë informacion dhe për kënaqësi estetike.
- Nxënësit përdorin strategjitë e të lexuarit për të marrë, kuptuar, interpretuar, vlerësuar dhe gjykuar në mënyrë kritike informacionin e duhur.
- Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore.
- Nxënësit dallojnë karakteristikat dhe elementet stilistike të teksteve si dhe sqarojnë funksionet e tyre.

LINJA: Të shkruarit.

Standardet

- Nxënësit mbledhin dhe përzgjedhin ide dhe informacione nga burime të ndryshme, për të shkruar për qëllime, lexues dhe kontekste të ndryshme.

- Nxënësit zhvillojnë punë me shkrim koherente dhe të mirëstrukturuara.
- Nxënësit rishikojnë dhe përmirësojnë punët e tyre me shkrim duke rregulluar gabimet drejtshkrimore, duke përmirësuar shprehjen dhe duke rishikuar strukturën dhe gjatësinë e fjalive.
- Nxënësit shkruajnë duke përdorur forma të ndryshme në varësi të qëllimit që kanë dhe lexuesve që iu drejtohen.
- Nxënësit përdorin mënyra e forma të ndryshme për prezantimin e punëve me shkrim, duke përfshirë edhe elemente të TIK-ut.

GJUHË SHQIPE

LINJA: Njohuri rreth sistemit gjuhësor

Standardet

- Nxënësit dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin trajtën e duhur gjatë komunikimit.
- Nxënësit dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në përdorimin korrekt të gjuhës së folur dhe të shkruar.
- Nxënësit përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet e pjesë të tjera të leksikut të gjuhës shqipe dhe respektojnë diversitetin gjuhësor.
- Nxënësit dallojnë mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.
- Nxënësit demostrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime rreth rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

LETËRSI

LINJA: Kuptimi, interpretimi, vlerësimi dhe reflektimi ndaj një teksti letrar

Standardet

- Nxënësit lexojnë krijimtarinë e disa autorëve klasikë, përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe e letërsia botërore.
- Nxënësit kuptojnë, interpretojnë, analizojnë, reflektojnë dhe vlerësojnë tekste letrare, të gjinive e llojeve të ndryshme.

- Nxënësit shprehin mendimet e tyre për subjektin, fabulën, personazhet, mjedisin, gjuhën, tematikën, stilin e një teksti letrar.

LINJA: Gjinitë dhe llojet e ndryshme të tekstit letrar*Standardet*

- Nxënësit dallojnë tiparet specifike të tre formave kryesore të tekstit letrar: tekst poetik, tekst në prozë e tekst dramatik dhe sqarojnë funksionet e këtyre tipareve.
- Nxënësit krahasojnë tekste që u përkasin gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.
- Nxënësit veçojnë dhe përdorin lidhjet e letërsisë me gjuhën dhe artet e tjera.

STANDARDET E TË NXËNIT

Fusha:

GJUHË E HUAJ

Koordinatorë:

Erifili HASHORVA

Grupi i punës:

Gëzim HADAJ

Tidita ABDURRAHMANI

Edmond TUPJA

Klodeta DIBRA

Albana BEJA

Erifili HASHORVA

Fatbardha LOLJA

Shpresa DELIJA

Fozi SIMONI

Admir KRAJA

I. HYRJE

Standardet e të nxënit, si një instrument matës për nivelin e përvetësimit të gjuhëve të huaja, përbëjnë një element shumë të domosdoshëm, që ndikon drejtpërdrejtë në përmirësimin e procesit të mësimi.

Standardet synojnë:

- rritjen e shkallës së përvetësimit të njohurive në gjuhë të huaj nga nxënësi;
- rritjen e përgjegjësisë së mësuesve për një mësimdhënie cilësore;
- ndërgjegjësimin e institucioneve arsimore dhe të aktorëve të tjerë që lidhen me këtë proces.

Standardet u japin mësuesve një mënyrë për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në të katër linjat e mësimi të gjuhës së huaj: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit. Përvetësimi i gjuhëve të huaja bazohet në krijimin e aftësive të qëndrueshme komunikative dhe të njohurive kulturore.

Të mësuarit me shkrim dhe me gojë i gjuhëve të huaja i aftëson nxënësit:

- të përvetësojnë informacionin dhe të njohin pikëpamje të tjera, të mundësuar vetëm me anë të gjuhës së huaj dhe të kulturës së dhënë nëpërmjet saj;
- të kuptojnë natyrën jo vetëm të gjuhës së huaj, por edhe të gjuhës amtare;
- të realizojnë lidhje të gjuhës së huaj me lëndët e tjera, si: Artet, Matematika, Historia, Gjeografia etj.

Përfundimet e të mësuarit përshkruajnë gjithçka që nxënësit mendohet se do të arrijnë në lëndë dhe në klasa të ndryshme. Ato quhen ndryshe edhe *përfundime të përmbytjes*. Standardet e të nxënit i përgjigjen pyetjes: “Çfarë njohurish, aftësish dhe shprehish pritet që nxënësi të arrijë në këtë klasë dhe nivel të caktuar?”

Të mësuarit e një gjuhe të huaj është njëkohësisht edhe njohje e kulturës së popullit që e ka atë gjuhë amtare. Ndërsa zhvillojnë aftësitë e përdorimit të gjuhës së huaj, nxënësit aftësohen gjithashtu në përdorimin e njohurive rreth kulturës dhe qytetërimit të popullit, gjuhën e të cilit mësojnë. Ndërgjegjësimi qoftë për dallimet, ashtu edhe për ngjashmëritë ndërmjet kulturës kombëtare dhe kulturës së popullit, gjuhën e të cilit nxënësi mëson, është i rëndësishëm për zhvillimin e personalitetit të nxënësit. Për t'u familiarizuar me të panjohurën duhet të komunikosh me tjetrin; kjo kërkon dëshirë për ndryshime vetjake, si dhe kapërcimin e paragjykimeve dhe stereotipave. Që nxënësit të arrijnë standardin e duhur kulturor, duhet:

- të demonstrojnë njohuri të aspekteve të kulturës së popullit gjuhën e të cilit mëson në lidhje me jetën e përditshme, arsimin, historinë, gjeografinë, shtetin, ekonominë, artin etj.;
- të tregojnë njohuri të kulturës praktike, kur komunikon në gjuhë të huaj;
- të përdorin gjuhën e huaj për të marrë informacionin e mundshëm kulturor në atë gjuhë.

2. ORGANIZIMI I STANDARDEVE TË FUSHËS

2.1. STANDARDET E KLASAVE III - VI

2.1.1. Të dëgjuarit

Nxënësit në përfundim të klasës VI duhet të jenë të aftë:

- t'u përgjigjen orientimeve dhe urdhrave të mësuesit, të shqiptuara me një shpejtësi pothuajse normale, duke reaguar ose vepruar;
- të dëgjojnë dhe të kuptojnë fraza të thjeshta, të shqiptuara qartë dhe ngadalë;
- të kuptojnë rrëfime të thjeshta, të bazuara mbi figura (mjete vizuale);
- të dallojnë saktë një objekt ose një cilësi kur fjalitë vështirësohen;
- të tregojnë objektet kur dëgjojnë emrin e tyre;
- të kuptojnë dhe të reagojnë ndaj komandave dhe mesazheve të tjera, të kuptojnë ose të marrin pjesë në dialogë të shkurtra me regjistër të thjeshtë gjuhësor dhe me ritëm normal;

- të dallojnë idenë kryesore dhe mesazhin në tekste dhe dialogë të shkurtra;
- të kuptojnë dhe të reagojnë ndaj urdhrave e këshillave dhe t'u përgjigjen sekuencave në gjuhë të folur, në të cilat janë përdorur fjalë të njohura apo të dëgjuara më parë, shprehje bazë, si edhe materiale nga tekste të thjeshta të shprehura qartë dhe me ritëm normal e me sqarime për paqartësi rreth diçkaje të kërkuar nga vetë ata;
- të kuptojnë dhe të reagojnë ndaj frazave të thjeshta, këshillave dhe urdhrave të shprehura me një ritëm normal;
- të kuptojnë dhe të reagojnë përmes përshkrimit të temave të njohura në kohën e tashme, të shkuar ose të ardhme me anë të përsëritjes ose përforsimit vizual.

2.1.2. Të folurit

Nxënësit në përfundim të klasës VI duhet të jenë të aftë:

- të shqiptojnë drejt fjalë dhe fraza të thjeshta të mësuara më parë;
- të përdorin strukturat bazë dhe një fjalor të thjeshtë të përdorimit të përditshëm;
- të bëjnë pyetje të thjeshta dhe të japin përgjigje të shkurtra për atë çka shikojnë apo dëgjojnë, duke shprehur ndjenjat, dëshirat apo parapëlqimet e tyre;
- të përshkruajnë thjesht persona dhe objekte konkrete të përdorimit të përditshëm me korrektësi gramatikore gjatë të folurit;
- të marrin pjesë në dialogje të shkurtra të parapërgatitura, duke përdorur shprehje të mësuara më parë;
- të respektojnë ritmin dhe intonacionin e frazës;
- të marrin pjesë në biseda të thjeshta për të treguar përvojën e tyre në lidhje me tema të njohura e të parashikuara, duke shprehur reagimet e veta;
- të japin e të marrin informacion për veprimtarinë e tyre të përditshme me anë të pyetje-përgjigjeve në të tashmen, të shkuarën e të ardhmen, duke përdorur fraza të thjeshta;
- të marrin fjalën dhe të përfundojnë një bisedë të zakonshme, duke përdorur fjalë e fraza që i kanë ndeshur në mënyrë të vazhdueshme.

2.1.3. *Të lexuarit*

Nxënësit në përfundim të klasës VI duhet të jenë të aftë:

- të përshtatin tingullin me simbolin, të lexojnë fjalë konkrete dhe fraza të thjeshta me një fjalor të njohur, të lexojnë tabela të shkruara dhe reklama të thjeshta;
- të demonstrojnë aftësi se kuptojnë dialogje e tekste të shkurtra dhe reagojnë ndaj tyre;
- të kuptojnë tekste autentike përshkruese të shkurtra që përmbajnë një fjalor tashmë të njohur, të dallojnë fjalët e panjohura dhe të kërkojnë t'i njohin, të lexojnë në mënyrë të pavarur dhe të kuptojnë fjalët sipas kontekstit;
- të fillojnë të dallojnë dhe të nxjerrin kuptimin e fjalëve dhe të strukturave të panjohura nga kontekste të thjeshta gjuhësore.

2.1.4. *Të shkruarit*

Nxënësit në përfundim të klasës VI duhet të jenë të aftë:

- të kopjojnë fjalë dhe fjali të shkurtra që kanë mësuar;
- të bëjnë ushtrime me plotësim vendesh bosh me fjalë të zgjedhura nga një listë me fjalë ose të plotësojnë fjali me etiketa;
- të kopjojnë fjali të shkurtra dhe të dallojnë gabimet;
- të shkruajnë fjali të thjeshta të mësuara (mbështetur në kujtesën e tyre) në çdo kohë dhe në fund të vitit;
- të shkruajnë paragrafe të shkurtra, duke përdorur gjuhë të thjeshtë përshkruese, p.sh., duke shprehur ndjenja dhe reagime të vetat;
- të shkruajnë fjali dhe paragrafe të shkurtra që përcjellin informacione dhe opinione lidhur me përvoja vetjake për tema tashmë të parashikuara në kohën e tashme dhe të shkuar;
- të shkruajnë mesazhe ose të mbajnë shënime brenda përvojave gjuhësore të kufizuara, bazuar në përvoja vetjake;
- të mund të përshtasin një tekst model të thjeshtë, duke përdorur shprehje dhe fjali të thjeshta që përshkruajnë kontekste të njohura në të tashmen, të shkuarën e në të ardhmen.

2.1.5. *Përshkrimi i standardit kulturor*

Nxënësit në përfundim të klasës VI duhet të jenë të aftë:

- të kuptojnë dhe të identifikojnë praktika të përditshme kulturore;

- të përdorin saktë elemente jashtëgjuhësore, si: gjestet, mimikën, gjuhën e trupit në bashkëbisedime në klasë;
- të lexojnë ose te dëgjojnë materiale rreth kulturës në gjuhën që ata mësojnë.

3.1. STANDARDET E TË NXËNIT KLASA VII-IX

3.1.1. Të dëgjuarit

Nxënësit në përfundim të klasës IX duhet të jenë të aftë:

- të tregojnë se kuptojnë thelbin dhe detaje të veçanta, me pak përsëritje, sqarime, pa vështirësi të mëdha, në tregime të shkurtra me larmi temash, me gjuhë dhe përmbajtje të njohur;
- të kuptojnë në një shkallë të gjerë materialin që përmban fjali të thjeshta dhe të përbëra, si dhe fjalë të panjohura, me gjuhë të artikuluar me shpejtësi normale (këtë e tregon përmes përmbledhjes së lajmeve të shkurtra dhe njoftimeve të dhëna në programe radiotelevizive, me pak përsëritje);
- të kuptojnë tregime të shkurtra dhe fragmente të gjuhës së folur me tematikë të ndryshme, të cilat përfshijnë regjistër gjuhësor të njohur në kontekst të panjohur;
- të përballojnë gjuhën e përditshme të artikuluar me shpejtësi normale, të kuptojnë pothuajse plotësisht programet e TV me interes për ta, si: intervista dhe njoftime, të shprehura qartë dhe ngadalë.

3.1.2. Të folurit

Nxënësit në përfundim të klasës IX duhet të jenë të aftë:

- të përballojnë shumicën e situatave në të cilat ndodhen gjatë një udhëtimi në vendin ku flitet gjuha që mësohet, për të plotësuar nevojat e tyre, të bëjnë një bisedë të thjeshtë dhe koherente për tema që paraqesin interes për ta, si: puna, shkolla, koha e lirë, zbavitjet, raste kur gjuha që përdoret është e qartë dhe me ritëm normal nga ana e bashkëfolësit;
- të tregojnë një ngjarje, një përvojë, një ëndërr;
- të përshkruajnë një shpresë apo një qëllim dhe të japin arsye të thjeshta ose shpjegime për një ide të shprehur;
- të japin shpjegime dhe informacione për veprimtarinë e tyre të përditshme;

- të kërkojnë informacione dhe opinione për tema të ndryshme në situata të improvizuara ose reale;
- të parashtrojnë dhe të mbrojnë një pikëpamje, duke përdorur struktura të ndërlikuara gjuhësore me pak hezitim gjatë të shprehurit;
- të diskutojnë për fakte, ide dhe opinione, duke përdorur një fjalor të pasur dhe struktura sintaksore të larmishme;
- të shprehen pa hezitim dhe me pak gabime gjuhësore.

3.1.3. Të lexuarit

Nxënësit në përfundim të klasës IX duhet të jenë të aftë:

- të kuptojnë sa më me qartësi tekstet që përmbajnë pikëpamje dhe opinione të shprehura me një gjuhë të njohur në kontekste të panjohura, të zgjedhin materiale leximi që u përgjigjen interesave të tyre për t'i lexuar në mënyrë të pavarur, të aftësohen për të nxjerrë gjithnjë e më shumë nga konteksti kuptimin e fjalëve dhe të shprehjeve të panjohura;
- të kuptojnë dhe të reagojnë më me lehtësi ndaj një larmie të gjerë tekstesh për tema të njohura me një strukturë më komplekse, me fjali dhe fraza të panjohura;
- të kapin me lehtësi idenë kryesore të teksteve autentike, si dhe detajet, përfshirë këtu dhe pikëpamjet e ndryshme që shprehen, të orientohen në përdorimin e fjalorëve të gjuhëve përkatëse ose dygjuhësh për të nxjerrë kuptimin e fjalëve në përputhje me kontekstin.

3.1.4. Të shkruarit

Nxënësit në përfundim të klasës IX duhet të jenë të aftë:

- të shkruajnë tekste mjaft të shkurtra, duke përdorur fjali të përbëra mbështetur në përvojën e tyre ndjesore, duke pyetur dhe duke dhënë informacione vetjake;
- të përdorin elementet kryesore gramatikore dhe një rend korrekt fjalësh;
- të kryejnë detyra të njohura që kërkojnë formime të thjeshta fjalish dhe strukturash për të përcjellë një ide, si p.sh., një shënim, një letër të shkurtër etj.;
- të përdorin gjuhë të thjeshtë, por të qartë përshkruese për të shkruar për tema dhe përvoja të njohura, duke përfshirë ngjarje të së shkuarës dhe të së ardhmes;

- të përdorin gjuhë formale dhe joformale në nivel të thjeshtë;
- të shkruajnë me paragrafe me gjuhë të thjeshtë përshkruese, duke iu referuar veprimeve dhe ngjarjeve të së shkuarës dhe të së ardhmes;
- të shkruajnë hartime, duke përdorur fjalorin për tema të njohura;
- të përshtasin gjuhën e mësuar më parë për kontekste të reja;
- të kuptojnë, të përshtasin, të përmbledhin duke përdorur burime përkatëse.

3.1.5. Përshkrimi i standardit kulturor

Nxënësit në përfundim të klasës IX duhet të jenë të aftë:

- të diskutojnë komponentë të modeleve sociale të kulturës që studiohet;
- të përdorin saktë me shkrim dhe me gojë regjistra të ndryshëm gjuhësorë;
- të përdorin në mënyrë të përshtatshme me gojë dhe me shkrim formulat e mirësjelljes.

STANDARDET E TË NXËNIT

Fusha:

SHKENCA SHOQËRORE

Koordinator:

Astrit DAUTAJ

Grupi i punës:

Mahir HOTI

Zyhdi DERVISHI

Merita SHEME

Majlinda ZIU

Neritan CEKA

Luan MALLTEZI

Mamica THANATI

Aurora GUXHOLLI

Albana KOSOVRASTI

Evis MASTORI

Ines TODHE

1. HYRJE

Fusha e shkencave shoqërore është një studim i integruar i shkencave shoqërore dhe humane që synojnë të formojnë kompetencat e qytetarisë. Në kuadrin e kurrikulës së arsimit, kjo fushë përfshin disiplina të tilla, si edukimi qytetar, historia, gjeografia etj. Qëllimi kryesor i shkencave shoqërore si fushë është t'i pajisë nxënësit me njohuri, aftësi dhe qëndrime për të marrë vendime të arsyeshme në emër të së mirës së përbashkët, si qytetarë të një shoqërie demokratike, shumëkultureshe në një botë gjithnjë e më të ndërruar.

Sipas Kornizës Kurrikulare, fusha e Shkencave shoqërore synon që, gjatë arsimit bazë, nxënësit:

- të përftojnë njohuritë bazë në disiplinat kryesore të shkencave shoqërore, si: Qytetaria, Historia, Gjeografia dhe aftësitë për t'i zbatuar ato në jetën e tyre të përditshme;
- të fitojnë bazat e qytetarisë, duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve politike, ekonomike, shoqërore e kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to, përmes studimit të gjithë përvojës njerëzore;
- të kuptojnë konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe të zbatojnë këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri;
- të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë gjeografike, si: vendndodhjen, vendet, ndërveprimin njerëzor/mjedisor, lëvizjet dhe rajonet;
- të fitojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme për të marrë pjesë në mënyrë të përgjegjshme në zhvillimet e vazhdueshme demokratike;
- të zbatojnë kuptimin e ndikimit të ndërveprimit njerëzor dhe larmisë kulturore në shoqëri;
- të marrin vendime, duke u bazuar në ligjësitë ekonomike.

Standardet e përbashkëta të shkencave shoqërore në këtë dokument janë organizuar në dhjetë linja, të cilat përmbajnë edhe arritjet e pritura nga

nxënësit në secilën prej tyre në fund të klasës së 9-të. Linjat janë ndërlëndore dhe si të tilla ato lidhen dhe priten natyrshëm me njëra-tjetrën.

Linjat kryesore të standardeve të shkencave shoqërore janë:

- Kultura.
- Koha, vazhdimësia, ndryshimi.
- Njerëz, vende dhe mjedise.
- Zhvillimi individual dhe identiteti.
- Individë, grupe, institucione.
- Pushteti dhe autoriteti.
- Prodhimi, shpërndarja, konsumi.
- Shkenca, teknologjia, shoqëria.
- Lidhjet globale.
- Ideale dhe praktika të qytetarisë.

2. STANDARDET SIPAS LINJAVE

LINJA 1: Kultura

Standardet

- Nxënësit krahasojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre,
- Nxënësit përshkruajnë ndikimin dhe bashkëveprimin e llojshmërinë kulturore, si dhe të kohezionit social brenda dhe ndërmjet grupeve.
- Nxënësit shpjegojnë si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme, interpretojnë informacionet dhe përvojat.
- Nxënësit shpjegojnë dhe japin shembuj për mënyrën e ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës.
- Nxënësit shpjegojnë pse individët dhe grupet reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre.

LINJA 2: Koha, vazhdimësia, ndryshimi*Standardet*

- Nxënësit demonstrojnë të kuptuarit që njerëz të ndryshëm mund të përshkruajnë të njëjtat ngjarje ose situata në mënyra të ndryshme, por duke dhënë argumente për këndvështrimet e tyre.
- Nxënësit identifikojnë dhe përdorin konceptet kyç, si kronologjia, rastësia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti për të shpjeguar, për të analizuar dhe për të treguar lidhjet ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë.
- Nxënësit identifikojnë dhe përshkruajnë periudha të caktuara historike dhe modele të ndryshimit në dhe ndërmjet kulturave, të tilla si rritja e qytetërimit, zhvillimi i sistemeve të transportit, komunikimit etj.
- Nxënësit identifikojnë dhe përdorin proceset e rëndësishme për të rindërtuar dhe për të riinterpretuar të kaluarën, të tilla si përdorimi i një larmie burimesh që sigurojnë të dhëna të vlefshme dhe të besueshme.
- Nxënësit zhvillojnë ndjenja të tilla si simpatia, skepticizmi etj., lidhur me qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e njerëzve në kontekste të ndryshme historike.

LINJA 3: Njerëz, vende, mjedise*Standardet*

- Nxënësit përshkruajnë tiparet e mjediseve në nivel vendor, kombëtar, rajonal e global dhe shpjegojnë marrëdhëniet brenda ekosistemit përmes përdorimit të burimeve të duhura, të dhënave burimore dhe mjeteve didaktike, të tilla si fotografi, harta, libra, gazeta, statistika, si dhe të tjera që ndihmojnë për të bërë përgjithësime, përpunime dhe interpretime rreth bashkëveprimit të njerëzve me vendet dhe mjedisin.
- Nxënësit zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, kuptojnë vendndodhjen e njerëzve, të vendeve dhe burimeve dhe shpjegojnë arsyen e kësaj vendndodhjeje.
- Nxënësit përshkruajnë si kanë ndikuar dhe ndikojnë ngjarjet historike, faktorët fizikë dhe njerëzorë në zhvillimin vendor, rajonal, kombëtar dhe global.

- Nxënësit vëzhgojnë dhe debatojnë rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe propozojnë, krahasojnë e vlerësojnë alternativat e përdorimit të burimeve natyrore në komunitete, rajone, kombe dhe në botë.

LINJA 4: Zhvillimi individual dhe identiteti

Standardet

- Nxënësit lidhin ndryshimet personale me kontekstet sociale, kulturore e historike dhe përshkruajnë mënyrat sesi familja, gjinia, etniciteti, kombësia dhe lidhjet institucionale kontribuojnë në identitetin e personit.
- Nxënësit identifikojnë dhe përshkruajnë ndikimin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe besimeve në identitetin personal dhe lidhin faktorë të tillë, si mjedisi dhe aftësitë fizike me të mësuarin, motivimin, personalitetin, perceptimin dhe sjelljen.
- Nxënësit identifikojnë dhe përshkruajnë mënyrat sesi kulturat rajonale, etnike dhe kombëtare, ndikojnë në jetën e përditshme të individit dhe punojnë në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me individë e grupe me prejardhje të ndryshme për arritjen e qëllimeve.

LINJA 5: Individët, grupet, institucionet

Standardet

- Nxënësit demonstrojnë të kuptuarit e koncepteve, të tilla si roli, statusi dhe klasa sociale në përshkrimin e ndërveprimit të individit me grupet sociale.
- Nxënësit përshkruajnë mënyrat e bashkëveprimit të institucioneve me njerëzit dhe analizojnë ndikimet e grupit dhe të institucioneve tek individët, njerëzit, ngjarjet dhe elementet e kulturës.
- Nxënësit përshkruajnë rolin nxitës apo frenues të institucioneve në shoqëri dhe zbatojnë njohuritë sesi grupet dhe institucionet duhet të punojnë për të përmbushur nevojat individuale dhe për të nxitur të mirën e përbashkët.
- Nxënësit identifikojnë dhe analizojnë shembuj tensionesh ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe grupit, respektimit të qëndrimeve individuale dhe përpjekjeve institucionale për konformitet social, ndërmjet sistemeve të besimit, ligjeve dhe politikave të qeverisjes etj.

LINJA 6: Pushteti, autoriteti, qeverisja*Standardet*

- Nxënësit përshkruajnë qëllimin e qeverisjes dhe mënyrën si është ruajtur, përdorur dhe justifikuar pushteti i saj. Ata analizojnë e përshkruajnë idetë dhe mekanizmat qeveritare për të përmbushur nevojat dhe dëshirat e qytetarëve, për të rregulluar territorin, për të menaxhuar konfliktet dhe për të vendosur rregull dhe siguri.
- Nxënësit shqyrtojnë në mënyrë të vazhdueshme çështjet që përfshijnë të drejtat, rolet dhe statusin individual në lidhje me mirëqenien e përgjithshme. Ata shpjegojnë dhe zbatojnë koncepte të tilla, si pushteti, roli, statusi, drejtësia, dhe ndikimi për shqyrtimin e çështjeve të përhershme të qeverisjes dhe problemeve sociale.
- Nxënësit identifikojnë dhe përshkruajnë tiparet bazë të sistemit politik në vendin tonë dhe identifikojnë udhëheqësit përfaqësues nga nivele dhe degë të ndryshme të qeverisjes.
- Nxënësit shpjegojnë kushtet, veprimet dhe motivet që nxisin rritjen e bashkëpunimit apo të konflikteve brenda dhe ndërmjet kombeve. Ata shpjegojnë me shembuj se si qeveritë përpiqen të arrijnë idealet e shpallura për brenda dhe jashtë vendit.

LINJA 7: Prodhimi, shpërndarja, konsumi*Standardet*

- Nxënësit përshkruajnë me shembuj si sistemet ekonomike bëjnë zgjedhjet e tyre për prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave materiale dhe të shërbimeve.
- Nxënësit përshkruajnë shembuj të ndryshëm të institucione që formojnë sistemet ekonomike, si prodhimi i vogël (edhe ai familjar), firmat prodhuese, bankat, institucionet qeveritare, sindikatat dhe korporatat.
- Nxënësit përshkruajnë rolin e specializimeve dhe të shkëmbimit në proceset ekonomike.
- Nxënësit përshkruajnë rolin që luajnë kërkesa, oferta, mënyra e shpërblimit, çmimi dhe fitimet në përcaktimin e asaj që prodhohet dhe shpërndahet në një sistem konkurrence në treg; bëjnë dallimin ndërmjet formave të ndryshme të shkëmbimit dhe parave.
- Nxënësit përdorin koncepte ekonomike për të shpjeguar zhvillimet aktuale dhe historike në një kontekst shoqëror vendor, kombëtar dhe global.

- Nxënësit përdorin arsyetimin ekonomik për të krahasuar propozime të ndryshme që lidhen me çështje shoqërore bashkëkohore, si papunësia, cilësia e arsimit etj.
- Nxënësit përshkruajnë dhe tregojnë me shembuj ndikimin e vlerave dhe bindjeve vetjake në vendimet e ndryshme ekonomike.

LINJA 8: Shkenca, teknologjia dhe shoqëria

Standardet

- Nxënësit shqyrtojnë dhe përshkruajnë ndikimin e kulturës në zgjedhjet dhe arritjet e shkencës dhe teknologjisë, si në transport, mjekësi, mirëqenie etj.
- Nxënësit tregojnë, përmes shembujve specifikë, se si shkenca dhe teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe sociale, si p.sh: marrëdhëniet e tyre me tokën, jetën e kafshëve, jetën familjare, nevojat dhe dëshirat ekonomike dhe sigurinë.
- Nxënësit përshkruajnë me shembuj se si vlerat, besimet dhe qëndrimet janë ndikuar nga zbulimet e reja shkencore dhe teknologjike, si për shembull, shpikja e shtypit, konceptimi i universit, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike.
- Nxënësit shpjegojnë nevojën për ligje dhe politika të caktuara për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike, si në fushën e sigurisë dhe të mirëqenies së punëtorëve dhe konsumatorëve, në fushën e përdorimit të pajisjeve të jetës të përditshme, të televizionit, të radios etj.

LINJA 9: Lidhjet globale

Standardet

- Nxënësit përshkruajnë me shembuj ndikimin e elementeve kulturore, si: gjuha, arti, muzika, besimet etj., në ndërtimin e mirëkuptimit në nivel kombëtar e global dhe analizojnë shembuj bashkëpunimi, ndërvarësie ose konfliktesh ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve.
- Nxënësit përshkruajnë dhe analizojnë ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global.
- Nxënësit shqyrtojnë shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëguara ose të reja, si shëndeti, siguria, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit.

- Nxënësit përshkruajnë dhe shpjegojnë marrëdhëniet e kontradiktat ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla, si: territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë dhe mirëqenia e popujve.
- Nxënësit identifikojnë dhe përshkruajnë rolin e organizmave ndërkombëtarë dhe të organizatave ndërshtetërore në zgjidhjen e problemeve globale.

LINJA 10: Idealet dhe praktikat e qytetarisë/të drejtat e njeriut

Standardet (Idealet dhe praktikat e qytetarisë)

- Nxënësit shqyrtojnë origjinën dhe ndikimin e vazhdueshëm të idealeve të shoqërisë demokratike, si dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës; identifikojnë e interpretojnë burimet e të drejtave të njeriut, si dhe shembuj të tyre në jetën e përditshme.
- Nxënësit gjejnë, grumbullojnë, organizojnë dhe shfrytëzojnë informacion për çështje të veçanta publike, duke shpjeguar këndvështrimet e ndryshme për to.
- Nxënësit analizojnë dhe shpjegojnë veprimet e ndryshme që qytetarët duhet të ndërmarrin për të ndikuar në vendimet e politikës publike. Ata analizojnë efektshmërinë e politikave të caktuara publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike.
- Nxënësit identifikojnë dhe shpjegojnë rolin që luajnë aktorët e ndryshëm politikë, që veprojnë në sektorin publik e në shoqërinë civile, në fushën e hartimit dhe të modelimit të politikës publike dhe të procesit të vendimmarrjes. Ata shqyrtojnë strategjitë e hartuara për realizmin dhe fuqizimin e të mirës së përbashkët.
- Nxënësit analizojnë ndikimin e formave të ndryshme të opinionit publik në zhvillimin e politikës dhe në procesin e vendimmarrjes për çështjet publike.
- Nxënësit praktikojnë forma të caktuara të diskutimeve dhe të pjesëmarrjes publike, që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike.

Standardet (Të drejtat e njeriut)

- Nxënësit identifikojnë, përshkruajnë dhe klasifikojnë nevojat dhe dëshirat bazë të qenies njerëzore dhe shpjegojnë pse plotësimi i

nevojave dhe i dëshirave bazë përbën një të drejtë që u takon atyre dhe të tjerëve.

- Nxënësit identifikojnë në dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut dhe në kushtetutën shqiptare, të drejtat dhe liritë themelore.
- Nxënësit dallojnë llojet kryesore të të drejtave, si të drejtat personale, të drejtat civile dhe politike, të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, të drejtat për një mjedis të shëndetshëm etj., dhe shpjegojnë me shembuj rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për veten dhe për të tjerët.
- Nxënësit vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuara lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimt, të kufizimit dhe të ndërlidhjes e ndërvarësisë së të drejtave.
- Nxënësit dallojnë raste të kufizimit të të drejtave në jetën e përditshme (familje, klasë etj.) dhe tregojnë se të drejtat kufizohen nga nevoja për të respektuar të drejtat e të tjerëve në emër të harmonisë shoqërore.
- Nxënësit respektojnë e ndërmarrin veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tyre dhe të të tjerëve.

QYTETARI

LINJA 1: Kultura (dimensioni kulturor)

Standardi

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje të kulturës dhe të llojshmërisë kulturore. Ata kuptojnë se si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë dhe përshtaten ndaj kulturës, vlerësojnë rolin e kulturës në modelimin e jetës dhe të shoqërisë.

LINJA 2: Zhvillimi individual dhe identiteti (dimensioni vetjak dhe shoqëror)

Standardi

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me zhvillimin individual dhe shoqëror. Ata mësojnë se identiteti vetjak formohet nga ndikimi i familjes, i grupit shoqëror, i kulturës dhe i institucioneve. Në këtë linjë studimi, nxënësit shqyrtojnë faktorët që ndikojnë në identitetin e tyre vetjak, në zhvillimin dhe veprimet e tyre.

LINJA 3: Individë, grupe dhe institucione (dimensioni shoqëror)*Standardi*

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me institucione të tilla, si familja dhe organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe me mënyrën se si ato ushtrojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë institucionet.

LINJA 4: Pushteti, autoriteti dhe qeverisja (dimensioni politik)*Standardi*

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështjet që lidhen me zhvillimin historik dhe bashkëkohor të formave të pushtetit, të autoritetit dhe të qeverisjes. Ata kuptojnë qëllimet dhe funksionet e qeverisjes, fushën dhe kufizimet e autoritetit, si dhe ndryshimet ndërmjet sistemeve politike demokratike dhe jodemokratike.

LINJA 5: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi (dimensioni ekonomik)*Standardi*

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me njohjen dhe të kuptuarit e mënyrës se si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave dhe të shërbimeve. Kjo linjë ofron mundësinë që nxënësit të studiojnë e të kuptojnë çështjet ekonomike vendore, kombëtare dhe globale.

LINJA 6: Ndërvarësia (dimensioni europian dhe global)*Standardi*

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me realitetet e ndërvarësisë rajonale dhe globale dhe rëndësinë, në rritje, të lidhjeve të ndryshme globale. Ata aftësohen të eksplorojnë çështje që lidhen ose janë pasojë e globalizimit.

LINJA 7: Ideale dhe praktika të qytetarisë (dimensioni politik, i të drejtave të njeriut, i përgjegjësisë vetjake e shoqërore, i pjesëmarrjes qytetare)*Standardi*

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështjet që lidhen me të kuptuarit e idealeve dhe të praktikave të qytetarisë si faktorë të rëndësishëm e vendimtarë për një pjesëmarrje të plotë, të përgjegjshme, aktive e cilësore në shoqëri.

GJEOGRAFI

LINJA 1: Sistemet fizike

Standardi

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për veçoritë e përbërësve të gjeosistemit, lidhjen dhe bashkëveprimin ndërmjet tyre, pasojat e këtij bashkëveprimi, si dhe ndikimin e tij në tiparet fizike të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, të rajoneve dhe vendeve të ndryshme të botës.

LINJA 2: Sistemet humane

Standardi

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për karakteristikat demografike, ekonomike, sociale, kulturore e politike të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, të rajoneve e vendeve të ndryshme të botës, si dhe për kompleksitetin e tyre.

LINJA 3: Vendet dhe rajonet

Standardi

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për tiparet fizike dhe humane të rajoneve dhe nënrajoneve të botës, të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, ndërvarësinë ndërmjet tyre, ndikimin e këtyre tipareve në fizionominë e rajoneve dhe nënrajoneve.

LINJA 4: Ndërveprimi njeri-mjedis

Standardi

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas, në nivel vendor, kombëtar, rajonal e global.

LINJA 5: Mjetet gjeografike dhe vendndodhja

Standardi

- Nxënësit përdorin mjetet gjeografike (harta, glob, fotografi etj.) dhe teknologjinë në lokalizimin e tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane, për grumbullimin, përpunimin dhe komunikimin e informacionit.

HISTORI**LINJA 1: Historia e qytetërimeve botërore***Standardi*

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për historinë e qytetërimit botëror, në mënyrë që të kuptojnë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, si dhe lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, duke përfshirë këto periudha të historisë botërore sipas linjës kronologjike:
 - Qytetërimi në parahistori.
 - Qytetërimet botërore në antikitet (mijëvjeçari IV p.e.s. - 400 e.s.).
 - Qytetërimet botërore në mesjetë (400 - 1450).
 - Qytetërimet në fillimet e historisë moderne (1450-1650).
 - Koha e ndryshimeve thelbësore (1650-1914).
 - Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945).
 - Qytetërimet bashkëkohore (1945 - sot).

LINJA 2: Historia e shqiptarëve*Standardi*

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për historinë e shqiptarëve në mënyrë që të kuptojnë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, si dhe lidhjen e tyre me të tashmen dhe të ardhmen, duke i përfshirë këto periudha të historisë së shqiptarëve sipas linjës kronologjike:
 - Njohuritë historike dhe rrënjët e tij.
 - Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare deri në shek. V.
 - Territoret arbërore në mesjetë (shek. VI - XIV).
 - Shqiptarët në periudhën moderne (shek. XV - XIX).
 - Rilindja kombëtare shqiptare (vitet '30 të shek. XIX-fillimi i shek. XX).
 - Shteti shqiptar gjatë shekullit XX.
 - Shqiptarët jashtë kufijve politikë (1912-sot).

STANDARDET E TË NXËNIT

Fusha:

EDUKIM PËR SIPËRMARRJEN

Koordinatorë:

Mirela ANDONI

Grupi i punës:

Merita SHUKA

Alqi MUSTAFAI

Luljeta MINAROLLI

1. HYRJE

Sipërmarrja, si një nga 8 kompetencat kyçe për arsimin, përcaktohet si aftësia e individit për të kthyer idetë në veprime konkrete. Edukimi për sipërmarrjen krijon premisa për të nxitur shpirtin e iniciativës dhe të inovacionit, orientimin për punë dhe shkollim, punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjve referuar zhvillimeve aktuale dhe të perspektivës në tregun e punës.

Edukimi për sipërmarrjen në arsimin parauniversitar ka për qëllim të aftësojë nxënësit për të njohur veten, botën e punës dhe biznesin me qëllim kryerjen e sipërmarrjeve personale, orientimin për karrierën duke përdorur elemente të planifikimit, të organizimit, të analizës, të drejtimit, të punës individuale dhe në grup, të vlerësimit dhe të buxhetimit.

Fusha “Edukimi për sipërmarrjen realizohet e integruar në fushën e “Shkencave shoqërore” përkatësisht në lëndën “Unë dhe shoqëria”, me fushën “Teknologji” përkatësisht në lëndën “Ekonomi shtëpiake”, si dhe përmes lëndës “Edukimi për karrierën” klasa 9-të.

Edukimi për sipërmarrjen është pjesë e objektivave të kurrikulës me zgjedhje të lirë.

2. ORGANIZIMI I STANDARDEVE TË FUSHËS

Standardet e fushës realizohen të integruara në lëndët “Unë dhe shoqëria”, klasa 1-6, “Ekonomi shtëpiake” klasa 4-6, “Edukim për karrierën” klasa 9-të si dhe përmes kurrikulës me zgjedhje të lirë.

3. STANDARDET SIPAS LINJAVE

LINJA: Zhvillimi personal

Standardet

- Nxënësit zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin si bazë për të kryer sipërmarrje.
- Nxënësit zbulojnë aftësitë personale, dëshirat, nevojat dhe krijojnë premisa për të kthyer idetë në veprime konkrete.
- Nxënësit zhvillojnë mendimin krijues, marrin përsipër rreziqe gjatë nismave të ndryshme të realizuara në mënyrë të mbikëqyrur apo të pavarur.

LINJA: Bota e punës dhe e biznesit

Standardet

- Nxënësit zbulojnë natyrën dhe llojet e punëve, të sipërmarrjeve dhe sipërmarrësit, mundësitë për karrierë dhe mundësitë për të kryer sipërmarrje.
- Nxënësit zbulojnë mënyrën e fitimit, kursimit dhe përdorimit të parasë.
- Nxënësit zbulojnë mënyrat e organizimit, funksionimit të biznesit dhe zhvillimet ekonomike të rajonit.

LINJA: Aftësitë sipërmarrëse

Standardet

- Nxënësit, gjatë punëve konkrete praktike në shkollë, shtëpi dhe komunitet, demonstrojnë aftësi për të komunikuar, prezantuar, planifikuar, drejtuar, analizuar, buxhetuar, për të punuar individualisht dhe në grup si aftësi bazë për një sipërmarrës.
- Nxënësit eksplorojnë mundësi për të ndërmarrë nisma që përfshijnë edhe ato për karrierën duke respektuar hapat për hapjen e një biznesi që gjithashtu përfshijnë hartimin dhe zbatimin e një plani të thjeshtë biznesi.
- Nxënësit demonstrojnë mënyra të ndryshme për të menaxhuar paratë dhe financat personale në rastet e sipërmarrjeve në shkollë, shtëpi, komunitet dhe për karrierën.

EDUKIMI PËR KARRIERËN**LINJA: Vetëvlerësimi***Standardet*

- Nxënësit gjykojnë dhe përgatitin informacionin për vetveten, duke marrë parasysh dhe ndikimet e mjedisit mbi ta.
- Nxënësit gjykojnë për aftësitë e nevojshme për t'u punësuar.
- Nxënësit krahasojnë dhe gjykojnë për aftësitë e transferueshme në profesione të ndryshme.

LINJA: Hulumtimi*Standardet*

- Nxënësit demonstrojnë aftësi për të hulumtuar në sistemin e arsimit, trajnimit, si dhe botën e punës.
- Nxënësit demonstrojnë aftësi për të dalluar mes punës, profesionit dhe karrierës.
- Nxënësit demonstrojnë aftësi për të kërkuar punë.

LINJA: Planifikimi/Vendimmarrja për karrierën*Standardet*

- Nxënësit demonstrojnë aftësi të hartojnë dhe të përshtatin planin personal për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm.
- Nxënësit demonstrojnë aftësi për reflektuar mundësitë ekonomike, bursat dhe financat personale në planin personal të karrierës.
- Nxënësit demonstrojnë vendimmarrjen për shkollimin dhe trajnimin e mëtejshëm bazuar në planin e karrierës.

STANDARDET E TË NXËNIT

Fusha:

ARTE

Koordinatorë:

Majlinda HALA

Grupi i punës:

Petrit MALAJ

Besnik BISHA

Julika SIMO

Majlinda HALA

Shpëtim KËRÇUKU

Joli ELENI GJOVREKU

Aneta MALAJ

Mehmet XHELILI

Ani THEODHOSI

1. HYRJE

Fusha e arteve është një nga fushat e rëndësishme të kurrikulës, e cila lidhet ngushtë me zhvillimin intelektual, social, kulturor dhe emocional të nxënësve. Ajo ndihmon në krijimin e lidhjeve të individëve me përvoja të ndryshme artistike.


Standardet sigurojnë mundësinë për zbatimin e një kurrikule kombëtare të arsimit të detyruar. Standardet e arteve krijojnë mundësinë për të njohur dhe qenë të suksesshëm në disiplinat artistike që nxënësit do të studiojnë përgjatë arsimit bazë. Artet kanë qenë dhe janë pjesë e rëndësishme e përvojës njerëzore, që lejojnë të gjithë njerëzit të shprehin ndjenjat dhe emocionet, duke i lidhur njohuritë e tyre me njohuritë e reja që marrin rreth kulturave të ndryshme.

Studimi i arteve synon që nxënësit në fund të arsimit të detyruar:

- të komunikojnë përmes fushës së arteve - art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër;
- të përdorin elementet dhe parimet e arteve në krijimin dhe vlerësimin estetik e kritik të një vepre muzikore, skenike apo figurative;
- të njohin vepra të ndryshme arti nga kultura, kontekste dhe periudha të ndryshme historike;
- të komunikojnë përmes fushës së artit, duke përdorur mjete, teknika dhe materiale të përshtatshme për realizimin e një vepre artistike;
- të vlerësojnë veprat e artit shqiptar dhe botëror, të krijuara në periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike;
- të zhvillojnë vetëdijen kombëtare nëpërmjet trajtimit historik të vlerave artistike kombëtare;
- të realizojnë një punë individuale dhe të analizojnë një punë arti të vetën apo të të tjerëve - art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër;

- të lidhin njohuritë artistike brenda disiplinave në fushën e arteve dhe me fusha të tjera të të nxënit.

Fusha e arteve përmban lëndët: Art pamor, Muzikë, Kërcim dhe Teatër.




2. ORGANIZIMI I STANDARDEVE TË FUSHËS

Standardet e fushës së arteve janë organizuar sipas linjave. Standardet e 5 linjave të para u adresohen të gjitha lëndëve të fushës. Standardet e linjave të tjera kanë të bëjnë me përmbajtjet sipas lëndëve të fushës.

Linjat e përbashkëta të fushës së arteve janë:

- kuptimi dhe zbatimi i njohurive artistike;
- elemente dhe parime;
- historia dhe kultura;

- krijime, analiza dhe vlerësime;
- lidhja me artet e tjera.



3. STANDARDET SIPAS LINJAVE

LINJA 1: Kuptimi dhe zbatimi i njohurive artistike

Standardet

- Nxënësit përdorin *konceptet e artit*, duke i zbatuar në *proceset* artistike dhe krijuar punët artistike origjinale, bazuar në ide, përvoja, histori dhe opinione të ndryshme.
- Nxënësit ndërthurin njohuritë mbi artet, duke i zbatuar në disiplina të ndryshme artistike vetëm dhe me të tjerët.
- Nxënësit kuptojnë se artet janë një mënyrë për të krijuar dhe komunikuar, duke shprehur gjendjen emocionale.

LINJA 2: Elemente dhe parime

Standardet

- Nxënësit zbatojnë elementet dhe parimet e arteve, duke përdorur veçoritë e secilit.

Për artin pamor - *elementet* janë: linja, forma, hapësira, vlera, cilësia, ngjyra, koha dhe lëvizja;

- *parimet* janë: theksi, balanca, proporcioni, modeli, përsëritja dhe variacioni, ritmi dhe uniteti.

Për muzikën - *elementet* janë: gjatësia, lartësia, dinamika, timbri, harmonia, forma.

Për kërcimin - *elementet* janë: trupi, hapësira, koha, energjia dhe marrëdhënia.

Për teatrin - *elementet* janë: besimi, koha dhe vendi, roli dhe karakteri, veprimi, marrëdhënia.

LINJA 3: Historia e artit

Standardet

- Nxënësit kuptojnë rolin që kanë luajtur artet në jetën e njerëzve në të shkuarën dhe të tashmen, duke shpjeguar *zhvillimet, karakteristikat, veprat dhe përfaqësuesit*.
- Nxënësit njohin rolin e zhvillimit të historisë së arteve dhe të veprave artistike të krijuara në kontekste të ndryshme sociale, politike, fetare, kulturore dhe gjeografike nga artistë të ndryshëm.

LINJA 4: Krijimi, analiza dhe vlerësimi

Standardet

- Nxënësit zbatojnë aftësitë krijuese për të realizuar një pjesë të thjeshtë artistike (muzikore, figurative, kërcyese, aktruese).
- Nxënësit përshkruajnë, analizojnë dhe vlerësojnë krijimet e tyre dhe të tjerëve në (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër), duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.
- Nxënësit vlerësojnë rolin e arteve në jetën e përditshme dhe në komunitet.

LINJA 5: Lidhja me artet e tjera

Standardet

- Nxënësit bëjnë lidhjen e njohurive të një disipline të caktuar arti me disiplina të tjera të artit dhe me fusha të tjera të të nxënit.

ART PAMOR

LINJA 1: Arti dydimensional

Standardet

- Nxënësit përdorin materialet, teknikat dhe proceset artistike dydimensionale për të krijuar punime arti origjinale (të vetat), duke u bazuar në ide, përvoja dhe opinione të ndryshme.
- Nxënësit përdorin elementet dhe parimet e artit në veprat dydimensionale.
- Nxënësit reflektojnë mbi krijimet dydimensionale të vetat dhe të të tjerëve, duke përshkruar, analizuar, interpretuar dhe vlerësuar ato.
- Nxënësit kuptojnë rolin që ka luajtur arti figurativ në të shkuarën dhe të tashmen, duke shpjeguar zhvillimin, karakteristikat e veprave dhe përfaqësuesit.

LINJA 2: Arti tredimensional

Standardet

- Nxënësit njohin dhe përdorin materialet, teknikat dhe proceset artistike tredimensionale, për të krijuar punime arti origjinale (të vetat), duke u bazuar në ide, përvoja dhe opinione të ndryshme.
- Nxënësit dallojnë, kuptojnë dhe përdorin elementet dhe parimet e artit, në veprat tredimensionale.
- Nxënësit reflektojnë mbi krijimet tredimensionale të veta dhe të të tjerëve, duke përshkruar, analizuar dhe vlerësuar ato.
- Nxënësit kuptojnë rolin që ka luajtur arti figurativ në të shkuarën dhe të tashmen, duke shpjeguar zhvillimin, karakteristikat e veprave dhe përfaqësuesit.

MUZIKË

LINJA 1: Dëgjimi muzikor

Standardet

- Nxënësit përdorin elementet muzikore, gjatë krijimit, interpretimit apo reflektimit të pjesëve muzikore.
- Nxënësit lexojnë dhe krijojnë në ritme të ndryshme muzikore.
- Nxënësit vlerësojnë zhvillimin e muzikës në kohë dhe hapësirë nga kultura të vendeve të ndryshme.

- Nxënësit vlerësojnë zhvillimin e muzikës shqiptare, vokale dhe instrumentale dhe përfaqësuesve të saj.

LINJA 2: Kënga dhe instrumenti

Standardet

- Nxënësit këndojnë shumëllojshmëri këngësh, vetëm dhe me të tjerët.
- Nxënësit luajnë në instrumente të ndryshme muzikore ORF melodike dhe ritmike, fyell, vetëm dhe me të tjerët.

LINJA 3. Krijimi dhe reflektimi

Standardet

- Nxënësit krijojnë dhe analizojnë punën e tyre dhe të të tjerëve, bazuar mbi elementet muzikore të përdorura.
- Nxënësit dëgjojnë dhe analizojnë pjesë muzikore vokale apo instrumentale, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.
- Nxënësit vlerësojnë rolin e muzikës në jetën e përditshme dhe komunitet.

KËRCIM

LINJA 1: Zbulojmë nëpërmjet procesit krijues

Standardet

- Nxënësit demonstrojnë aftësitë lëvizore, elementet e lëvizjes (hapësira, koha, energjia forca, dhe forma) dhe cilësitë e lëvizjes.
- Nxënësit kuptojnë se vallja është një formë artistike për të komunikuar dhe për të shprehur gjendje të ndryshme emocionale.
- Nxënësit kuptojnë rolin e kërcimit në periudha të ndryshme historike dhe kultura të ndryshme.

LINJA 2: Krijojmë dhe bashkëpunojmë përmes kërcimit

Standardet

- Nxënësit demonstrojnë elemente të ndryshme të lëvizjes, të lidhura së bashku në hapësirë dhe kohë.
- Nxënësit zbatojnë aftësitë krijuese për të realizuar një kërcim të thjeshtë.

LINJA 3: Reflektojmë përmes kërcimit*Standardet*

- Nxënësit mbajnë qëndrim ndaj kërcimeve që realizojnë vetë apo ndaj kërcimeve të realizuara nga të tjerët.

TEATËR**LINJA 1: Zbulojmë nëpërmjet procesit krijues***Standardet*

- Nxënësit kuptojnë rolin e aktrimit nëpërmjet elementeve të teatrit.
- Nxënësit zbatojnë aftësitë aktruese konkretisht në një përrallë, tregim, histori, përmes elementeve të dramës, si: besimi, koha, roli dhe karakteri, veprimi etj.
- Nxënësit kuptojnë rolin e teatrit në lidhje me kulturën dhe historinë, përmes veprave teatrale dhe përfaqësuesve të tyre.

LINJA 2: Krijojmë dhe bashkëpunojmë përmes teatrit*Standardet*

- Nxënësit zotërojnë vetveten kur përballen me publikun, duke rritur vetëbesimin.
- Nxënësit zbatojnë aftësitë krijuese për të realizuar një pjesë të thjeshtë dramatike.
- Nxënësit bashkëpunojnë me njëri - tjetrin gjatë aktrimit të një veprë dramatike.

LINJA 3: Reflektojmë përmes teatrit*Standardet*

- Nxënësit analizojnë dhe mbajnë qëndrim kritik ndaj krijimeve dramaturgjike (të vetat ose të të tjerëve) bazuar në aftësitë e tyre.

STANDARDDET
E ARRITJEVE

PARATHËNIE

I. KONCEPTI

Standardet e arritjeve përcaktojnë nivelet e pritura ose të dallueshme të aftësive të nxënësve në kuadrin e vlerësimit të një detyre, të dhënë në bazë të standardeve të të nxënësve.

Standardet e arritjes (të përkufizuara si më lart), në sisteme të ndryshme arsimore, gjenden në terma të ndryshme. Ato gjenden me termat anglisht “performance standards”, “performance indicators”, “achievement standards”, “benchmarks” etj., që në gjuhën shqipe, me marrëveshje, i kemi quajtur “Standarde arritjeje”.

Fjala “**standard**” lidhet me faktin që, përmes tyre, unifikohen, brenda mundësive, kriteret për vlerësimin e nxënësve nga çdo shkollë e mësues dhe krijohen mundësi për të minimizuar subjektivizmin e skajshëm në vlerësimin e tyre.

Fjala “nivele” shpreh rezultatet e ndryshme që arrijnë nxënës të ndryshëm në përpjekjet e tyre për të arritur standardin e shpallur të të nxënësve. Çdo nivel, në thelb, ofron kriteret të njësuara për vlerësimin e njohurive, të shkathtësive e shprehive të nxënësve dhe kriteret të hollësishme për vlerësimin e nivelit të realizimit të objektivave.

Përshtatjet e standardeve të arritjes nuk janë shteruese, ato nuk dublojnë standardet e të nxënësve dhe nuk duhet të dëmtojnë fleksibilitetin e tyre në zbatim. Ato nuk zëvendësojnë rezultatet e programeve lëndore të ciklit 1-9.

II. NIVELET

Standardet e arritjes, në paketën tonë kurrikulare, gjenden në tre nivele, pa llogaritur nivelin pakalues:

1. Niveli bazë
2. Niveli mesatar
3. Niveli i lartë

Çdo nivel përmban aftësi të grupuara në bazë të nivelit **të aftësive të të menduarit**, pra si aftësi të ulëta, mesatare dhe të larta të të menduarit, të lidhura ngushtë me **njohuritë dhe konceptet** në fushën përkatëse të dijes. Në këtë mënyrë, ato shërbejnë si bazë për vlerësimin e nxënësve në procesin e të nxënësve. Në çdo rast, krahasimi i tyre bëhet me standardet e të nxënësve që janë bazë për zhvillimin e programeve lëndore, mbi të cilat zhvillohet, në përgjithësi, procesi i të mësuarit dhe për rrjedhojë, edhe i vlerësimit.

Në përgjithësi, aftësitë e të menduarit (intelektuale) grupohen në:

1. aftësi për të identifikuar dhe për të përshkruar;
2. aftësi për të shpjeguar dhe për të analizuar;
3. aftësi për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara.

1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave, sendeve, dukurive të prekshme ose jo të prekshme (bardhësia, drejtësia, barazia etj). Të identifikosh diçka do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj.
- **Të përshkruash** do të thotë dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj.

2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- **Të shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, për shembull, shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara.
- **Të analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara natyrore ose shoqërore.

3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara

- **Të vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, për shembull, për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj.
- **Të marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose e krijon vetë.
- **Të mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.

Tre grupimet e mësipërme të aftësive intelektuale janë baza për përcaktimin e niveleve të arritjes.

III. PËRDORIMI

Përveç unifikimit në nivel kombëtar të kritereve të vlerësimit të nxënësve, standardet e arritjes:

- krijojnë mundësinë e përcaktimit real të cilësisë së kërkuar të sistemit arsimor, të monitorimit, të verifikimit dhe të vlerësimit të tij nga shoqëria dhe shteti;
- krijojnë dhe sigurojnë sistemin e referimit për ndryshimet graduale afatshkurtëra, afatmesme dhe aftagjata në arsim;
- rritin shkallën e vlefshmërisë dhe përdorimit të rezultateve të vlerësimit të sistemit arsimor.

IV. METODA

Përvoja e deritanishme njih dy metoda ose pikënisje kryesore për hartimin e standardeve të arritjes: metodën relative dhe metodën absolute.

Metoda relative mbështetet në strategjinë e vlerësimit që i referohet një vlere e cila shërben si normë krahasimi. Për shembull, arritjet e një shkolle, në një vit të dhënë, përdoren si normë me të cilën krahasohen arritjet në vitet në vijim. Kjo normë përdoret si pikë referimi për vlerësimet e mëtejshme. Në bazë të kësaj strategjie, edhe nivelet e arritjeve të nxënësve interpretohen

duke u krahasuar me arritjet e një grupi tjetër nxënësish që pranohen si grup normë.

Kjo metodë, megjithëse është e shpejtë, ka dizavantashet e mëposhtme:

- Ajo të çon në kritere të vendosura në mënyrë arbitrare.
- Ndryshimet në arritje ndërmjet nxënësve, mund të duken shumë të vogla ose shumë të mëdha dhe për rrjedhojë krijon vlerësime fiktive.
- Pavarësisht se cilat janë nivelet e referimit, gjithmonë do të ketë mësues dhe nxënës që do t'i vlerësojnë ato shumë të larta (tepër ambicioze) dhe shumë të ulta (të papërfillshme).

Metoda absolute mbështetet në strategjinë e vlerësimit në bazë të kritereve të parapërcaktuara (standardeve) dhe përcakton shkallën në të cilën nxënësit kanë përvetësuar një standard të paracaktuar të nxëni. Interpretimi i arritjeve të nxënësve, mbi bazën e kësaj metode, nuk varet nga arritjet e nxënësve të tjerë.

Meqë e tërë kurrikula jonë bazohet në standarde të miratuara në nivel kombëtar, metoda absolute është baza për hartimin e modelit të standardeve të arritjes, pra edhe të vlerësimit të nxënësve.

Metoda absolute e përdorur në procesin e hartimit të standardeve të arritjes krijoi mundësinë që nivelet e arritjes:

- të hartohen në nivel kombëtar, nga specialistë të kurrikulës dhe nga ekspertë lëndorë;
- të jenë unifikuara për të gjithë;
- të njihen paraprakisht nga të gjithë;
- të gëzojnë miratimin në nivel kombëtar;
- të mos bazohen në matjen e asaj që nxënësit janë të aftë aktualisht të bëjnë etj.

STANDARDET E ARRITJEVE

Fusha:

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Lëndët: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Koordinatorë:

Erida KOLECI

Grupi i punës:

Ardian MARASHI

Alfred MULLA

Aljula JUBANI

Dhurata SHEHRI

Enkelejda KAPIA

Lindita AGURIDHI

Erida KOLECI

1. HYRJE

Standardet e arritjes së gjuhës shqipe dhe të letërsisë janë dokument kurrikular në funksion të zbatimit të synimeve dhe të objektivave të fushës dhe të lëndëve përkatëse. Këto standarde janë hartuar duke u bazuar në standardet e të nxënimit të fushës së gjuhës shqipe dhe letërsisë dhe të lëndëve që e përbëjnë atë.

Standardet e të nxënimit përcaktojnë se çfarë duhet të dinë dhe të bëjnë nxënësit në përfundim të një cikli arsimor, ndërsa standardet e arritjes përshkruajnë se si nxënësit e demonstrojnë përvetësimin e standardeve të të nxënimit sipas niveleve të përcaktuara të arritjes.

Standardet e arritjes janë hartuar në bazë cikli, që nënkuptojnë arsimin fillor, i cili zgjat në klasat 1-6 dhe arsimin e mesëm të ulët, i cili përfshin klasat 7-9 të arsimit bazë.

Për çdo standard të nxëni janë hartuar standardet e arritjes, duke përfshirë si standardet e përbashkëta të fushës kurrikulare, po ashtu edhe standardet e lëndëve që përbëjnë fushën.

Nivelet e arritjeve përcaktohen në tri shkallë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Këto nivele korrespondojnë përkatësisht me grupnotat: 5-6; 7-8 dhe 9-10.

2. ORGANIZIMI I STANDARDEVE TË ARRITJES

Lënda e Letërsisë zhvillohet e integruar me Gjuhën shqipe nga klasa e parë deri në klasën e gjashtë. Në këto klasa, nxënësit lexojnë, dëgjojnë, flasin dhe shkruajnë tekstin letrar së bashku me llojet e tjera të teksteve. Prandaj standardet e linjave të të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit për klasat 1-6 janë të përbashkëta për të dyja lëndët. Standardet e këtyre linjave për klasat 7-9 i takojnë lëndës së Gjuhës shqipe. Më pas, janë përcaktuar standardet e veçanta të Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë.

3. KËRKESA PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE TË ARRITJES

Standardet e arritjes janë një dokument kurrikular në ndihmë dhe në mbështetje të vlerësimit të arritjeve në procesin e të nxënit. Standardet e arritjes duhet të shërbejnë si dokument orientues në fushat kurrikulare për të hartuar instrumente të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në të dyja ciklet e arsimit bazë. Ato u drejtohen mësuesve, vlerësuesve, inspektorëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme të edukimit.

Hartimi i instrumenteve të vlerësimit të arritjeve në të nxënë duhet kryer duke u mbështetur në nivelet e arritjeve, që janë parashikuar për çdo standard arritjeje.

Niveli bazë përshkruan kriteret që përcaktojnë një zotërim bazik të përmbajtjes së standardeve të të nxënit.

Niveli mesatar përshkruan kriteret që përcaktojnë një zotërim mesatar të qëndrueshëm të përmbajtjes së standardeve të të nxënit.

Niveli i lartë përshkruan kriteret që përcaktojnë një zotërim në nivel të lartë të përmbajtjes së standardeve të të nxënit.

4. PËRMBLEDHJE E STANDARDEVE TË ARRITJES SIPAS CIKLEVE/FUSHAVE DHE LËNDËVE

Në përfundim të klasës së gjashtë në lëndën e Gjuhës shqipe nxënësit:

- lexojnë rrjedhshëm tekste të ndryshme letrare dhe joletrare, të përshtatshme për moshën që kanë;
- analizojnë, gjykojnë dhe shprehin idetë që dalin nga tekstet dhe i lidhin ato me jetën dhe me mjedisin rreth tyre;
- janë folës dhe dëgjues aktivë e korrektë në situata të ndryshme komunikimi;
- shkruajnë tekste të ndryshme në varësi të qëllimit dhe lexuesit;
- shkruajnë, pasi kanë mbledhur dhe përpunuar nga burime të ndryshme, informacionin e nevojshëm;
- përdorin dhe analizojnë rregullat gramatikore;

- përdorin dhe analizojnë dukuritë leksikologjike dhe fjalëformuese;
- respektojnë rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Në përfundim të klasës së nëntë në lëndën e Gjuhës shqipe nxënësit:

- flasin, dëgjojnë, lexojnë dhe shkruajnë për të ndërtuar marrëdhënie ndërvepruese në mjedise të ndryshme komunikimi në shkollë e jashtë saj;
- përmirësojnë shprehitë e tyre në leximin dhe në dëgjimin aktiv e kritik;
- aftësohen me procesin e përfutimit dhe të përdorimit të informacionit, si dhe mësojnë të vlerësojnë e të përdorin shumë lloje burimesh;
- përdorin njohuritë bazë rreth strukturës së gjuhës shqipe dhe të dialekteve të saj;
- përdorin gjuhën standarde në situata dhe për qëllime të ndryshme, si dhe respektojnë, përdorin dhe vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- përdorin fuqinë e medias për të prodhuar imazhe dhe për të formësuar perceptimet e tyre rreth botës.

Në përfundim të klasës së nëntë në lëndën e Letërsisë nxënësit:

- zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit të letërsisë dhe bëhen të vetëdijshëm për shumësinë e mënyrave të perceptimit të botës përreth tyre;
- shprehin në mënyrë të logjikshme mendimet e tyre, kur diskutojnë ose shkruajnë rreth letërsisë;
- analizojnë tiparet e veprave ose fragmenteve të ndryshme letrare në poezi, prozë dhe gjini dramatike, si dhe veçojnë funksionet e këtyre tipareve;
- lexojnë vepra e fragmente nga gjini të ndryshme letrare, si dhe krijimtarinë e disa autorëve klasikë, përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe dhe letërsia botërore;
- shprehin mendimet dhe këndvështrimet e tyre për personazhet e veprës, subjektin, mjedisin, gjuhën, tematikën, stilin.

STANDARDET E PËRBASHKËTA TË FUSHËS ¹⁾

STANDARDET E FUSHËS PËR KLASËN 1-6

LINJA 1: Të folurit

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit flasin qartë, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, si dhe përshtatin të folurit në varësi të dëgjuesit, të situatës dhe të qëllimit që kanë.

Përshkrimi i niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- flasin rrjedhshëm e kuptueshëm në situata të ndryshme, duke shqiptuar saktë tingujt, fjalët, fjalitë, si dhe duke respektuar theksin dhe intonacionin e duhur;
- përcaktojnë qëllimin e të folurit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- flasin duke shqiptuar saktë dhe me theksin e duhur tingujt, fjalët dhe fjalitë, respektojnë në përgjithësi intonacionin e duhur në çdo situatë;
- përcaktojnë me ndihmën e mësuesit qëllimin e të folurit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- flasin duke shqiptuar mirë dhe me theksin e duhur tingujt, fjalët dhe fjalitë.

1. Standardet e të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit për klasat 1-6 janë standarde të përbashkëta të fushës. Standardet e këtyre linjave për klasat 7-9 i takojnë vetëm lëndës së Gjuhës shqipe.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit planifikojnë dhe paraqesin ide dhe informacione për qëllime të ndryshme, duke pranuar e respektuar edhe idetë dhe pikëpamjet e të tjerëve.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përdorin forma të larmishme dhe të përshtatshme komunikimi, si dhe vlerësojnë me fjalë të thjeshta të folurin e tyre dhe atë të tjerëve;
- renditin logjikisht idetë, ndjesitë dhe informacionin dhe shoqërojnë të folurit edhe me elemente pamore, si: imazhe, foto, tabela, harta, grafikë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin forma të ndryshme gjatë komunikimit, si dhe analizojnë të folurin e tyre dhe atë të të tjerëve;
- renditin në përgjithësi idetë, ndjesitë dhe informacionin në mënyrë logjike dhe në disa raste e pasurojnë të folurit edhe me elemente pamore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- komunikojnë thjesht dhe analizojnë me ndihmën e mësuesit të folurit të tyre dhe atë të të tjerëve;
- flasin pa i renditur mirë idetë, ndjesitë dhe informacionin dhe shumë rrallë e shoqërojnë të folurin e tyre me elemente pamore.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit flasin në mjedise të ndryshme komunikimi, në grupe të vogla, në grupe të gjera dhe në publik, si dhe ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi dhe ndërveprimi me të tjerët.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- bashkëbisedojnë lirshëm për çështje të ndryshme, në mjedise të ndryshme komunikimi, si dhe zgjedhin tema që janë interesante për ta;

- argumentojnë mendimet dhe këndvështrimet e tyre dhe vlerësojnë pas diskutimeve, kontributet e njëri-tjetrit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- bashkëbisedojnë në mjedise të ndryshme komunikimi, për çështje të ndryshme, marrin pjesë në diskutime në grup, por nuk janë ata që përzgjedhin temën dhe marrin iniciativë;
- japin mendimet dhe këndvështrimet e tyre me fjalë të thjeshta dhe veçojnë kontributet e njëri-tjetrit gjatë diskutimit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- janë të tërhequr në mjedise të ndryshme komunikimi;
- japin me fjalë të thjeshta mendimet dhe këndvështrimet e tyre, vetëm kur kjo i kërkohet.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit përdorin njohuritë gjuhësore gjatë të folurit, si edhe elementet joverbale (gjestet, mimikën, kontaktin me sy) për të komunikuar në mënyrë të efektshme.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përdorin fjalët dhe frazat e duhura për të komunikuar qartë dhe për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit;
- shprehin mendimet e tyre me një fjalor të pasur e shprehës;
- shoqërojnë gjithmonë të folurin me elemente joverbale, si: shprehjet e fytyrës, gjestet dhe lëvizjet e trupit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin mirë fjalët dhe fjalitë për të komunikuar qartë dhe tërheqin në përgjithësi vëmendjen e dëgjuesit;
- shprehin mendimet e tyre me një fjalor korrekt dhe disi shprehës;
- përdorin gjatë komunikimit disa elemente joverbale.

Niveli bazë

Nxënësit:

- flasin me një fjalor të varfër dhe në përgjithësi nuk tërheqin vëmendjen e dëgjuesit;
- përdorin gjatë komunikimit pak elemente joverbale.

LINJA 2: Të dëgjuarit**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit janë dëgjues aktivë në grupe formale dhe joformale, për të marrë informacion nga një shumëllojshmëri burimesh, në situata të ndryshme.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- dëgjojnë të tjerët me vëmendje dhe dëshirë, kryesisht në situata joformale, në grupe të vogla dhe të gjera për të marrë informacion.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dëgjojnë në përgjithësi me vëmendje, kryesisht në situata joformale, në grupe të vogla dhe të gjera për të marrë informacion.

Niveli bazë

Nxënësit:

- shfaqin pak vëmendje dhe përfshihen me vështirësi në grupe të vogla dhe të gjera.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit shfaqin qëndrime dhe sjellje pozitive gjatë të dëgjuarit duke treguar vëmendje, respekt dhe mirëkuptim ndaj folësit ose ndaj teksteve që dëgjojnë në media të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- dëgjojnë në mënyrë aktive tekste të përshtatshme për moshën e tyre, në bashkëbisedime, kryesisht në situata joformale dhe nga

media, si dhe demonstrojnë gjatë gjithë kohës qëndrime dhe sjellje të përshtatshme: vëmendje, kontakt me sy, mbajtje të trupit në pozicion korrekt;

- tregojnë respekt dhe interes ndaj bashkëbiseduesit duke e inkurajuar me fjalë e shprehje të thjeshta atë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dëgjojnë tekste të përshtatshme për moshën e tyre, në bashkëbisedime, në situata joformale e në media dhe në përgjithësi demonstrojnë qëndrime dhe sjellje të përshtatshme: vëmendje, kontakt me sy, mbajtje të trupit në pozicion korrekt;
- tregojnë respekt dhe interes ndaj bashkëbiseduesit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përfshihen me vështirësi në dëgjimin e teksteve të përshtatshme për moshën e tyre dhe nuk shfaqin përgjatë gjithë kohës: vëmendje, kontakt me sy, mbajtje të trupit në pozicion korrekt.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit kuptojnë dhe vlerësojnë tekstin që dëgjojnë

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përmbledhin me fjalët e tyre tekstet që dëgjojnë duke i ilustruar më fragmente dhe detaje, krahasojnë informacionin e dëgjuar me njohuritë e tyre të mëparshme, bëjnë disa përgjithësime të thjeshta, analizojnë këndvështrime të ndryshme gjatë të dëgjuarit dhe japin këndvështrime e pikëpamje të tjera;
- bëjnë dallimin mes shkakut dhe pasojës, gjejnë problemin dhe zgjidhjen, dallojnë faktet nga opinionet;
- dallojnë strategjitë e folësit, analizojnë efektin e tyre tek ata, si dhe shpjegojnë se si elementet joverbale i ndihmojnë për të kuptuar tekstin.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përmbledhin me fjalët e tyre tekstet duke i ilustruar me pak fragmente dhe detaje nga teksti, krahasojnë informacionin e dëgjuar me njohuritë e tyre të mëparshme, dallojnë këndvështrime të ndryshme gjatë të dëgjuarit dhe japin këndvështrime dhe pikëpamje të tjera;
- bëjnë dallimin mes shkakut dhe pasojës, gjejnë problemin dhe zgjidhjen;
- dallojnë strategjitë e folësit dhe elementet joverbale që i ndihmojnë ata për të kuptuar tekstin.

Niveli bazë

Nxënësit:

- ritregojnë tekstin duke u ndalur edhe në detaje të parëndësishme, si dhe lidhin informacionin e dëgjuar me njohuritë e tyre të mëparshme;
- dallojnë me vështirësi shkakun dhe pasojën, si dhe gjejnë me ndihmën e mësuesit problemin dhe zgjidhjen.

LINJA 3: Të lexuarit**Standardi i të nxënës 1**

Nxënësit zbatojnë njohuritë për shkronjat, tingujt, fjalët, fjalitë dhe tekstin për të lexuar në mënyrë të pavarur, për të marrë informacion dhe për kënaqësi estetike.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- drejtshqiptojnë tingujt, lexojnë rrjedhshëm, përdorin gjithmonë theksin në fjalët e reja dhe në fjalët e njohura;
- dallojnë kuptimet e të gjitha fjalëve dhe shprehjeve në tekstet që lexojnë;
- kërkojnë informacion në botimet që i tërheqin, lexojnë të drejtuar nga mësuesi dhe në mënyrë të pavarur e për kënaqësi estetike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- drejtshqiptojnë tingujt, lexojnë rrjedhshëm dhe përdorin drejt theksin në fjalët e njohura;
- dallojnë dhe interpretojnë kuptimin e pjesës më të madhe të fjalëve dhe shprehjeve në tekstet që lexojnë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- lexojnë në përgjithësi rrjedhshëm, përdorin në përgjithësi drejt theksin në fjalët e njohura;
- përdorin kontekstin për të dalluar kuptimin e fjalëve të ndryshme, si dhe gjejnë me vështirësi sinonime dhe antonime me fjalët e dhëna.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit përdorin strategjitë e të lexuarit për të marrë, kuptuar, interpretuar, vlerësuar dhe gjykuar në mënyrë kritike informacionin e duhur.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- interpretojnë, analizojnë dhe vlerësojnë tekste letrare dhe joletrare të përshtatshme për klasën e gjashtë;
- dallojnë me lehtësi idetë dhe temat kryesore të një teksti, si dhe i ilustrojnë ato me shembuj dhe detaje nga teksti;
- përmbledhin me fjalët e tyre informacionin kryesor të një teksti;
- vlerësojnë dhe japin këndvështrimet e tyre në lidhje me tematikën dhe idetë e tekstit;
- lidhin në mënyrë intuitive informacionin e tekstit me njohuritë dhe përvojat e tyre;
- krahasojnë tekste të ndryshme, veçojnë qëllimin e autorit, si dhe dallojnë lehtësisht shkakun dhe pasojën.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- interpretojnë, analizojnë tekste të ndryshme letrare dhe joletrare të përshtatshme për moshën e tyre;
- dallojnë temat dhe idetë kryesore në një tekst, por nuk i mbështesin me shumë detaje dhe ilustrime nga teksti;

- përmbledhin informacionin e një teksti, megjithatë ata duhet të punojnë më shumë për ta shprehur atë me fjalët e tyre;
- dallojnë me vështirësi shkakun nga pasoja dhe qëllimin e autorit në një tekst;
- bëjnë pyetje me qëllim që të lidhin informacionin e tekstit që lexojnë me njohuritë dhe përvojat e tyre.

Niveli bazë

Nxënësit:

- interpretojnë dhe analizojnë mjaftueshëm tekste letrare dhe joletrare;
- identifikojnë temën kryesore në një tekst;
- ritregojnë thjesht tekstin që lexojnë, pa mundur të përmbledhin idetë kryesore;
- parashikojnë rreth teksteve duke u mbështetur më shumë në njohuritë paraprake, se sa në tekst;
- kërkojnë disa shembuj konkretë që të dallojnë shkakun dhe pasojën;
- bëjnë krahasime të thjeshta brenda tekstit;
- dallojnë qëllimin e autorit vetëm nëse u jepen një listë alternativash ose zgjidhjesh.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, të letërsisë shqipe dhe asaj botërore.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- lexojnë me interes lloje të ndryshme tekstesh letrare dhe joletrare, shqipe dhe botërore për të pasuruar përvojën letrare dhe për tema dhe çështje që iu interesojnë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- lexojnë tekste letrare dhe joletrare që janë të rekomanduara nga mësuesi/ja ose që janë lexime jashtëklase.

Niveli bazë

Nxënësit:

- shfaqin pak interes për të lexuar tekste letrare dhe joletrare.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit dallojnë karakteristikat dhe elementet stilistike të teksteve, si dhe sqarojnë funksionet e tyre.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- analizojnë karakteristikat e teksteve dhe elementet letrare dhe stilistike të tyre.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dallojnë karakteristikat e teksteve dhe elementet stilistike të teksteve.

Niveli bazë

Nxënësit:

- veçojnë me ndihmën e mësuesit/es karakteristikat e teksteve.

LINJA 4: Të shkruarit**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit mbledhin dhe për zgjedhin ide dhe informacione nga burime të ndryshme, për të shkruar për qëllime, lexues dhe kontekste të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- mbledhin kryesisht në mënyrë të pavarur fakte, informacione, komente nga një ose më shumë burime të shtypura ose digjitale për punët dhe për detyrat me shkrim;
- rendisin ose klasifikojnë informacionin gjatë përgatitjes për punën ose detyrën me shkrim, në mënyrë që të sigurojnë koherencë gjatë të shkruarit;

- analizojnë informacionin e mbledhur , si dhe kërkojnë informacion shtesë, kur është e nevojshme.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- mbledhin me ndihmën e mësuesve fakte, informacione dhe komente nga burime të mjaftueshme, si punë paraprake për detyrën me shkrim;
- rendisin informacionin gjatë përgatitjes për punën ose detyrën me shkrim, në mënyrë që të sigurojnë koherencë gjatë të shkruarit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- mbledhin informacione të pakta nga burime të rekomanduara nga mësuesi/ja, për punën dhe detyrat me shkrim.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit zhvillojnë dhe organizojnë punë me shkrim, koherente dhe të mirëstrukturuara.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shkruajnë duke u përqendruar te tema dhe te lexuesit;
- shkruajnë saktë, me qartësi logjike dhe strukturore (brenda dhe mes paragrafëve) lloje të ndryshme punësh dhe detyrash me shkrim;
- mbështesin idetë e tyre me detaje e shembuj të shumtë, kur është e nevojshme i shoqërojnë me figura, grafikë, tabela, ilustrime;
- përdorin një gjuhë shprehëse dhe fjalor të pasur, përdorin në mënyrë të qëllimshme lloje të ndryshme fjalish, respektojnë rregullat drejtshkrimore dhe përdorin në përgjithësi gjuhën standarde gjatë të shkruarit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shkruajnë saktë dhe qartë dhe përpiqen të respektojnë strukturën e punës me shkrim;

- mbështesin idetë e tyre me detaje, të cilat shpesh nuk janë të përzgjedhura dhe kur është e nevojshme i shoqërojnë me figura, grafikë dhe ilustrime të thjeshta;
- përpiqen të zgjedhin fjalët dhe fjalorin e përshtatshëm, përdorin fjali të thjeshta dhe të shkurtra, bëjnë gabime të rralla drejtshkrimore, por që nuk cenojnë të kuptuarit e tekstit, si dhe përdorin kryesisht në mënyrë korrekte gjuhën standarde.

Niveli bazë

Nxënësit:

- shfaqin probleme në qartësinë dhe në strukturën e tekstit gjatë të shkruarit;
- mbështetin idetë e tyre me detaje të pakta;
- shprehen me një gjuhë të varfër në punët me shkrim;
- shfaqin dobësi në njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore dhe në përdorimin e gjuhës standarde gjatë të shkruarit.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit rishikojnë dhe përmirësojnë punët e tyre me shkrim, duke rregulluar gabimet drejtshkrimore, duke përmirësuar të shprehurit dhe duke rishikuar strukturën dhe qartësinë e fjalive.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përdorin reagimet dhe gjykimet e të tjerëve për të rishikuar dhe për të redaktuar punët dhe detyrat me shkrim;
- rilexojnë punën me shkrim për të rishikuar, shtuar ose hequr fjalë a fjali, në mënyrë që ta bëjnë më të qartë dhe më tërheqëse punën e tyre dhe shmangin gabimet drejtshkrimore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- rilexojnë punën me shkrim dhe shtojnë ndonjë fjalë për ta bërë më shprehëse punën me shkrim, si dhe shmangin në përgjithësi gabimet drejtshkrimore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- rilexojnë nën kujdesin e mësuesit dhe shmangin disa nga gabimet drejtshkrimore.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit shkruajnë duke përdorur forma të ndryshme në varësi të qëllimit që kanë dhe lexuesve që iu drejtohen.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- zgjedhin të shkruajnë histori të shkurtra, poezi ose pjesë për lojë me role në varësi të qëllimit dhe të lexuesit;
- shkruajnë përshkrime të hollësishme të njerëzve, ngjarjeve ose sendeve që janë të dashura për ta duke përdorur ilustrimet përkatëse, dialogun, gjuhë shprehëse ose fjalor të pasur;
- shkruajnë tekste (me disa paragrafë), si: letra, kartolina, njoftime, udhëzime etj., duke i shoqëruar edhe me harta, tabela, grafikë, ilustrime, foto.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shkruajnë me ndihmën e mësuesit/es histori të shkurtra, poezi ose pjesë për lojë me role në varësi të qëllimit dhe të lexuesit;
- shkruajnë përshkrime njerëzve, ngjarjeve ose sendeve që janë të dashura për ta;
- shkruajnë tekste të thjeshta, si: letra, kartolina, njoftime, udhëzime etj., duke i shoqëruar edhe me harta, tabela, grafikë, ilustrime, foto.

Niveli bazë

Nxënësit:

- shkruajnë me ndihmën e mësuesit/es histori të shkurtra, poezi ose pjesë për lojë me role, në varësi të qëllimit dhe të lexuesit;
- shkruajnë përshkrime të njerëzve, ngjarjeve ose sendeve që janë të dashura për ta, duke përdorur ilustrimet përkatëse;

- shkruajnë tekste të thjeshta, si: letra, kartolina, njoftime, udhëzime etj., duke i shoqëruar edhe me harta, tabela, grafikë, ilustrime, foto, por i përmbahen me vështirësi strukturës dhe karakteristikave të këtyre teksteve.

Standardi i të nxënit 5

Nxënësit përdorin mënyra e forma të ndryshme për prezantimin e punëve me shkrim, duke përfshirë edhe elemente të TIK-un.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- realizojnë punë me shkrim duke përdorur TIK-un.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- realizojnë punë të thjeshta me shkrim duke përdorur TIK-un, me ndihmën e mësuesve ose të rriturve.

Niveli bazë

Nxënësit:

- realizojnë më vështirësi punë të thjeshta me shkrim duke përdorur TIK-un, edhe kur kanë ndihmën e mësuesve ose të rriturve.

STANDARDET E FUSHËS PËR KLASËN 7-9

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit flasin qartë, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, si dhe përshtatin të folurit në varësi të dëgjuesit, të situatës dhe të qëllimit që kanë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- flasin qartë, rrjedhshëm, me intonacionin e duhur dhe duke respektuar theksin e fjalëve dhe fjalive;

- përdorin pauzat (pushimet) dhe ndryshojnë ritmin, tonin ose volumin e zërit gjatë të folurit për të nxjerrë në pah ose për të theksuar një ide;
- përzgjedhin fjalët në varësi të qëllimit, të dëgjuesit dhe të situatës (formale dhe joformale) dhe janë koherentë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- flasin në përgjithësi qartë, rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, duke respektuar theksin e fjalëve dhe fjalive;
- ndryshojnë ndonjëherë ritmin, tonin ose volumin e zërit gjatë të folurit për të nxjerrë në pah ose për të theksuar një ide;
- përcaktojnë qëllimin e të folurit dhe përshtatin të folmen e tyre në varësi të rrethanave.

Niveli bazë

Nxënësit:

- flasin qartë, rrjedhshëm, me intonacionin e duhur dhe duke respektuar në përgjithësi theksin e fjalëve;
- përzgjedhin me vështirësi fjalët në funksion të qëllimit, rrethanës dhe dëgjuesit.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit planifikojnë dhe paraqesin ide dhe informacione për qëllime të ndryshme, duke pranuar e respektuar edhe idetë dhe pikëpamjet e të tjerëve.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- mbledhin, përzgjedhin e vlerësojnë fakte dhe ide nga shumë burime të shtypura dhe elektronike për prezantimet e tyre me gojë;
- organizojnë qartë mendimet, idetë dhe ndjesitë e tyre në mënyra e forma të ndryshme për të mbështetur qëllimin dhe për të siguruar vëmendjen e dëgjuesit;
- përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit gjatë prezantimit të projekteve ose detyrave në grup.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- mbledhin dhe përzgjedhin fakte e ide në pak burime të shtypura dhe elektronike për prezantimet e tyre me gojë;
- organizojnë mirë mendimet, idetë dhe ndjesitë e tyre në disa mënyra e forma të ndryshme për të mbështetur qëllimin dhe për të siguruar vëmendjen e dëgjuesit;
- përdorin me ndihmën e mësuesit Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit gjatë prezantimit të projekteve ose detyrave në grup.

Niveli bazë

Nxënësit:

- mbledhin pak informacione për prezantimet e tyre me gojë;
- organizojnë mjaftueshëm mendimet, idetë dhe ndjesitë e tyre dhe janë të varfër në zgjedhjen e mënyrave dhe formave të prezantimit;
- përdorin me vështirësi Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në prezantime projektsh ose detyrash të ndryshme në grup.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit flasin në mjedise të ndryshme komunikimi, në grupe të vogla, në grupe të gjera dhe në publik, si dhe ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi dhe ndërveprimi me të tjerët.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- bashkëbisedojnë lirshëm duke dhënë mendimet dhe këndvështrimet e tyre dhe vlerësuar edhe mendimin ndryshe;
- përcaktojnë dhe ndjekin rregullat gjatë diskutimit në grup, ndajnë rolet gjatë diskutimeve, ndajnë detyrat në punë e projekte të ndryshme në klasë;
- vlerësojnë dhe japin ndihmesë në situata mosmarrëveshesh, pasurojnë linjën e debatit me argumente dhe respektojnë etikën.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- bashkëbisedojnë për të dhënë mendimet e tyre duke u nxitur nga të tjerët;

- ndjekin në përgjithësi rregullat gjatë diskutimit në grup, pranojnë rolet gjatë diskutimeve, pranojnë detyrat në punë e projekte të ndryshme në klasë;
- japin argumentet e tyre në një debat duke respektuar etikën.

Niveli bazë

Nxënësit:

- bashkëbisedojnë dhe ndërveprojnë pak me të tjerët dhe japin me fjalë të thjeshta mendimet dhe këndvështrimet e tyre.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit përdorin njohuritë gjuhësore gjatë të folurit, si edhe elementet joverbale (gjestet, mimikën, kontaktin me sy) për të komunikuar në mënyrë të efektshme.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- zgjedhin dhe përdorin mirë format e gjuhës së folur, fjalorin teknik, regjistrin formal dhe joformal etj., në varësi të situatës dhe të qëllimit;
- shprehin mendimet e tyre me një fjalor të pasur duke përdorur: shprehje frazeologjike, fjalë të urta, fjalë me kuptim të figurshëm etj;
- përdorin gjuhën standarde gjatë të folurit dhe shmangin fjalët e huaja dhe dialektore;
- flasin me shprehjen e duhur të fytyrës, gjuhën e trupit dhe gjestet e përshtatshme, në mënyrë që të mos japin mesazhe të gabuara.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- zgjedhin dhe përdorin në përgjithësi format e gjuhës së folur, fjalorin teknik, regjistrin formal dhe joformal etj., në varësi të situatës dhe të qëllimit;
- shprehin mendimet e tyre me një fjalor korrekt;
- përdorin mirë gjuhën standarde gjatë të folurit dhe shmangin në përgjithësi fjalët e huaja dhe ato dialektore;

- flasin me shprehjen e duhur të fytyrës, gjuhën e trupit dhe gjestet e përshtatshme, në mënyrë që të mos japin mesazhe të gabuara.

Niveli bazë

Nxënësit:

- zgjedhin dhe përdorin me vështirësi format e gjuhës së folur, fjalorin teknik, regjistrin formal dhe joformal etj., në varësi të situatës dhe të qëllimit;
- shprehin mendimet e tyre me një fjalor të varfër;
- shmangen shpesh nga gjuha standarde gjatë të folurit;
- përdorin pak shprehjen e duhur të fytyrës, gjuhën e trupit dhe gjestet e përshtatshme.

LINJA 2: Të dëgjuarit

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit janë dëgjues aktivë në grupe formale dhe joformale, për të marrë informacion nga një shumëllojshmëri burimesh, në situata të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- dëgjojnë të tjerët me vëmendje dhe dëshirë, kryesisht në situata formale dhe joformale, në grupe të vogla dhe të mëdha për të marrë informacione, udhëzime, orientime.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dëgjojnë të tjerët me vëmendje, kryesisht në situata formale dhe joformale, në grupe të vogla dhe të mëdha për të marrë informacione, udhëzime, orientime.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dëgjojnë të tjerët pa shumë interes dhe përfshihen me vështirësi në situata formale dhe joformale, në grupe të vogla dhe të mëdha.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit shfaqin qëndrime dhe sjellje pozitive gjatë të dëgjuarit duke treguar vëmendje, respekt dhe mirëkuptim ndaj folësit ose ndaj teksteve që dëgjojnë në media të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- dëgjojnë me interes tekste të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre, në situata formale e joformale, në media, si dhe shfaqin vëmendje, interes, empati me fjalë dhe me shprehje inkurajuese;
- përdorin në mënyrë korrekte gjuhën e trupit, kontaktin me sy dhe mimikën e duhur të fytyrës që të mos japin mesazhe negative të folësit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dëgjojnë tekste të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre, në situata formale e joformale, në media, si dhe shfaqin vëmendje, interes, empati;
- përdorin në përgjithësi në mënyrë korrekte gjuhën e trupit, kontaktin me sy dhe mimikën e duhur gjatë të dëgjuarit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dëgjojnë tekste të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre, në situata formale e joformale dhe në media;
- përdorin në përgjithësi në mënyrë korrekte gjuhën e trupit, kontaktin me sy dhe mimikën e duhur gjatë të dëgjuarit.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit kuptojnë dhe vlerësojnë tekstin që dëgjojnë

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- përmbledhin me fjalët e tyre tekstet që dëgjojnë duke i ilustruar më fragmente dhe detaje, krahasojnë informacionin e dëgjuar me

njohuritë e tyre të mëparshme, bëjnë disa përgjithësime të thjeshta, analizojnë këndvështrime të ndryshme gjatë të dëgjuarit dhe japin këndvështrime e pikëpamje të tjera;

- bëjnë dallimin mes shkaktit dhe pasojës, gjejnë problemin dhe zgjidhjen, dallojnë faktet nga opinionet;
- dallojnë strategjitë e folësit, analizojnë efektin e tyre tek ata, si dhe shpjegojnë se si elementet joverbale i ndihmojnë për të kuptuar tekstin.

LINJA 3: Të lexuarit

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit zbatojnë njohuritë për shkronjat, tingujt, fjalët, fjalitë dhe tekstin për të lexuar në mënyrë të pavarur, për të marrë informacion dhe për kënaqësi estetike.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- lexojnë rrjedhshëm dhe me shprehësi tekste të llojeve të ndryshme, si dhe përdorin gjithnjë drejt theksin logjik;
- dallojnë lehtësisht kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve, si dhe gjejnë sinonimet dhe antonimet e tyre;
- dallojnë nuancat kuptimore të fjalëve në tekste të ndryshme;
- lexojnë për qëllime të ndryshme, janë të motivuar, kureshtarë, të pavarur dhe shfaqin interes për leximin.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- lexojnë rrjedhshëm dhe me shprehësi tekste të llojeve të ndryshme, përdorin në përgjithësi drejt theksin logjik;
- përdorin të dhënat kontekstuale dhe strategji të tjera për të dalluar kuptimet e fjalëve dhe shprehjeve të ndryshme;
- gjejnë kuptime të tjera të fjalëve dhe shprehjeve të ndryshme në tekst;
- zgjedhin dhe lexojnë tekste të ndryshme për kënaqësi dhe për informacion.

Niveli bazë

Nxënësit:

- lexojnë rrjedhshëm tekste të llojeve të ndryshme, përdorin rrallë theksin logjik;
- përdorin të dhënat kontekstuale për të dalluar kuptimet e fjalëve dhe shprehjeve të ndryshme;
- lexojnë tekste të thjeshta që u rekomandohen nga mësuesi për informacion dhe për kënaqësi.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit përdorin strategjitë e të lexuarit për të marrë, kuptuar, interpretuar, vlerësuar dhe gjykuar në mënyrë kritike informacionin e duhur.

Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- dallojnë lehtësisht tekstet letrare nga tekstet joletrare dhe përzgjedhin strategjitë e duhura për t'i kuptuar ato;
- interpretojnë, analizojnë dhe vlerësojnë tekste të përshtatshme për moshën e tyre;
- veçojnë me lehtësi idetë dhe çështjet kryesore, duke i ilustruar me detaje dhe shembuj të shumtë nga teksti;
- përmbledhin me fjalët e tyre çështjet kryesore të një teksti;
- bëjnë parashikime rreth tekstit që lexojnë duke siguruar prova të shumta në tekst për të mbështetur përgjigjet e tyre;
- dallojnë lehtësisht shkakun nga pasoja, faktin nga opinioni, si dhe bëjnë krahasime brenda dhe mes teksteve;
- dallojnë dhe analizojnë qëllimin e autorit dhe vlerësojnë mjetet që përdor ai në tekst;
- zgjerojnë dhe e përdorin informacionin përtej tekstit, bëjnë përgjithësime duke përdorur detaje të shumta nga burime të ndryshme;
- përdorin lehtësisht informacionin dhe konceptet që kanë marrë nga një tekst në situata dhe tekste të reja;
- dallojnë dhe analizojnë qëllimin e autorit në një tekst duke e ilustruar mendimin e tyre me detaje nga teksti;
- lidhin në mënyrë intuitive njohuritë dhe përvojat personale me tekstin që po lexojnë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- interpretojnë dhe analizojnë tekste të përshtatshme për moshën e tyre;
- lidhin tekstin me veten, me njohuritë e tyre dhe me botën në përgjithësi;
- dallojnë idetë dhe temat kryesore, si dhe janë në gjendje të gjejnë informacionin mbështetës;
- përmbledhin tekstin duke dhënë detaje nga teksti;
- bëjnë parashikime rreth teksteve që lexojnë, por nuk mbështesin dhe argumentojnë shumë idetë e tyre;
- dallojnë shkakun dhe pasojën, faktin dhe opinionin, brenda tekstit;
- dallojnë qëllimin e autorit, por nuk veçojnë të gjitha mjetet që përdor autori.

Niveli bazë

Nxënësit:

- interpretojnë tekste të përshtatshme për moshën e tyre;
- shprehin me një gjuhë të thjeshtë mendimet dhe idetë e tyre, pasi lexojnë një tekst;
- dallojnë temat dhe idetë kryesore në një tekst;
- përmbledhin tekstin duke dhënë pak detaje prej tij;
- bëjnë parashikime jo të argumentuara rreth teksteve që lexojnë;
- dallojnë me vështirësi shkakun dhe pasojën, faktin dhe opinionin brenda tekstit;
- dallojnë qëllimin e autorit, por nuk veçojnë të gjitha mjetet që ai përdor.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe jolettrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, të letërsisë shqipe dhe asaj botërore.

Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- lexojnë në mënyrë të pavarur për tema të ndryshme, literaturë tradicionale dhe bashkëkohore, duke përdorur TIK-un dhe burimet

tradicionale të informimit, për t'u njohur me përvojën njerëzore dhe me mundësitë në jetë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- lexojnë të drejtuar nga mësuesi/ja për tema të ndryshme, literaturë tradicionale dhe bashkëkohore, duke përdorur TIK-un dhe burimet tradicionale të informimit, për t'u njohur me përvojën njerëzore dhe me mundësitë në jetë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- lexojnë tekstet dhe fragmentet që janë të detyrueshme.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit dallojnë karakteristikat dhe elementet stilistike të teksteve, si dhe sqarojnë funksionet e tyre.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë dhe vlerësojnë karakteristika të ndryshme të teksteve;
- analizojnë dhe vlerësojnë mjetet stilistike të tekstit dhe sqarojnë funksionit e tyre.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- veçojnë karakteristikat e ndryshme të teksteve;
- dallojnë mjetet stilistike të tekstit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- veçojnë disa karakteristika të ndryshme të teksteve;
- dallojnë me vështirësi mjetet stilistike të tekstit.

LINJA 4: Të shkruarit**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit mbledhin dhe për zgjedhin ide dhe informacione nga burime të ndryshme, për të shkruar për qëllime, lexues dhe kontekste të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- mbledhin në mënyrë të pavarur informacion nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, klasifikojnë burimet e informacionit në të rëndësishme dhe dytësore;
- kryejnë në mënyrë të pavarur intervista me specialistë që kanë njohuri për temën ose me dëshmitarë në një ngjarje;
- citojnë në punën ose në detyrën me shkrim burimet e informacionit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- mbledhin, kryesisht në mënyrë të pavarur, informacion nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, klasifikojnë burimet e informacionit në të rëndësishme dhe dytësore;
- citojnë më ndihmën e mësuesit/es, burimet e informacionit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- mbledhin të drejtuar nga mësuesi/ja, informacion nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, si dhe e klasifikojnë me vështirësi informacionin kryesor.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit zhvillojnë dhe organizojnë punë me shkrim, koherente dhe të mirëstrukturuara.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- shkruajnë duke u përqendruar te tema, lexuesit, qëllimi dhe këndvështrimi i tyre;

- rendisin dhe organizojnë në paragrafë idetë kryesore duke i ilustruar dhe duke i mbështetur me detaje, shembuj, fakte dhe opinione të ndryshme;
- shkruajnë duke siguruar lidhje logjike mes fjalive e paragrafëve dhe respektojnë strukturën e punës me shkrim;
- përzgjedhin fjalë dhe fraza që i japin punës gjallëri e shprehësi, përdorin lloje të ndryshme fjalish (lloj, gjatësi, strukturë) për të shtuar interesin e lexuesit dhe për të përmirësuar rrjedhën e punës me shkrim;
- zbatojnë gjatë të shkruarit njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore dhe përdorin gjuhën standarde gjatë të shkruarit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shkruajnë duke u përqendruar në përgjithësi te tema, te lexuesit dhe te qëllimi;
- rendisin dhe organizojnë në paragrafë idetë kryesore, por nuk i ilustrojnë me detaje dhe shembuj të shumtë;
- shkruajnë duke respektuar strukturën e punës me shkrim;
- përzgjedhin fjalë dhe fraza të zgjedhura, si dhe përdorin lloje të ndryshme fjalish (lloj, gjatësi, strukturë);
- zbatojnë gjatë të shkruarit në përgjithësi njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore dhe përdorin gjuhën standarde gjatë të shkruarit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- e kanë të vështirë të përqendrohen te tema, te lexuesit dhe te qëllimi i tyre gjatë të shkruarit;
- organizojnë në paragrafë idetë kryesore, por i mbështesin me pak detaje;
- zbatojnë me vështirësi strukturën e punës me shkrim;
- shkruajnë me një fjalor të thjeshtë, pa shumë emocione, me fjali të thjeshta dhe të shkurtra, bëjnë disa gabime drejtshkrimore dhe shfaqin probleme në përdorimin e gjuhës standarde.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit rishikojnë dhe përmirësojnë punët e tyre me shkrim, duke rregulluar gabimet drejtshkrimore, duke përmirësuar të shprehurit dhe duke rishikuar strukturën dhe gjatësinë e fjalive.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- diskutojnë në mënyrë aktive me të tjerët rreth asaj që kanë shkruar për të përmirësuar aftësitë e të shkruarit;
- redaktojnë punën me shkrim, duke u ndalur në: përqendrimin te tema, riorganizimin e tekstit, gjetjen e fjalëve më të përshtatshme, gabimet gramatikore dhe drejtshkrimore;
- përdorin njohuritë që kanë për cilësitë e mira të një pune me shkrim (ose modele të mira) për të përmirësuar punën e tyre.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë punët e tyre me shkrim me ndihmën e mësuesve dhe përcaktojnë disa elementë që duhen përmirësuar në punën me shkrim;
- përdorin njohuritë që kanë për cilësitë e mira të një pune me shkrim (ose modele të mira) për të përmirësuar punën e tyre.

Niveli bazë

Nxënësit:

- rishikojnë punët e tyre, por mbeten kryesisht në ndreqjen e disa gabimeve drejtshkrimore dhe nuk bëjnë përpjekje për të përmirësuar anë të tjera të detyrës ose punës me shkrim.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit shkruajnë duke përdorur forma të ndryshme në varësi të qëllimit që kanë dhe lexuesve që iu drejtohen.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- shkruajnë duke zbatuar formën, strukturën dhe karakteristikat e teksteve të tilla (me disa paragrafë) si: letra formale dhe joformale,

përshkrime, raporte, udhëzime, ese, artikuj, intervista, rrëfime ngjarjesh, ku mund të pasqyrojnë p.sh., shkakun dhe pasojat, të gjejnë zgjidhjet e një problemi (kur përshtatet me temën) dhe i shoqërojnë me harta, tabela, grafikë, ilustrime, foto;

- shkruajnë tekste në të cilat shprehin opinione dhe fakte si dhe japin argumente për të bindur lexuesin;
- shkruajnë të njëjtin subjekt ose tematikë për lexues të ndryshëm dhe forma të ndryshme.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shkruajnë duke zbatuar në përgjithësi formën, strukturën dhe karakteristikat e teksteve të tilla si (me disa paragrafë) letra, përshkrime, raporte, udhëzime, ese, artikuj, intervista, rrëfime ngjarjesh ku mund të pasqyrojnë, p.sh., shkakun dhe pasojat, të gjejnë zgjidhjet e një problemi (kur përshtatet me temën) dhe i shoqërojnë me harta, tabela, grafikë, ilustrime, foto;
- shkruajnë tekste bindëse në të cilat shprehin opinione dhe fakte, si dhe japin disa argumente për të bindur lexuesin.

Niveli bazë

Nxënësit:

- shkruajnë letra, përshkrime, raporte, udhëzime, ese, artikuj, intervista, rrëfime ngjarjesh, ku mund të pasqyrojnë, p.sh., shkakun dhe pasojat, të gjejnë zgjidhjet e një problemi (kur përshtatet me temën) dhe i shoqërojnë me harta, tabela, grafikë, ilustrime, foto;
- shkruajnë tekste bindëse në të cilat shprehin opinione dhe fakte.

Standardi i të nxënit 5

Nxënësit përdorin mënyra e forma të ndryshme për prezantimin e punëve me shkrim, duke përfshirë edhe elemente të TIK-ut.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- prezantojnë në mënyrë të pavarur punët me shkrim duke përfshirë elemente të TIK-ut (përfshirë edhe internetin), kryesisht me anë të programeve: Word, PowerPoint.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- prezantojnë punët me shkrim duke përfshirë elemente të TIK-ut (përfshirë edhe internetin), duke përdorur kryesisht programet Word, PowerPoint.

Niveli bazë

Nxënësit:

- prezantojnë punë të thjeshta me shkrim duke përfshirë elemente të TIK-ut (përfshirë edhe internetin), kryesisht me anë të programeve Word, PowerPoint.

STANDARDET E GJUHËS SHQIPE

STANDARDET E ARRITJEVE PËR LËNDËN E GJUHËS SHQIPE PËR KLASËN 1-6

LINJA: Njohuri rreth sistemit gjuhësor**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit.

Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- gjejnë dhe analizojnë emrin, mbiemrin, foljen dhe përemrin sipas kategorive të tyre gramatikore;
- gjejnë ndajfoljet, lidhëzat, parafjalët dhe pasthirrmat më të përdorshme.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- gjejnë saktë emrin, mbiemrin, foljen dhe përemrin sipas kategorive të tyre gramatikore;
- gjejnë ndajfoljet, lidhëzat dhe parafjalët më të përdorshme.

Niveli bazë

Nxënësit:

- gjejnë me ndihmë emrin, mbiemrin, përemrin dhe foljen.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në përdorimin korrekt të gjuhës së folur dhe të shkruar.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- shkruajnë dhe flasin qartë e saktë tekste të thjeshta duke renditur në mënyrë logjike fjalët, grupet e fjalëve dhe fjalitë;
- dallojnë dhe ndërtojnë saktë fjali dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore, fjali pohore dhe mohore;
- dallojnë, zgjerojnë dhe shkurtojnë grupet kryesore të fjalisë (grupin e kryefjalës dhe kallëzuesit);
- dallojnë zgjerojnë dhe shkurtojnë grupet kryesore të fjalisë dhe i vendosin në të tria pozicionet (në fillim, në mes dhe në fund të fjalisë).

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shkruajnë dhe flasin përgjithësisht qartë tekste të thjeshta, duke renditur në mënyrë logjike fjalët, grupet e fjalëve dhe fjalitë;
- dallojnë dhe ndërtojnë fjali dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore, fjali pohore dhe mohore;
- dallojnë grupet kryesore të fjalisë (grupin e kryefjalës dhe kallëzuesit);
- dallojnë grupet plotësuese të fjalisë dhe i vendosin në pozicione të ndryshme brenda fjalisë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- flasin dhe shkruajnë tekste të thjeshta;
- dallojnë dhe ndërtojnë fjali dëftore dhe pyetëse, pohore dhe mohore;

- dallojnë grupet kryesore të fjalisë (grupin e kryefjalës dhe kallëzuesit) me anë të pyetjeve;
- gjejnë me anë të pyetjeve rrethanorin, përcaktorin dhe rrethanorin.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet dhe pjesë të tjera të leksikut të gjuhës shqipe, si dhe respektojnë diversitetin gjuhësor.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përdorin në përgjithësi saktë gjatë komunikimit gjuhën standarde.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin mirë gjuhën standarde.

Niveli bazë

Nxënësit:

- flasin me mangësi në gjuhën standarde.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit dallojnë mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë saktë fjalën sipas përbërësve të saj;
- dallojnë dhe shkruajnë përgjithësisht pa gabime fjalët e prejardhura dhe fjalët e përbëra;
- dallojnë parashtesat dhe prapashtesat më të përdorshme (për-, pa-, -shëm, -or, -ar) dhe krijojnë fjalë të prejardhura prej tyre;
- gjejnë dhe përdorin gjatë të folurit dhe të shkruarit kuptimin e parë të fjalëve dhe kuptimet e figurshme më të përdorshme;
- dallojnë dhe përdorin me lehtësi sinonimet dhe antonimet e fjalëve;
- dallojnë në një tekst shprehjet frazeologjike dhe fjalët e urta.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dallojnë përbërësit e fjalës;
- dallojnë dhe shkruajnë saktë fjalët e prejardhura dhe fjalët e përbëra më të përdorshme;
- dallojnë përgjithësisht saktë parashtesat dhe prapashtesat më të përdorshme (për-, pa-, -shëm, -or, -ar) dhe rrallëherë krijojnë fjalë të prejardhura prej tyre;
- gjejnë kuptimin e parë të fjalëve dhe kuptimet e figurshme më të përdorshme;
- dallojnë dhe përdorin me lehtësi sinonimet e fjalëve më të përdorshme;
- dallojnë në përgjithësi në një tekst shprehjet frazeologjike dhe fjalët e urta.

Niveli bazë

Nxënësit:

- gjejnë me vështirësi përbërësit e fjalës;
- dallojnë fjalët e përbëra dhe të prejardhura;
- dallojnë parashtesat dhe prapashtesat më të përdorshme (për-, pa-, -shëm, -or, -ar);
- gjejnë kuptimin e parë të fjalëve dhe në shumë pak raste kuptimet e tyre të figurshme;
- dallojnë dhe përdorin sinonimet dhe antonimet e një numri të kufizuar fjalësh;
- dallojnë me vështirësi në një tekst shprehjet frazeologjike dhe fjalët e urta.

Standardi i të nxënit 5

Nxënësit demostrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime rreth rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- shkruajnë saktë dhe duke respektuar shenjat e pikësimit, si: pika, pikëpyetja, pikëçuditësja, presja;

- përdorin drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, në emrat e njerëzve, kafshëve, emërtimeve gjeografike;
- ndajnë saktë dhe pa gabime fjalët shumërokëshe në fund të rreshtit;
- shkruajnë saktë zanoret “e” dhe “ë” në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- vendosin në përgjithësi saktë shenjat e pikësimit në dialog, por më rrallë në ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin saktë pikën në fund të fjalisë, por përdorin përgjithësisht në mënyrë korrekte shenjat e pikësimit, si: pikëpyetja, pikëçuditësja, presja;
- përdorin me pak gabime shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, në emrat e njerëzve, kafshëve, emërtimeve gjeografike;
- ndajnë saktë shumërokëshe në fund të rreshtit;
- shkruajnë në përgjithësi saktë zanoret “e” dhe “ë” në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- vendosin saktë shenjat e pikësimit në dialog.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përdorin saktë pikën, por gabojnë shpesh në përdorimin e pikëçuditëses, pikëpyetjes dhe presjes;
- përdorin shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, në emrat e njerëzve dhe të kafshëve, por gabojnë në shkrimin e disa emërtimeve gjeografike;
- bëjnë shpesh gabime në ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit;
- shkruajnë me gabime zanoren “ë” kur ajo ndodhet në mes dhe në fund të fjalës;
- vendosin, duke gabuar në disa raste, shenjat e pikësimit në dialog.

STANDARDET E ARRITJEVE PËR LËNDËN E GJUHËS SHQIPE PËR KLASËN 7-9

LINJA: Njohuri rreth sistemit gjuhësor

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- gjejnë saktë, duke argumentuar përgjigjen e tyre, emrin, mbiemrin, foljen, përemrin dhe numërorin sipas kategorive të tyre gramatikore;
- gjejnë dhe klasifikojnë ndajfoljen, lidhëzën, parafjalën, pasthirrmën dhe pjesëzën sipas llojeve dhe formave përfaqësuese.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- gjejnë dhe analizojnë në përgjithësi emrin, mbiemrin, foljen, përemrin dhe numërorin sipas kategorive të tyre gramatikore;
- dallojnë ndajfoljen, lidhëzën, parafjalën, pjesëzën dhe pasthirrmën sipas llojeve dhe formave përfaqësuese.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë emrin, mbiemrin, foljen, përemrin dhe numërorin;
- gjejnë me ndihmën e mësuesit/es ndajfoljen, lidhëzën, parafjalën, pjesëzën, pasthirrmën dhe llojet e tyre.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në përdorimin korrekt të gjuhës së folur dhe të shkruar.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- flasin qartë dhe shkruajnë saktë tekste të ndryshme, duke respektuar karakteristikat gjuhësore dhe duke renditur në mënyrë logjike fjalët, grupet e fjalëve dhe fjalitë;
- dallojnë dhe ndërtojnë saktë fjali të ndryshme sipas kuptimit dhe intonacionit, dallojnë dhe ndërtojnë me lehtësi fjali bashkërenditëse dhenënrenditëse, dallojnë dhe ndërtojnë saktë fjalë në kryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe;
- klasifikojnë saktë të gjitha fjalitë me bashkërenditje dhe të nënrenditura, nisur nga lidhëzat e përdorura;
- analizojnë saktë grupin e kryefjalës dhe të kallëzuesit;
- analizojnë të gjitha grupet plotësuese të fjalisë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- flasin qartë dhe shkruajnë tekste, duke respektuar përgjithësisht karakteristikat gjuhësore në lidhje me fjalët, grupet, e fjalëve dhe fjalitë;
- dallojnë dhe ndërtojnë përgjithësisht saktë fjali të ndryshme sipas kuptimit dhe intonacionit, fjali bashkërenditëse dhe nënrenditëse, fjali njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe;
- klasifikojnë në përgjithësi saktë të gjitha fjalitë me bashkërenditje dhe me nënrenditje, nisur nga lidhëzat e përdorura;
- gjejnë grupin e kryefjalës dhe të kallëzuesit;
- dallojnë kundrinorin, rrethanorin, përcaktorin dhe me vështirësi kallëzuesorin.

Niveli bazë

Nxënësit:

- flasin përgjithësisht qartë dhe shkruajnë tekste të thjeshta sipas modeleve të dhëna dhe respektojnë me mangësi rregullat gjuhësore të shkrimit të fjalëve, grupeve të fjalëve dhe fjalive;
- dallojnë dhe ndërtojnë fjali dëftore, pyetëse, nxitëse; fjali të përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje me dy pjesë;
- shfaqin vështirësi dhe paqartësi në përcaktimin e fjalive me bashkërenditje dhe me nënrenditje;

- gjejnë grupin e kryefjalës dhe të kallëzuesit;
- gjejnë kundrinorin, përcaktorin dhe rrethanorin.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet dhe pjesë të tjera të leksikut të gjuhës shqipe, si dhe respektojnë diversitetin gjuhësor.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përdorin gjuhën standarde, bëjnë krahasime mes gjuhës standarde dhe dialekteve, vlerësojnë pasurinë e leksikut të gjuhës shqipe;
- dallojnë fjalët e huaja nga fjalët e gjuhës shqipe, dallojnë fjalën e huaj që është bërë pjesë e leksikut nga fjalët e huaja që kanë fjalën përkatëse në gjuhën tonë, gjejnë huazime të panevojshme dhe i zëvendësojnë me fjalën shqipe;
- dallojnë regjistrat e gjuhës në tekste të ndryshme, përdorin regjistrat e gjuhës për qëllime të ndryshme në situata të ndryshme, dallojnë mjetet gjuhësore me të cilat shprehen stilet dhe regjistrat e ndryshëm në gjuhën shqipe.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin përgjithësisht gjuhën standarde gjatë komunikimit, gjejnë disa ndryshime mes gjuhës standarde dhe dialekteve, veçojnë disa nga vlerat e leksikut të shqipes;
- dallojnë fjalët e huaja nga fjalët e gjuhës shqipe, dallojnë fjalën e huaj, që është bërë pjesë e leksikut, nga fjalët e huaja që kanë fjalën përkatëse në gjuhën tonë;
- dallojnë regjistrat e gjuhës në tekste të ndryshme, përdorin në përgjithësi regjistrat e gjuhës për qëllime të ndryshme në situata të ndryshme, dallojnë disa nga mjetet gjuhësore me të cilat shprehen stilet dhe regjistrat e ndryshëm në gjuhën shqipe.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë me vështirësi gjuhën standarde nga dialektet;

- dallojnë fjalët e huaja nga fjalët e gjuhës shqipe;
- dallojnë regjistrat e gjuhës në tekste të ndryshme, dallojnë shumë pak mjete gjuhësore me të cilat shprehen stilet dhe regjistrat e ndryshëm në gjuhën shqipe.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit dallojnë mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- dallojnë, analizojnë, përdorin dhe shkruajnë saktë fjalët e përbëra, të prejardhura dhe të përngjitura dhe bëjnë krahasimet mes tyre;
- dallojnë parashtesat dhe prapashtesat; formojnë dhe përdorin kur është e nevojshme fjalë të reja me prapashtesat më të përdorura në gjuhën shqipe;
- gjejnë dhe përdorin fjalë dhe shprehje në kuptimin e parë dhe në kuptimin e figurshëm;
- dallojnë dhe përdorin vazhdimisht fjalë të urta, shprehje të figurshme dhe shprehje frazeologjike;
- krijojnë me lehtësi familje fjalësh dhe fushën leksikore të një fjale të dhënë (15-20 fjalë).

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dallojnë dhe analizojnë fjalët e përbëra, të prejardhura dhe të përngjitura;
- dallojnë parashtesat dhe prapashtesat;
- formojnë dhe përdorin në pak raste dhe kur është e nevojshme fjalë të reja me prapashtesat më të përdorura në gjuhën shqipe;
- gjejnë dhe përdorin kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm të fjalëve dhe shprehjeve;
- dallojnë dhe përdorin shpesh fjalë të urta, shprehje të figurshme dhe shprehje frazeologjike;
- krijojnë familje fjalësh dhe fushën leksikore të një fjale të dhënë (10-15 fjalë).

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë fjalët e prejardhura dhe të përbëra dhe gabojnë në gjetjen e fjalëve të përngjitura;
- dallojnë në përgjithësi saktë parashtesat dhe prapashtesat e fjalëve;
- gjejnë kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm të fjalëve dhe shprehjeve;
- dallojnë në disa raste fjalë të urta, shprehje të figurshme dhe shprehje frazeologjike;
- krijojnë familje fjalësh dhe fushën leksikore të një fjale të dhënë (deri në 8 fjalë).

Standardi i të nxënit 5

Nxënësit demostrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime rreth rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- shkruajnë saktë dhe duke respektuar në të gjitha rastet e përdorimit shenjat e pikësimit, si: pika, pikëpyetja, pikëçuditësja, presja, apostrofi, thonjëzat, dypikëshi, viza;
- përdorin saktë dhe vazhdimisht shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, në emrat e njerëzve, kafshëve, në emërtimet gjeografike dhe zyrtare, titujt dhe emrat e rrugëve;
- shkruajnë drejt zanoren “ë”, grupet e zanoreve, bashkëtingëlloren “h” dhe grupet e bashkëtingëlloreve;
- përdorin përgjithësisht saktë shenjat e pikësimit në dialog, në ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë dhe në lloje të ndryshme fjalish.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin në përgjithësi saktë pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditësen, por gabojnë në disa raste në vendosjen e presjes, thonjëzave, vizës, apostrofit dhe dypikëshit;
- përdorin në përgjithësi saktë shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, në emrat e njerëzve dhe të kafshëve, në emërtimet gjeografike dhe zyrtare, titujt dhe emrat e rrugëve;

- shkruajnë në përgjithësi saktë zanoren “ë”, grupet e zanoreve, bashkëtingëlloren “h” dhe grupet e bashkëtingëlloreve;
- vendosin saktë, në rastet më të shpeshta, shenjat e pikësimit në dialog, në ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë dhe në lloje të ndryshme fjalish.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përdorin në përgjithësi saktë pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditësen, por gabojnë në përdorimin e shenjave të tjera të pikësimit;
- përdorin saktë shkronjën e madhe vetëm në fillim të fjalive, ose në emrat e njerëzve dhe të qyteteve;
- gabojnë shpesh në shkrimin e zanores “ë”, grupeve të zanoreve, bashkëtingëllores “h” dhe grupeve të bashkëtingëlloreve;
- bëjnë shpesh gabime në përdorimin e shenjave të pikësimit në dialog, në ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë dhe në lloje të ndryshme fjalish.

STANDARDET E LETËRSISË

KLASA 7-9

LINJA 1: Kuptimi, interpretimi, vlerësimi dhe reflektimi ndaj një teksti letrar

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit lexojnë krijimtarinë e disa autorëve klasikë, përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe e letërsia botërore.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- lexojnë në mënyrë të vullnetshme dhe me dëshirë një shumëllojshmëri tekstesh letrare nga autorë të ndryshëm, nga letërsia shqipe dhe botërore: poezi, prozë, tekste dramatike përfaqësuese, si dhe krijimtari nga tradita folklorike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- lexojnë vepra për lexime jashtëklase ose libra të tjerë që u rekomandohen nga mësuesit, si dhe i tërheqin kryesisht tekstet me aventura.

Niveli bazë

Nxënësit:

- shfaqin pak interes për të lexuar.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit kuptojnë, interpretojnë, analizojnë, reflektojnë dhe vlerësojnë tekste letrare, të gjinive e llojeve të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- interpretojnë dhe analizojnë një tekst, gjykojnë e vlerësojnë elemente të formës dhe të përmbajtjes së një teksti letrar, shprehin këndvështrimet e tyre rreth tekstit letrar, gjykojnë rreth ideve të ndryshme që shfaqen në një tekst letrar, përshkruajnë se si ndikon teksti në botën emocionale të tyre, si dhe vlerësojnë tiparet e gjuhës dhe të stilit (me shkrim dhe me gojë);
- analizojnë epitelin, krahasimin, personifikimin, metaforën, hiperbolën, antitezën, similitudën, ironinë, simbolin, alegorinë dhe sinekdokën, metoniminë dhe tregojnë efektin që krijojnë ata;
- analizojnë funksionin e figurave tingullore, si: aliteracion, asonancë, konsonancë;
- analizojnë përdorimin në një tekst letrar të elipsës, shkallëzimit, enumeracionit, paralelizmit dhe antitezës.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- interpretojnë një tekst, analizojnë disa elemente të formës dhe të përmbajtjes së një teksti letrar, shprehin këndvështrimet e tyre me gjuhë të thjeshtë, veçojnë ide të ndryshme që shfaqen në një tekst, analizojnë tiparet e gjuhës dhe të stilit;

- dallojnë me lehtësi epitetin, krahasimin, personifikimin, metaforën dhe funksionin e tyre;
- dallojnë hiperbolën, antitezën, similitudën, ironinë, simbolin, alegorinë, sinekdokën dhe metoniminë;
- dallojnë figurat tingullore, si: aliteracion, asonancë, konsonancë;
- dallojnë elipsën, shkallëzimin, enumeracionin, paralelizmin dhe antitezën.

Niveli bazë

Nxënësit:

- interpretojnë me vështirësi një tekst, dallojnë disa elemente të formës dhe të përmbajtjes së një teksti letrar, shprehin këndvështrimet e tyre me gjuhë të thjeshtë, veçojnë ide të ndryshme që shfaqen në një tekst, dallojnë tiparet e gjuhës dhe të stilit;
- dallojnë epitetin, krahasimin, personifikimin, hiperbolën, antitezën, similitudën, ironinë, simbolin, alegorinë, sinekdokën dhe metoniminë;
- dallojnë figurat tingullore, si: aliteracion, asonancë, konsonancë;
- dallojnë elipsën, shkallëzimin, enumeracionin, paralelizmin dhe antitezën.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit shprehin mendimet e tyre për subjektin, fabulën, personazhet, mjedisin, gjuhën, tematikën, stilin e një teksti letrar.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- gjykojnë për subjektin, fabulën, personazhet, mjedisin, gjuhën, tematikën dhe stilin e një teksti letrar.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë subjektin, fabulën, personazhet, mjedisin, gjuhën, tematikën dhe stilin e një teksti letrar.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë subjektin, fabulën, personazhet, mjedisin, gjuhën, por hasin vështirësi në veçimin e tematikës dhe tipareve të stilit.

LINJA 2: Gjinitë dhe llojet e ndryshme të tekstit letrar**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit dallojnë tiparet specifike të tri formave kryesore të tekstit letrar: tekst poetik, tekst në prozë e tekst dramatik dhe sqarojnë funksionet e këtyre tipareve.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- analizojnë motivet dhe elementet e metrikës në një tekst poetik, analizojnë dhe shpjegojnë funksionin e elementeve të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik, krahasojnë poezinë lirike me poezinë epike, dallojnë tiparet e disa teksteve poetike, si: balada, soneti, himni, elegjia;
- analizojnë temën dhe motivet e një proze; përshkruajnë me detaje nga teksti fabulën dhe subjektin; përcaktojnë tipare të disa teksteve në prozë, si: tregimi, novela, romani; analizojnë dhe gjykojnë personazhe të ndryshme; dallojnë rrëfimtarin, vetën, kohën e rrëfimit dhe kohën historike;
- përcaktojnë tipare kryesore të tragjedisë, komedisë dhe dramës, analizojnë elementet e kompozicionit në një vepër dramatike, analizojnë elementet e strukturës, si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë, tregojnë ç'rol kanë personazhet në veprat dramatike, analizojnë tiparet psikologjike të personazhit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dallojnë motivet kryesore dhe elementet e metrikës në një tekst poetik, dallojnë funksionin e elementeve të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik, krahasojnë në përgjithësi poezinë lirike me poezinë epike, dallojnë disa tipare të teksteve poetike, si: balada, soneti, himni, elegjia;

- dallojnë temën dhe motivet kryesore të një teksti në prozë, përshkruajnë me detaje nga teksti fabulën dhe subjektin, veçojnë tiparet kryesore të teksteve në prozë, si: tregimi, novela, romani, analizojnë personazhe të ndryshme, dallojnë rrëfimtarin, vetën, kohën e rrëfimit dhe kohën historike;
- përcaktojnë dy-tri tipare tragjedisë, komedisë dhe dramës, veçojnë elementet e kompozicionit në një vepër dramatike, dallojnë elementet e strukturës, si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë, analizojnë tiparet psikologjike të personazhit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë pjesërisht motivet kryesore dhe elementet e metrikës në një tekst poetik, dallojnë me vështirësi disa elemente të thjeshta të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik, krahasojnë në përgjithësi poezinë lirike me poezinë epike, kanë njohuri të kufizuara për të bërë klasifikimin e teksteve poetike;
- dallojnë temën kryesore e një teksti në prozë, përshkruajnë me detaje të pakta fabulën dhe subjektin, veçojnë tiparet kryesore të teksteve në prozë, si: tregimi, novela, romani, analizojnë personazhe të ndryshme;
- dallojnë tragjedinë nga komedia dhe drama, dallojnë disa elemente të strukturës, si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë, dallojnë dy-tri tipare të personazhit.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit krahasojnë tekste që u përkasin gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë gjinitë dhe llojet letrare duke veçuar tiparet e tyre të rëndësishme, klasifikojnë tekstet në gjini epike, lirike dhe dramatike, krahasojnë poezinë lirike me poezinë epike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dallojnë vepra të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare, i klasifikojnë në përgjithësi tekstet letrare, veçojnë disa krahasime mes teksteve të gjinive të ndryshme.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë gjinitë dhe llojet letrare, kanë njohuri të kufizuara për të bërë klasifikimin e teksteve në lloje letrare.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit veçojnë dhe përdorin lidhjet e letërsisë me gjuhën dhe artet e tjera.

Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- gjykojnë për lidhjet e letërsisë me pikturën, skulpturën, muzikën, gjuhën, filmin, teatrin;
- shprehin përjetimet e tyre në pikturë ose në muzikë, pas leximit të një libri artistik.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë lidhjet e letërsisë me pikturën, skulpturën, muzikën, gjuhën, filmin, teatrin;
- shprehin përjetimet e tyre në pikturë ose në muzikë, pas leximit të një libri artistik.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë disa nga lidhjet e letërsisë me pikturën, skulpturën, muzikën, gjuhën, filmin, teatrin.

STANDARDET E ARRITJEVE

Fusha:

GJUHË E HUAJ

Lënda: Gjuhë Angleze, Gjuhë Frënge, Gjuhë Italiane,
Gjuhë Gjermane. Cikli: Klasat 3-9

Koordinatorë:

Erifili HASHORVA

Grupi i punës:

Gëzim HADAJ

Tidita ABDURRAHMANI

Edmond TUPJA

Klodeta DIBRA

Albana BEJA

Erifili HASHORVA

Fatbardha LOLJA

Shpresa DELIJA

Fozi SIMONI

Admir KRAJA

1. HYRJE

Standardet e arritjes, si një instrument matës për nivelin e përvetësimit të gjuhëve të huaja, përbëjnë një element të domosdoshëm, që ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e procesit të mësimin.

Standardet e arritjes u japin mësuesve një mënyrë për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në të katërta dukuritë e mësimin të gjuhës së huaj: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit.

Mësuesit mund t'i përdorin standardet e arritjes:

- për të monitoruar, vlerësuar dhe raportuar për të nxënëit e secilit nxënë;
- për të identifikuar nxënësit, të cilët kërkojnë mbështetje nga mësuesi/ja;
- për të nxitur diskutime me prindër dhe mësues të tjerë rreth të nxënëit të nxënësve;
- për të vendosur së bashku synime dhe objektiva për një individ, klasë dhe shkollë të caktuar;
- për të hartuar një bazë të dhënash për planet e zhvillimit të shkollës për gjuhët e huaja;
- për të siguruar modele për vlerësimin e të nxënëit.

Përvetësimi i gjuhëve të huaja bazohet në krijimin e aftësive të qëndrueshme komunikative dhe të njohurive kulturore.

2. PËRSHKRIMI I NIVELEVE TË ARRITJES

Sipas Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave të Këshillit të Evropës dhe të Kurrikulës Kombëtare të gjuhëve moderne për arsimin publik parauniversitar, mësimdhënia e gjuhëve të huaja dallon tri nivele:

Niveli A1

Nxënësit mund të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të përditshme dhe shprehje bazë që synojnë plotësimin e nevojave konkrete. Mund të paraqesin veten dhe të tjerët, si dhe të pyesin e të përgjigjen për detaje vetjake, si: ku jeton e banon, njerëzit që njeh, sendet që ka etj. Mund të komunikojnë në një mënyrë të thjeshtë nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë, qartë dhe është i gatshëm të ndihmojë.

Niveli A2

Nxënësit mund të kuptojnë fjali dhe shprehje të përditshme që lidhen me fusha të nevojës më të domosdoshme, si p.sh.: informacion bazë rreth vetes e familjes, në dyqan, gjeografi lokale, punët që bën; Mund të komunikojnë për detyra të thjeshta dhe rutinë që kërkojnë shkëmbim informacioni të drejtpërdrejtë për çështje të njohura dhe të përditshme dhe të përshkruajnë me terma të thjeshtë aspekte të formimit të tij, të mjedisit rrethues dhe çështje të fushave me interes të drejtpërdrejtë.

Niveli B1

Nxënësit mund të kuptojnë çështjet kryesore të një informacioni standard të qartë për çështje të njohura që hasen rregullisht në shkollë, punë, argëtim etj. Mund të përgatisin një material të thjeshtë për tema të njohura ose të një fushe të interesit vetjak.

Ndërsa nivelet sipas standardeve të arritjes dhe Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave (KPR) janë:

Niveli sipas standardeve të arritjes	Shkallëzimi	Shtrirja në klasa	Niveli në klasa
2.1 Niveli bazë	A1 Zbulimi i gjuhës A2 Mbijetesa gjuhësore	Kl. III-IV Kl. V-VI	Kl. III- VI
2.2 Niveli mesatar	B1 Pragu i njohjes gjuhësore	Kl. VII-IX	Kl. VII- IX

Kërkesa për zbatimin e standardeve të arritjes

Standardet e të nxënit përshkruajnë gjithçka që nxënësit mendohet se do të arrijnë në lëndë dhe në klasa të ndryshme. Standardet e arritjes janë përpiluar dhe janë paraqitur në mënyrë që të jenë të përdorshme nga të interesuarit në këtë fushë dhe në nivelin përkatës. Prandaj ato përdoren lehtësisht për të gjitha gjuhët e huaja që mësohen në arsimin tonë publik parauniversitar.

Standardet e arritjes sipas niveleve të kuadrit të përgjithshëm të referencave të KE-së dhe aftësive gjuhësore

Niveli A1 (Në fund të klasës së 4-t)

Të dëgjuarit

Niveli i lartë

Nxënësit:

- kuptojnë numrat, kohën, ditët e javës, muajt e vitit, stinët dhe çmimet.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- kuptojnë pyetje dhe udhëzime të drejtuara me shumë kujdes dhe shumë ngadalë, si dhe zbatojnë drejtime të thjeshta dhe të shkurtra.

Niveli bazë

Nxënësit:

- kuptojnë kur dikush flet shumë ngadalë, me artikulum të kujdesshëm dhe me pauza të gjata

Të folurit

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përshkruajnë thjesht vendin e banimit, objekte konkrete të klasës dhe portrete të shokëve.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- u bëjnë pyetje bashkëfolësve për vendbanimin e tyre, për lidhjet familjare, për gjërat që u përkasin, si dhe u përgjigjen të njëjtave pyetje, nëse bashkëfolësi i formulon ato ngadalë dhe qartë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- marrin pjesë në një bisedë ku paraqesin veten ose dikë tjetër dhe përdorin shprehje të thjeshta për të përshëndetur dhe për të marrë leje.

Të lexuarit*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- kuptojnë fjalë dhe fjali të thjeshta nëpër njoftime, postera dhe katalogë, tekste të shkurtra e të thjeshta, fraza të shkëputura, duke dalluar emra të njohur, fjalë dhe shprehje bazë, si dhe duke pasur mundësi për t'i rilexuar sipas nevojave.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- kuptojnë mesazhe të shkurtra të gjuhës së folur të shkruara nga shokët e tyre, si: "Takohemi në orën...", "Kthehem në..." etj.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shkruajnë me një bagazh të kufizuar fjalësh dhe shprehjesh të izoluar brenda situatash konkrete të veçanta.

Të shkruarit*Niveli mesatar*

Nxënësit:

- shkruajnë fjali dhe shprehje të thjeshta për veten, si p.sh.: ku jetojnë, çfarë bëjnë etj.;
- përdorin struktura gramatikore të thjeshta ose modele fjalish mbi të cilat zotëron një kontroll të kufizuar.

Niveli bazë

Nxënësit:

- plotësojnë një pyetësor me të dhëna vetjake, si: emri, mbiemri, adresa, kombësia etj.,
- shkruajnë një shënim të thjeshtë për të treguar se ku ndodhen dhe ku do të takohen me dikë.

Niveli A2 (Në fund të klasës së 6-të)**Të dëgjuarit***Niveli i lartë*

Nxënësit:

- kuptojnë informacionin bazë në pjesë të shkurtra të regjistruara, që merren me çështje të përditshme, kur flitet ngadalë dhe qartë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- kuptojnë frazat, fjalët dhe shprehjet që lidhen me fushat e interesit të tyre të çastit, si: informacione për veten dhe familjen, për vendbanimin, klasën e shkollën, shpjegime si të shkojnë në treg, për veprimtarinë që ai bën etj.

Niveli bazë:

Nxënësi:

- kuptojnë çka i thuhet qartë, ngadalë dhe drejtpërsëdrejti në një bisedë të thjeshtë të përditshme.

Të folurit*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- komunikojnë me ndihmën e disa shprehjeve të thjeshta ose të disa frazave të mësuara, duke lidhur grupe fjalësh me anë të lidhëzave të mësuara tashmë, si: edhe, por, sepse etj;
- zotërojnë një fjalor të mjaftueshëm për të përballuar situata të thjeshta të komunikimit të përditshëm.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- marrin pjesë në një bisedë ku kërkojnë informacion dhe bëjnë veprime të thjeshta në dyqan, në postë ose në bankë;
- përshëndesin dikë, e pyesin për shëndetin dhe reagojnë kur mësojnë prej tij lajme të reja.

Niveli bazë

Nxënësit:

- flasin në mënyrë të thjeshtë për kohën e lirë dhe interesat e veta;
- i drejtohen dikujt për një informacion dhe tregojnë kur e kuptojnë ose jo, si dhe i kërkojnë në mënyrë të thjeshtë dikujt t'i përsërisë diçka.

Të lexuarit***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- kuptojnë tregime të shkurtra të jetës së përditshme për tema të njohura, nëse janë shkruar në gjuhë të thjeshtë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- kuptojnë një korrespondencë ose mesazh të thjeshtë të shkruar nga shokët e tyre, ku lihet takimi, vendi dhe ora për të shkruar diku, si: në kinema, ndeshje etj.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë informacionet kryesore në përmbledhjen e lajmeve ose të artikujve të thjeshtë të gazetave, kur janë të shkruara, të ilustruara dhe të strukturuara qartë dhe ku emrat dhe shifrat luajnë një rol të rëndësishëm.

Të shkruarit***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- shkruajnë me fjali dhe shprehje të thjeshta për aspektet e jetës së përditshme, si: për vendin ku banojnë, ku luajnë, për shkollën, shokët, familjen;

- shkruajnë një seri shprehjesh të thjeshta dhe fjalish rreth familjes së tij, kushteve të jetesës, formimit arsimor etj.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shkruajnë një listë me sendet që duhen blerë dhe për veprimet që duhet të kryejnë gjatë ditës;
- paraqesin shkurtimisht veten në një letër me shprehje e fjali të thjeshta, duke treguar për familjen, shkollën, hobet.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shkruajnë një listë me sendet që duhen blerë dhe për veprimet që duhet të kryejnë gjatë ditës;
- paraqesin shkurtimisht veten në një letër me shprehje e fjali të thjeshta, duke treguar për familjen, shkollën, hobet.

Niveli bazë

Nxënësit:

- mbajnë shënime të shkurtra, të thjeshta dhe dërgojnë mesazhe të shkurtra për nevoja të çastit;
- shkruajnë për jetën e tyre të përditshme me shprehje dhe fjali
- të thjeshta (për njerëzit, vendet, punën, shkollën, familjen, hobet, duke përdorur lidhëza të thjeshta, si: dhe, ose, sepse).

Niveli B1 (Në fund të klasës së 9-të)

Të dëgjuarit

Niveli i lartë

Nxënësit:

- kapin thelbin e programeve televizive mbi tema të njohura, kur këto jepen me gjuhë relativisht të ngadalshme dhe të qartë, si dhe ku ngjarjet e treguara shoqërohen me veprime dhe figura;
- kuptojnë të dhëna të thjeshta teknike për instrumente të veprimtarisë së tij, si: të dhëna për një kompjuter, makinë llogaritëse, televizor, magnetofon, CD etj.

Niveli mesatar

Nxënësi:

- përgjithësisht ndjek thelbin e një bisede të zgjatur rreth tij, kur gjuha e folur është e shqiptuar qartë dhe kur është përdorur një gjuhë standarde.

Niveli bazë

Nxënësit:

- reagojnë në biseda të përditshme të shqiptuara qartë që i drejtohen atyre, dhe shpesh kërkojnë përsëritje të fjalëve dhe shprehjeve të veçanta.

Të folurit*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- shprehin me gojë në mënyrë të thjeshtë pasazhe të shkurtra të një teksti të shkruar, duke përdorur fjalët dhe renditjen e tekstit original;
- i kërkojnë bashkëfolësit t'i përsërisë në mënyrë më të saktë e më të qartë atë çka ata thonë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- flasin në mënyrë të kuptueshme dhe pa shumë hezitim, por bëjnë pauza për të planifikuar ose për të qortuar atë që thonë, veçanërisht kur flasin gjatë dhe lirshëm.

Niveli bazë

Nxënësit:

- fillojnë, vazhdojnë dhe përfundojnë me bashkëfolësin një bisedë për një temë shumë të njohur ose që paraqet interes.

Të lexuarit*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- kuptojnë në nivel të kënaqshëm tekste faktike të mirëfillta për tema e subjekte që lidhen me interesat e tij;
- kuptojnë instruksione, manuale të thjeshta për përdorimin e pajisjeve elektro-shtëpiake, të telefonit, kompjuterit etj.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- gjejnë dhe kuptojnë informacionin ose faktet e kërkuara (p.sh.: kush, ku dhe kur është kryer diçka), duke i hedhur një vështrim të shpejtë teksteve të shkurtra, si p.sh., përmbledhjes së lajmeve.

Niveli bazë

Nxënësit:

- kuptojnë çështjet kryesore në artikuj të shkurtër gazetash ose revistash për tema aktuale dhe të njohura;
- lexojnë artikuj ose intervista në gazeta e revista ku bëhet fjalë për tema dhe ngjarje aktuale dhe e kuptojnë në mënyrë të përgjithshme thelbin e informacionit.

Të shkruarit*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- hartojnë një faks, një e-mail, një mesazh për t'ua transmetuar në formë informacioni të thjeshtë dhe të shkurtër shokëve, si edhe kërkojnë informacion po në këtë mënyrë;
- hartojnë letra, kartolina, SMS dhe tekste të shkurtra mjaft të kuptueshme me një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë për veprimtaritë e përditshme.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shkruajnë përmbajtjen e një libri për fëmijë, të një filmi ose të një koncerti;
- shkruajnë duke shprehur në një letër ndjenjat e tyre, si: trishtim, gëzim, interesa, simpati ose keqardhje etj.

Niveli bazë

Nxënësit:

- shkruajnë tekste të thjeshta për tema të ndryshme, duke lidhur në seri elementet e rëndësishme;
- përshkruajnë një ngjarje, një udhëtim real ose imagjinar me fjali të thjeshta për një gazetë shkolle ose rrethin jashtëshkollor ku mund të bëjnë pjesë.

STANDARDET E ARRITJEVE

Fusha:

SHKENCA SHOQËRORE

Lënda: Unë dhe Shoqëria, Qytetaria,
Historia, Gjeografia

Koordinator:

Astrit DAUTAJ

Grupi i punës:

Mahir HOTI

Zyhdi DERVISHI

Merita SHEME

Majlinda ZIU

Neritan CEKA

Luan MALLTEZI

Mamica THANATI

Aurora GUXHOLLI

Albana KOSOVRASTI

Evis MASTORI

Ines TODHE

HYRJE

Hartimi i standardeve të arritjeve për fushën e shkencave shoqërore është kryer në kuadrin e reformës aktuale të arsimit bazë, si një nga faktorët që mundësojnë dhe garantojnë realizimin dhe vlerësimin e cilësisë në arsim.

Standardet e arritjes janë të lidhura ngushtësisht me standardet e të nxënit. Standardet e të nxënit tregojnë atë çka nxënësi duhet të dijë dhe të bëjë, ndërsa standardet e arritjeve e plotësojnë këtë kuadër me përshkrimin e niveleve të ndryshme, që demonstrojnë përvetësimin e standardeve të të nxënit.

Në hartimin e standardeve të arritjeve për fushën e shkencave shoqërore janë patur parasysh: Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Standardet e të nxënit të fushës së shkencave shoqërore, veçoritë moshore të nxënësve, si dhe përvoja e deritanishme e mësuesve në punën e diferencuar dhe në vlerësimin e nxënësve.

Janë përcaktuar 3 nivele arritjesh: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Këto nivele korrespondojnë përkatësisht me grup-notat: 5-6; 7-8 dhe 9-10 të sistemit tonë të vlerësimit.

Përveç përshkrimit të modelit të niveleve të arritjeve, në këtë material ofrohen edhe detajime në tri nivele të standardeve të të nxënit sipas linjave.

Kujtesë!

Këto përshkrime nuk janë shteruese. Ato nuk dublojnë standardet e të nxënit dhe nuk duhet të dëmtojnë fleksibilitetin e tyre në zbatim. Ato nuk zëvendësojnë rezultatet e programeve lëndore të ciklit 1-9.

I. KËRKESA PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE TË ARRITJES

Standardet e arritjeve do të përdoren nga mësuesit, hartuesit e teksteve shkollore e të materialeve të tjera ndihmëse për procesin mësimor, specialistët e vlerësimit dhe inspektorët e arsimit.

Në veçanti, standardet e arritjeve do ta ndihmojnë mësuesin për të planifikuar mësimdhënien, punën e diferencuar, për të vlerësuar objektivisht nxënësit dhe për të ndikuar pozitivisht në progresin e tyre.

Hartimi i instrumenteve të vlerësimit të arritjeve të të nxënit duhet kryer duke u mbështetur në nivelet e arritjeve që janë përshkruar në dokumentin e standardeve të arritjeve.

Cilat janë tri nivelet kryesore të aftësive intelektuale që kërkohen në lëndët shoqërore?

Këto aftësi, në përgjithësi, grupohen në nivelet e mëposhtme:

1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar.
2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar.
3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara.

1. AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR DHE PËR TË PËRSHKRUAR

Të identifikosh do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (për shembull ministrat) ose jo të prekshme (për shembull koncepte të tilla, si: drejtësia, barazia etj.). Të identifikosh diçka do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj.

Të përshkruash do të thotë të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj.

Pra, **të identifikosh** ose **të përshkruash** në fushën e edukimit qytetar, për shembull, do të thotë:

- të identifikosh koncepte kryesore të demokracisë, si: kushtetuta, qeverisja demokratike etj.;

- të dallosh, për shembull: degët kryesore të pushtetit, format e ndryshme të qeverisjes, institucionet qeveritare nga ato joqeveritare etj.;
- të identifikosh individë, simbole, institucione, si dhe udhëheqës të shquar, simbole kombëtare etj.;
- të identifikosh ide dhe koncepte, si: të drejtat e fëmijëve, të grave, shoqëri civile, patriotizëm etj.;
- të përshkruash funksione dhe procese, si: kontrolli ligjor i pushtetit, hartimi i politikës arsimore etj.;
- të përshkruash origjinën historike, për shembull, të ditëve historike (ose të festave kombëtare), të burimit të pushtetit politik, të formës së demokracisë në vend etj.;
- të përshkruash karakteristikat, për shembull, të qeverisjes në Shqipëri, të raportit ndërmjet degëve të ndryshme të pushtetit në Shqipëri etj.;
- të klasifikosh sipas tipareve, për shembull, demokracia liberale, demokracia joliberale etj.;
- të përshkruash prirjet, për shembull, të pjesëmarrjes së njerëzve në votim, shkallën e emigrimit të inteligjencës shqiptare, ndikimin e kulturës europiane në atë shqiptare përmes emigrantëve etj.

2. AFTËSIA PËR TË SHPJEGUAR DHE PËR TË ANALIZUAR

Të **shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësoh ose të interpretosh diçka, për shembull, shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara.

Të **analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike.

Pra, të **shpjegosh** ose të **analizosh** në fushën e edukimit qytetar, për shembull, do të thotë:

- të shpjegosh funksionimin e gjërave, për shembull: të sistemit elektoral;
- të analizosh arsyet për veprime, ngjarje ose prirje të caktuara, për shembull: të miratimit të ligjit të legalizimit të ndërtimeve pa leje në

disa zona, të rënies së shkallës së pjesëmarrjes së njerëzve në procesin e votimit etj.;

- të shpjegosh shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve dhe të dukurive, për shembull: të ligjit të heqjes së dënimit me vdekje në Shqipëri etj.;
- të analizosh arsyet ose motivet, për shembull: për përdorimin e gjuhës së emocioneve, veçanërisht gjatë fushatave elektorale etj.;
- të krahasosh, për shembull: shkallën e mbrojtjes së interesave të minoriteteve në demokracitë liberale dhe në ato joliberale etj.;
- të dallosh faktet nga opinionet, për shembull: bindjet se qytetarët nuk mund të ndikojnë në hartimin dhe zbatimin e politikës publike me rrugët e mundshme me anë të të cilave qytetarët mund të kontrollojnë dhe të ndikojnë në politikën publike etj.;
- të dallojnë qëllimet dhe mjetet, për shembull: të bëjnë dallimin ndërmjet taksave dhe sigurisë së njerëzve, ndihmës së huaj dhe interesave të sigurisë dhe pavarësisë kombëtare etj.;
- të qartësojnë përgjegjësitë, për shembull: të dallojnë dhe të qartësojnë përgjegjësitë personale dhe ato publike, të bëjnë dallimin ndërmjet qytetarëve dhe nëpunësve të zgjedhur prej tyre etj.;
- të interpretojnë kuptimin ose rëndësinë e ngjarjeve, të ideve ose të dukurive, për shembull: të miratimit të një ligji të caktuar, të kalimit në sistemin nëntëvjeçar të arsimit të detyruar etj.

3. AFTËSIA PËR TË VLERËSUAR, PËR TË MARRË DHE PËR TË MBROJTUR QËNDRIME TË CAKTUARA

Këto aftësi janë të rëndësishme, pasi i ndihmojnë qytetarët të vlerësojnë çështje të jetës qytetare, të gjykojnë për to dhe të diskutojnë me të tjerët për qëndrimet e tyre.

Të **vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, për shembull: për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj.

Të **marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri.

Të **mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim ose të kundërshtosh një qëndrim të

caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.

Pra, **të vlerësosh, të marrësh ose të mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë:

- të identifikosh pikat e forta dhe të dobëta, për shembull: rregulla, ligje etj., të propozuara nga parlamenti ose qeveria;
- të sfidosh argumente që vlerësohen si jo të arsyeshëm, për shembull: përdorimi i emrave fytes, sulmet personale, nënkuptimet etj.;
- të vlerësosh vlefshmërinë e akordimeve, të analogjive dhe të dhënave, për shembull: burimet e të dhënave, kohezioni logjik, përdorimi i duhur i analogjive etj.;
- të japësh të dhëna për të mbështetur ose hedhur poshtë, për shembull: besueshmëria e fakteve, përshtatshmëria e fakteve, kontradiktat ndërmjet llojeve të ndryshme të të dhënave etj.;
- të parashikosh pasojat e mundshme, për shembull: vlera e parashikimit, shkalla e mundësisë, krahasimi me shembuj të së kaluarës etj.;
- të vlerësosh qëllimet dhe mjetet, për shembull: mjetet që nuk të çojnë në realizimin e qëllimeve, përdorime të pamoralshme të mjeteve dhe të qëllimeve që vijnë në kundërshtim me qëllime të tjera të dëshirueshme;
- të vlerësosh koston dhe përfitimin e alternativave, për shembull: numri i njerëzve që janë ndikuar pozitivisht ose negativisht, kostoja monetare përkundrejt vlerave shoqërore;
- të zgjedhësh një qëndrim të caktuar nga alternativat ekzistuese, për shembull: analiza e qëndrimeve ekzistuese, gjykimi i qëndrimeve duke përdorur kriteret e duhura;
- të krijosh një qëndrim të ri, për shembull: të dallosh idetë më të mira nga alternativat ekzistuese, harmonizimi i elementeve përbërëse në një mënyrë të caktuar;
- të mbrosh një qëndrim të caktuar, për shembull: përputhja me vlerat dhe parimet themelore, kosto që nuk mbështetet ose kalohet nga fitimi, alternativa më e mirë ose më e keqe e kundërshtueshme etj.;
- t'u përgjigjesh argumenteve të kundërta, citimi i argumenteve të përshtatshme, kundërshtimi i gjuhës së emocioneve etj.; marrja parasysh e rastit më të mirë që kundërshton pikëpamjet personale.

II. SHEMBUJ TË STANDARDEVE TË ARRITJEVE TË FUSHËS SË SHKENCAVE SHOQËRORE

LINJA 1: Kultura (dimensioni kulturor)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje të kulturës dhe të llojshmërisë kulturore. Ata kuptojnë se si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë e përshtaten ndaj kulturës, vlerësojnë rolin e kulturës në modelimin e jetës dhe të shoqërisë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- krahasojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre; shpjegon se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë informacionet dhe përvojat;
- shpjegojnë dhe japin shembuj për mënyrën e ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës;
- shpjegojnë pse individët dhe grupet reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre;
- përshkruajnë ndikimin dhe bashkëveprimin e diversitetit kulturor, si dhe të kohezionit social brenda dhe ndërmjet grupeve.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- identifikojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre;
- dallojnë këndvështrimet e ndryshme të njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore për probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore;

- dallojnë dhe japin shembuj të ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës;
- përshkruajnë reagimet e ndryshme të individëve dhe të grupeve ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre;
- krahasojnë raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të diversitetit kulturor brenda dhe ndërmjet grupeve.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë ngjashmëri dhe ndryshime në mënyrën se si individë dhe grupe të ndryshme plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre;
- dallojnë faktin që njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme për probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore;
- dallojnë raste të ndikimit të gjuhës, të traditave dhe të sjelljeve në zhvillimin e kulturës;
- dallojnë elemente të lidhjeve ndërmjet reagimeve të ndryshme të individëve dhe të grupeve ndaj mjediseve shoqërore ose ndryshimeve dhe pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre;
- dallojnë raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore brenda dhe ndërmjet grupeve.

LINJA 2: Koha, vazhdimësia, ndryshimi

Standardi

Nxënësit demonstrojnë të kuptuarit që njerëz të ndryshëm mund të përshkruajnë të njëjtat ngjarje ose situata në mënyra të ndryshme, por duke dhënë argumente për këndvështrimet e tyre; identifikojnë dhe përdorin konceptet kyç, si kronologjia, rastësia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti për të shpjeguar, për të analizuar dhe për të treguar lidhjet ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë; përshkruajnë periudha të caktuara historike dhe modele të ndryshimit në dhe ndërmjet kulturave, të tilla si: rritja e qytetërimit, zhvillimi i sistemeve të transportit, komunikimit etj.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shpjegojnë dhe argumentojnë me shembuj dhe fakte pse njerëz të ndryshëm mund të përshkruajnë të njëjtat ngjarje ose situata në mënyra të ndryshme;
- shpjegojnë dhe analizojnë lidhjet ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë dhe përdorin konceptet kyç si kronologjia, rastësia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti për të shpjeguar, analizuar dhe treguar lidhjet midis ndryshimit dhe vazhdimësisë;
- dallojnë dhe përshkruajnë *periudha* të caktuara historike dhe *modele* të ndryshimit brenda e ndërmjet kulturave, të tilla, si: zhvillimi i kulturave dhe i qytetërimeve të hershme, zhvillimi i sistemeve politike, ekonomike të transportit, komunikimit etj.;
- përdorin sistematikisht metodat e vështirimit kritik të historisë; përdorin burime të ndryshme për të rindërtuar dhe për të riinterpretuar të kaluarën, të tilla si: përdorimi i një larmie burimesh që furnizojnë me të dhëna të vlefshme dhe të besueshme; verifikojnë vazhdimisht besueshmërinë dhe vlerën e burimeve të përdorura;
- mbrojnë dhe zhvillojnë qëndrime e ndjenja kritike të tilla si: simpatia ose dyshimi lidhur me qëndrimet, vlerat, dhe sjelljet e njerëzve në kontekste të ndryshme historike;
- përdorin njohjen e fakteve dhe të koncepteve të nxjerra nga historia për vendimmarrje dhe pjesëmarrje në veprime konkrete për çështjet publike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë shembuj të përshkrimit të të njëjtave ngjarje ose situata nga njerëz të ndryshëm nga këndvështrime të ndryshme;
- përshkruajnë lidhjet ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë, duke përdorur konceptet kyç si: kronologjia, rastësia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti;
- përshkruajnë periudha të caktuara të ndryshimit brenda dhe ndërmjet kulturave, të tilla si: rritja e qytetërimit, zhvillimi i sistemeve politike, ekonomike etj.;
- përdorin burime të ndryshme për të rindërtuar dhe për të

riinterpretuar të kaluarën; verifikojnë besueshmërinë e burimeve të përdorura;

- mbajnë qendrimet të caktuara, si: simpatia ose dyshimi për qëndrimet, vlerat, dhe sjelljet e njerëzve në kontekste të ndryshme historike;
- përdorin njohjen e fakteve të caktuara për vendimmarrje dhe pjesëmarrje në veprime konkrete.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë raste ose shembuj të këndvështrimit të ndryshme të të njëjtave ngjarje;
- dallojnë elemente të lidhjes ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë dhe të marrëdhënieve shkak pasojë nga historia dhe jeta e përditshme;
- dallojnë periudha të caktuara historike dhe elemente të ndryshme të ndryshimit që ekzistojnë ndërmjet tyre;
- dallojnë elemente të veçanta të historisë, duke përdorur të dhëna ose burime të shpëputura dhe jo të rëndësishme; nuk bëjnë përpjekje për të verifikuar besueshmërinë ose vlerën e tyre;
- shprehin lehtësisht qëndrimin e tyre (simpatinë dhe antipatinë) për qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e njerëzve të marrë jashtë konteksteve të ndryshme historike dhe jashtë shikimit kritik;
- marrin vendime individuale dhe marrin pjesë në veprime të caktuara konkrete mbi bazën e gjykimeve të shpejtuara të elementeve të veçanta ose të shpëputura të realitetit.

LINJA 3: Njerëz, vende, mjedise

Standardi

Nxënësit përshkruajnë tiparet e mjedisve në nivel vendor, kombëtar, rajonal e global dhe shpjegojnë marrëdhëniet brenda ekosistemit përmes përdorimit të burimeve të duhura, të dhënave burimore dhe mjeteve didaktike, të tilla si: fotografi, harta, libra, gazeta, statistika, si dhe të tjera që ndihmojnë për të bërë përgjithësime, përpunime dhe interpretime rreth bashkëveprimit të njerëzve me vendet dhe mjedisin; zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, kuptojnë vendndodhjen e njerëzve, të vendeve dhe burimeve dhe shpjegojnë arsyen e kësaj vendndodhjeje; përshkruajnë si kanë ndikuar dhe ndikojnë ngjarjet historike, faktorët fizikë dhe njerëzorë në zhvillimin vendor, rajonal, kombëtar dhe global; vëzhgojnë dhe debatojnë rreth

pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe propozojnë, krahasojnë e vlerësojnë alternativat e përdorimit të burimeve natyrore në komunitete, rajone, kombe dhe në botë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shpjegojnë marrëdhëniet ndërmjet tipareve të mjedisit në nivel lokal (vendor) dhe rajonal;
- shpjegojnë marrëdhëniet ndërmjet ndryshimeve në mjedis dhe zakoneve të banorëve që jetojnë në të;
- shpjegojnë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet mënyrës së ndërtimit të qendrave të banuara, parqeve, qendrave të biznesit etj. dhe vlerave e idealeve kulturore të njerëzve që i ndërtojnë ato;
- analizojnë dhe interpretojnë bashkëveprimin ndërmjet traditave fizike dhe kulturore, si: përdorimi i tokës, transmetimi i ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.;
- shpjegojnë ndikimin e ngjarjeve historike dhe faktorët fizikë në zhvillimin lokal, kombëtar dhe global;
- debatojnë me argumente rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe të dukurive që burojnë prej tyre, si: stuhitë, thatësitrat, përmbytjet etj.;
- bëjnë përgjithësime dhe interpretojnë, duke përdorur burime të vlefshme dhe mjete të tilla, si: fotografi, harta, libra, gazeta, statistika, si dhe të tjera për bashkëveprimin e njerëzve me vendet dhe mjedisin;
- vlerësojnë dhe propozojnë alternativa të përdorimit të burimeve natyrore në bashkësinë ku jetojnë dhe më gjerë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë tiparet e mjedisve në nivel lokal dhe rajonal;
- përshkruajnë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet ndryshimeve në mjedis dhe zakoneve të banorëve që jetojnë në të;
- përshkruajnë se si njerëzit krijojnë vende (vende banimi, parqe etj.), që pasqyrojnë vlerat dhe idealet e tyre kulturore;
- shqyrtojnë bashkëveprimin ndërmjet traditave fizike dhe kulturore, si: përdorimi i tokës, transmetimi i ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.;

- përshkruajnë ndikimin e ngjarjeve historike dhe faktorët fizikë në zhvillimin lokal dhe kombëtar;
- diskutojnë rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe të dukurive që burojnë prej tyre, si: stuhitë, thatësitat, përmbytjet etj.;
- duke përdorur burime të vlefshme dhe mjete të tilla, si: fotografi, harta, libra, gazeta etj., përshkruajnë bashkëveprimin e njeriut me mjedisin;
- propozojnë alternativa të përdorimit të burimeve natyrore në bashkësinë ku jetojnë dhe më gjerë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë tipare të veçanta të mjedisit në nivel lokal dhe rajonal;
- identifikojnë ndryshimet dhe zakonet e banorëve që jetojnë në një mjedis të caktuar;
- identifikojnë lidhje që ekzistojnë ndërmjet idealeve të njerëzve dhe mënyrës së ndërtimit të vendeve ku banojnë etj.;
- dallojnë raste të bashkëveprimit ndërmjet traditave fizike dhe kulturore, si: përdorimi i tokës, transmetimi i ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.;
- dallojnë raste të ndikimit të ngjarjeve të caktuara dhe të faktorëve fizikë në zhvillimin e komunitetit ose të vendit ku jetojnë;
- shprehin mendimin e tyre për pasoja të veçanta që sjellin ndryshime të caktuara mjedisore, si: stuhitë, thatësitat, përmbytjet etj.;
- flasin duke u mbështetur në burime të tilla, si: fotografi, gazeta etj., për lidhjet ndërmjet njeriut dhe mjedisit;
- japin mendim për mënyrën e përdorimit të burimeve të caktuara natyrore në bashkësinë ku jeton.

LINJA 4: Zhvillimi individual dhe identiteti

(dimensioni vetjak dhe shoqëror)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me zhvillimin individual dhe atë shoqëror. Ata mësojnë se identiteti vetjak formohet nga ndikimi i familjes, i grupit shoqëror, i kulturës dhe i institucioneve. Në këtë linjë studimi, nxënësit shqyrtojnë faktorët që ndikojnë në identitetin e tyre vetjak, në zhvillimin dhe në veprimet e tyre.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- analizojnë lidhjet e tyre personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore;
- vlerësojnë ndikimet e kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale;
- shpjegojnë mënyrat se si familja, feja, gjinia, etnia, kombësia, statusi social-ekonomik, faktorë të tjerë kulturorë ose të grupeve ndikojnë ndaj zhvillimit të ndjenjës së identitetit personal;
- zbatojnë në mënyrë sistematike koncepte, metoda dhe teori për studimin e rritjes dhe zhvillimit njerëzor, si: zhvillimi fizik, të nxënës, motivimi, sjellja, perceptimi dhe personaliteti;
- analizojnë ndërveprimin e ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose situata të veçanta;
- analizojnë rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;
- vlerësojnë ndikimin që ushtrojnë stereotipat, konformizmi, altruizmi dhe sjellje të tjera tek individët dhe te grupet;
- shpjegojnë faktorët që ndikojnë në zhvillimin ose në dëmtimin e shëndetit mendor;
- analizojnë çështjet që lidhen me shëndetin mendor dhe me çrregullimet e sjelljes në shoqërinë bashkëkohore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë lidhjet e tyre personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore;
- përshkruajnë ndikimet e kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale;
- përshkruajnë mënyrat se si familja, feja, gjinia, etnia, kombësia, statusi social-ekonomik, faktorë të tjerë kulturorë ose të grupeve ndikojnë ndaj zhvillimit të ndjenjës së identitetit personal;
- përdorin koncepte të ndryshme për studimin e rritjes dhe zhvillimit njerëzor, si: zhvillimi fizik, të nxënës, motivimi, sjellja, perceptimi dhe personaliteti;
- përshkruajnë ndërveprimin e ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose në situata të veçanta;

- përshkruajnë rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;
- përshkruajnë ndikimin që ushtrojnë stereotipat, konformizmi, altruizmi dhe sjellje të tjera tek individët dhe te grupet;
- shqyrtojnë faktorët që ndikojnë në zhvillimin ose dëmtimin e shëndetit mendor;
- përshkruajnë çështjet që lidhen me shëndetin mendor dhe me çrregullimet e sjelljes në shoqërinë bashkëkohore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë elemente që shprehin lidhjet e tij personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore;
- identifikojnë raste të ndikimeve të kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale;
- dallojnë raste të ndikimit të familjes, gjinisë, fesë, statusit ekonomik dhe social etj., në zhvillimin e ndjenjës së identitetit personal;
- përdorin *me vështirësi* koncepte të ndryshme për studimin e rritjes dhe zhvillimit njerëzor, si: zhvillimi fizik, të nxënës, motivimi, sjellja, perceptimi dhe personaliteti;
- dallojnë raste të ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose situata të veçanta;
- flasin për rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;
- dallojnë raste të ndikimit të sjelljeve konformiste, altruiste ose stereotipa tek individët dhe te grupet;
- identifikojnë faktorë që ndikojnë në zhvillimin ose dëmtimin e shëndetit mendor.

LINJA 5: Individë, grupe dhe institucione (dimensioni shoqëror)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me institucione të tilla, si: familja dhe organizatat qytetare, arsimore, qeveritare e fetare dhe me mënyrën se si ato ushtrojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë institucionet.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësi:

- zbatojnë *sistematikisht* koncepte të tilla, si: roli, statusi dhe klasa shoqërore për të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri;
- analizojnë ndikimin e grupeve dhe institucioneve te njerëzit, ngjarjet dhe elementet e ndryshme kulturore në të kaluarën dhe sot;
- shpjegojnë zhvillimin e institucioneve në kohë dhe në hapësirë; analizojnë shembuj të kontradiktave ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe përpjekjeve që bëhen për të nxitur konformizimin shoqëror nga grupet dhe institucionet;
- shqyrtojnë sistemet e besimeve që qëndrojnë në themel të traditave dhe ligjeve në shoqërinë e sotme dhe gjatë historisë; vlerësojnë rolin e institucioneve si në drejtim të trashëgimisë dhe vazhdimësisë, ashtu edhe në drejtim të ndryshimit;
- analizojnë shkallën në të cilën grupet dhe institucionet plotësojnë interesat e individëve dhe interesat e përbashkëta në shoqërinë e sotme dhe në atë të së kaluarës.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin koncepte të tilla, si: roli, statusi dhe klasa shoqërore për të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri;
- përshkruajnë ndikimin e grupeve dhe institucioneve te njerëzit, ngjarjet dhe elementet e ndryshme kulturore në të kaluarën dhe sot;
- përshkruajnë zhvillimin e institucioneve në kohë dhe në hapësirë;
- identifikojnë shembuj të kontradiktave ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe përpjekjeve që bëhen për të nxitur konformizimin shoqëror nga grupet dhe institucionet;
- përshkruajnë besimet që qëndrojnë në themel të traditave dhe ligjeve në shoqërinë e sotme dhe gjatë historisë;
- përshkruajnë rolin institucioneve si në drejtim të trashëgimisë dhe vazhdimësisë, ashtu edhe në drejtim të ndryshimit;
- përshkruajnë me shembuj shkallën në të cilën grupe dhe institucionet plotësojnë interesat e individëve dhe interesat e përbashkëta në shoqërinë e sotme dhe në atë të së kaluarës.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përdorin me vështirësi koncepte të tilla, si: roli, statusi dhe klasa shoqërore për të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri;
- listojnë raste të ndikimit të grupeve dhe të institucioneve te njerëzit, ngjarjet dhe elementet e ndryshme kulturore në të kaluarën dhe sot;
- flasin për ndryshime të institucioneve në kohë dhe në hapësirë; dallojnë raste të përpjekjeve të grupeve dhe të institucioneve për të nxitur konformizmin shoqëror;
- dallojnë raste të ndikimit të besimeve në ligjet e shoqërisë së të kaluarës dhe të sotme;
- nxjerrin në pah raste të ndikimit të institucioneve në fushën e trashëgimisë dhe të ndryshimit shoqëror;
- tregojnë raste të plotësimit ose jo të interesave të individëve ose të interesave të përbashkëta nga institucionet dhe grupet shoqërore.

LINJA 6: Pushteti, autoriteti dhe qeverisja (dimensioni politik)**Standardi**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështjet që lidhen me zhvillimin historik dhe bashkëkohor të formave të pushtetit, të autoritetit dhe të qeverisjes. Ata kuptojnë qëllimet dhe funksionet e qeverisjes, fushën dhe kufizimet e autoritetit, si dhe ndryshimet ndërmjet sistemeve politike demokratike dhe jodemokratike.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- shpjegojnë qëllimin e qeverisjes;
- analizojnë rrugën se si fitohet, ushtrohet dhe justifikohet pushteti;
- shpjegojnë idetë dhe mekanizmin që duhet për plotësimin e nevojave dhe dëshirave të qytetarëve, për të rregulluar territorin, manaxhuar konfliktet, vendosur rendin dhe sigurinë dhe balancën e koncepteve për një shoqëri të drejtë;
- analizojnë mënyrën se si kombet dhe organizatat e ndryshme u përgjigjen konflikteve ndërmjet forcës së unitetit dhe të diversitetit;
- krahasojnë sistemet e ndryshme politike (ideologjitë, strukturën,

- institucionet, proceset dhe kulturat politike) me sistemin shqiptar;
- analizojnë dhe vlerësojnë kushtet, veprimet dhe motivimet që ndihmojnë në konfliktet dhe bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet kombeve;
 - shpjegojnë dhe zbatojnë *sistematikisht* ide, teori dhe mënyra të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë qëllimet dhe funksionet kryesore të qeverisjes, si dhe rrugën e fitimit, ushtrimit dhe justifikimit të pushtetit;
- përshkruajnë mekanizmin me anë të të cilit qytetarët duhet të përdorin për plotësimin e disa prej nevojave dhe dëshirave të tyre etj.;
- përshkruajnë mënyrat se si kombet dhe organizatat e ndryshme u përgjigjen konflikteve ndërmjet forcës së unitetit dhe të diversitetit;
- përshkruajnë tiparet kryesore të sistemit politik shqiptar dhe i krahasojnë ato me tiparet e një sistemi tjetër politik;
- përshkruajnë kushtet, veprimet dhe motivimet që ndihmojnë në konfliktet dhe në bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet kombeve;
- zbatojnë mënyra të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përmendin disa nga funksionet e qeverisjes, si dhe rrugët e fitimit dhe ushtrimit të pushtetit;
- identifikojnë forma të ndryshme që qytetarët përdorin për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre;
- përmendin forma të ndryshme të reagimeve të kombeve dhe organizatave ndaj konflikteve;
- dallojnë elemente të përbashkëta të sistemit politik shqiptar me një sistem tjetër politik të dhënë;
- përmendin faktorë të veçantë që ndihmojnë në konfliktet brenda dhe ndërmjet kombeve;
- përdorin *me vështirësi* elemente të hulumtimit të shkencave politike

për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.

LINJA 7: Prodhimi shpërndarja, konsumi

Standardi

Nxënësit përshkruajnë me shembuj si sistemet ekonomike bëjnë zgjedhjet e tyre për prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave materiale dhe të shërbimeve; përshkruajnë shembuj të ndryshëm të institucione që formojnë sistemet ekonomike, si: prodhimi i vogël (edhe ai familjar), firmat prodhuese, bankat, institucionet qeveritare, sindikatat dhe korporatat; përshkruajnë rolin e specializimeve dhe të shkëmbimit në proceset ekonomike; përdorin koncepte ekonomike për të shpjeguar zhvillimet aktuale dhe historike në një kontekst shoqëror vendor, kombëtar dhe global; përdorin arsyetimin ekonomik për të krahasuar propozime të ndryshme që lidhen me çështje shoqërore bashkëkohore, si papunësia, cilësia e arsimit etj.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përshkruajnë “sistemet ekonomike”, që vinë nga institucione sociale si ekonomia familjare - vjen nga prodhimi i vogël artizanal, deri tek firmat, korporatat, bankat e tjerë;
- analizojnë si realizohet procesi i “shkëmbimit ekonomik” në nivel lokal dhe global;
- diferencojnë format e shkëmbimit: në para dhe mall;
- përdorin arsyetimin ekonomik kur diskuton për çështje sociale si papunësia etj.;
- sjellin argumente pro dhe kundër, nëse zhvillimi i teknologjisë dhe shkencës stimulon më shumë “individualizmin” nga “kolektivizmi”.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- dallojnë termat dhe konceptet, si: kërkesë/ofertë/çmimin e prodhimit/tregun e prodhimit;
- evidentojnë shkaqet e papunësisë në nivel lokal dhe global;
- interpretojnë dhe krahason dukurinë “papunësi” me atë “progres teknologjik”;

- identifikojnë burimet natyrore lokale që janë bazë për zhvillimin ekonomik lokal;
- argumentojnë pse dhe si (në çfarë mënyre) tradita ndikon në procesin e prodhimit;
- përdorin përvoja personale nga vendimet ekonomike që janë marrë në familjen e tij dhe i komenton ato.

Niveli bazë

Nxënësit:

- listojnë jo më pak se tre nga institucionet ekonomike lokale private dhe publike;
- dallojnë prodhimin e vogël nga prodhimi i madh;
- diferencojnë konceptin “eksport” nga “import”;
- sjellin shembuj dhe listojnë produkte të cilat eksportohen dhe produkte, të cilat importohen, si dhe evidentojnë vendet prej nga vinë importet dhe destinacionin e produkteve të eksportuara;
- interpretojnë një statistikë të thjeshtë që vjen nga ekonomia lokale.

LINJA 8: Shkenca, teknologjia dhe shoqëria

Standardi

Nxënësit shqyrtojnë dhe përshkruajnë ndikimin e kulturës në zgjedhjet dhe arritjet e shkencës dhe teknologjisë, si në transport, mjekësi, mirëqenie etj.; tregojnë, përmes shembujve specifikë, se si shkenca dhe teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe sociale, si p.sh: marrëdhëniet e tyre me tokën, jetën e kafshëve, jetën familjare, nevojat dhe dëshirat ekonomike dhe sigurinë; përshkruajnë me shembuj se si vlerat, besimet dhe qëndrimet janë ndikuar nga zbulimet e reja shkencore dhe teknologjike, si për shembull, shpikja e shtypit, konceptimi i universit, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike; shpjegojnë nevojën për ligje dhe politika të caktuara për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike, si në fushën e sigurisë dhe të mirëqenies së punëtorëve dhe konsumatorëve, në fushën e përdorimit të pajisjeve të jetës të përditëshme, të televizionit, të radios etj.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shqyrtojnë ndikimin e kulturës në zgjedhjet dhe arritjet e shkencës dhe teknologjisë, si në transport, mjekësi etj.
- analizojnë, duke përdorur shembuj se si shkenca dhe teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe shoqërore, për marrëdhëniet e tyre me tokën, për jetën e kafshëve, për jetën familjare, nevojat ekonomike dhe sigurinë;
- analizojnë ndikimin e zbulimeve të reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i gjithësisë, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike në vlerat dhe besimet e tyre;
- shpjegojnë nevojën për ligje dhe politika për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike, të tilla si: siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe konsumatorëve, rregullimi i gjërave të dobishme, si radioja, televizioni etj.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë me shembuj ndikimin e kulturës në zgjedhjet dhe arritjet e shkencës dhe teknologjisë, si në transport, mjekësi etj.;
- përshkruajnë me shembuj se si shkenca dhe teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe shoqërore, për marrëdhëniet e tyre me tokën, për jetën e kafshëve, për jetën familjare, nevojat ekonomike dhe sigurinë;
- përshkruajnë ndikimin e zbulimeve të reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i gjithësisë, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike në vlerat dhe besimet e tyre;
- përshruajnë me shembuj nevojën e ligjeve dhe të politikës për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike, të tilla si: siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe konsumatorëve, rregullimi i gjërave të dobishme, si radioja, televizioni etj.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë raste të ndikimit të elementeve të kulturës në arritje të veçanta në fushën e shkencës dhe të teknologjisë, si në transport, mjekësi;

- dallojnë raste të ndikimit të shkencës dhe teknologjisë në ndryshimin e perceptimeve të njerëzve për jetën e tyre ekonomike dhe shoqërore dhe marrëdhëniet me natyrën;
- dallojnë raste të veçanta të ndikimit të zbulimeve të reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i gjithësisë, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike në vlerat dhe besimet e tyre;
- tregojnë ose flasin për raste të nevojës së ligjeve për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike, të tilla si: siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe konsumatorëve, rregullimi i gjërave të dobishme, si radioja, televizioni etj.

LINJA 9: Ndërvarësia (dimensioni europian dhe global)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me realitetet e ndërvarësisë rajonale dhe globale dhe rëndësinë, në rritje, të lidhjeve të ndryshme globale. Ata aftësohen të eksplorojnë çështje që lidhen ose janë pasojë e globalizimit.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përshkruajnë me shembuj ndikimin e kulturës në rritjen ose jo të mirëkuptimit global;
- përshkruajnë dhe analizojnë ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global;
- shqyrtojnë shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose të reja, si: shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit;
- shpjegojnë marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet mundësisë për të marrë vendime të pavarura në interesin kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla, si: territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë dhe mirëqenia e popujve;
- argumentojnë me shembuj ekzistencën e problemeve globale, si të drejtat e njeriut, ndotja e mjedisit, paqja etj., si dhe shprehin qëndrimin e tyre personal për pasojat e tyre për botën;

- përshkruajnë rolin e organizmave ndërkombëtarë dhe të organizatave ndërshtetërore dhe disa nga raportet që ato krijojnë me organizmat kombëtarë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë ndikimin e elementeve të veçanta kulturore (gjuha, besimet, arti etj.) në rritjen ose jo të mirëkuptimit në nivel kombëtar ose global;
- përshkruajnë ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global;
- përshkruajnë disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose reja, si: shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit, si dhe disa prej pasojave të tyre;
- përshkruajnë disa prej rrjedhøjave pozitive ose negative të marrëdhënieve ose kontradiktave të vendit me komunitetin ndërkombëtar, lidhur me çështje të tilla, si: territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë, mirëqenia e popujve etj.;
- përshkruajnë me shembuj disa nga çështjet më të njohura globale, si të drejtat e njeriut, mjedisin, paqen etj.;
- përshkruajnë disa nga karakteristikat kryesore të organizmave kryesorë ndërkombëtarë dhe të organizatave ndërshtetërore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë raste ose elemente të veçanta kulturore që kanë luajtur dhe luajnë rol në mirëkuptimin ose jo në nivel kombëtar ose global;
- dallojnë raste, shembuj, të ndikimit të teknologjisë në komunitetin global;
- identifikojnë disa prej problemeve bashkëkohore ose të trashëguara, për shembull, në fushën e shëndetit, e mjedisit, e shpërndarjes së të ardhurave etj., dhe disa prej pasojave të tyre; dallojnë probleme të veçanta që lindin nga marrëdhëniet ndërmjet kombit me vendet e tjera lidhur me çështje të tilla, si: territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë, mirëqenia e popujve etj.;
- identifikojnë çështje të njohura globale, si: të drejtat e njeriut, mjedisin, paqen etj.;

- përmendin organizmat kryesorë ndërkombëtarë dhe të organizatave ndërshtetërore.

LINJA 10: Ideale dhe praktika të qytetarisë (dimensioni politik, i të drejtave të njeriut, i përgjegjësisë vetjake e shoqërore, i pjesëmarrjes qytetare)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështjet që lidhen me të kuptuarit e idealeve dhe të praktikave të qytetarisë, si faktorë të rëndësishëm e vendimtarë për një pjesëmarrje të plotë, të përgjegjshme, aktive e cilësore në shoqëri.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shqyrtojnë e shpjegojnë origjinën dhe ndikimin e vazhdueshëm të idealeve të shoqërisë demokratike, si: dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës;
- shqyrtojnë dhe interpreton informacione për çështje të ndryshme publike;
- shfrytëzojnë informacione për çështje të veçanta publike;
- praktikojnë dhe udhëheqin forma të thjeshta diskutimesh në përputhje me idealet e shoqërisë demokratike;
- marrin pjesë në forma të ndryshme diskutimesh për çështje publike, që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike;
- analizojnë veprimet e ndryshme që qytetarët duhet të ndërmarrin për të ndikuar në vendimet e politikës publike, si dhe shpjegojnë arsyen e veprimeve të ndërmarra;
- shpjegojnë rolin që luajnë aktorët e ndryshëm politikë që veprojnë në sektorin publik dhe në shoqërinë civile në hartimin dhe në modelimin e politikës publike dhe të procesit të vendimmarrjes;
- analizojnë ndikimin e formave të ndryshme të opinionit publik në zhvillimin e politikës dhe në procesin e vendimmarrjes për çështjet publike;
- analizojnë efektshmërinë e politikave të caktuara publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike;

- shpjegojnë marrëdhëniet ndërmjet politikave të shpallura dhe planit të veprimeve, që përdoret për të trajtuar çështjet në interes të përbashkët;
- shqyrtojnë, analizon, shpjegojnë strategjitë e hartuara për realizmin dhe fuqizimin e të mirës së përbashkët.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë ndikimin e idealeve të shoqërisë demokratike, si: dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës;
- grumbullojnë dhe organizojnë informacion për çështje publike; dallojnë këndvështrimet e ndryshme për to;
- marrin pjesë në forma të thjeshta diskutimesh për çështje publike, që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike;
- përshkruajnë veprime të ndryshme që qytetarët mund të marrin për të ndikuar në vendimet publike;
- përshkruajnë rolin që mund të luajnë aktorët kryesorë që veprojnë në sektorin publik dhe në shoqërinë civile dhe në procesin e vendimmarrjes;
- përshkruajnë format e ndryshme të opinionit publik;
- përshkruajnë rolin e tyre në çështje të ndryshme publike;
- përshkruajnë ndikimin e politikave publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike;
- krahasojnë dhe përshkruajnë lidhjet ndërmjet politikave dhe veprimeve lidhur me çështjet në interes të përbashkët;
- përshkruajnë lidhjet ndërmjet strategjive të hartuara për të mirën e përbashkët.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë raste të ndikimeve të idealeve të shoqërisë, si: liria, barazia, drejtësia në jetën e shoqërisë;
- identifikojnë dhe grumbullojnë fakte ose informacione që lidhen me çështje publike;
- me vështirësi mrrin pjesë në forma të thjeshta diskutimesh;
- ndjekin me vështirësi rregulla të domosdoshme për diskutimet që zhvillohen në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike;

- identifikojnë veprime të veçanta qytetare, që mund të ndikojnë në vendimet e grupit ose të komunitetit;
- dallojnë elemente të ndikimit të veprimit qytetar në vendimet e grupit ose të komunitetit ku bëjnë pjesë;
- identifikojnë dhe renditin elemente të veçanta të rolit që mund të luajnë aktorë të ndryshëm në politikën publike;
- dallojnë fusha të ndikimit të aktorëve të veçantë në procesin e vendimmarrjes;
- dallojnë forma të ndryshme të opinionit publik;
- dallojnë elemente të pjesshme të ndikimit të opinionit në çështje publike;
- dallojnë ndikimin e veprimeve ose të sjelljeve të caktuara të politikanëve në realizmin e idealeve të shoqërisë demokratike;
- identifikojnë, dallojnë, krahasojnë elemente të lidhjeve të veprimeve qytetare dhe interesave të përbashkëta;
- dallojnë, krahasojnë lidhje të elementeve të veçanta të strategjive të paraqitura dhe të mirës së përbashkët;
- dallojnë elemente të ndikimit të tyre në çështjet e interesit të përbashkët.

LINJA 11: Dimensioni i të drejtave të njeriut

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje të kulturës dhe të llojshmërisë kulturore. Ata kuptojnë se si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë dhe përshtaten ndaj kulturës, vlerësojnë rolin e kulturës në modelimin e jetës dhe të shoqërisë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përshkruajnë e klasifikojnë nevojat dhe dëshirat bazë të qenies njerëzore;
- shpjegojnë pse plotësimi i nevojave bazë të njeriut përbën një të drejtë që u takon si atij, ashtu edhe të tjerëve;
- përshkruajnë llojet kryesore të të drejtave dhe i grupojnë ato sipas veçorive në kategori të ndryshme, si: të drejtat personale, të drejtat civile dhe politike, të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, të

drejtat për një mjedis të shëndetshëm; diskutojnë rreth ndryshimeve të tyre;

- shpjegojnë se të drejtat veprojnë në një fushë të caktuar dhe kanë kufizimet e tyre;
- argumentojnë se të drejtat kufizohen nga nevoja për të respektuar të drejtat e tij dhe të të tjerëve në emër të harmonisë shoqërore;
- shpjegojnë me shembuj rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për vete dhe për të tjerët;
- vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuara lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave;
- respektojnë dhe ndërmarrin veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- bëjnë dallimin ndërmjet nevojave dhe dëshirave të individit;
- përshkruajnë lidhjen ndërmjet të drejtave të njeriut dhe nevojave bazë të tij;
- bëjnë dallimin ndërmjet kategorive të ndryshme të të drejtave civile e politike, ekonomike, sociale dhe kulturore;
- përshkruajnë me shembuj kufizimin e të drejtave në jetën e përditshme, në familje, klasë etj., për shembull, e drejta për shprehur dhe e drejta e njerëzve për të pasur jetën e tyre private pa ndërhyrje nga të tjerët;
- përshkruajnë rëndësinë që kanë të drejta të caktuara për jetën e individit;
- mbajnë qëndrim të caktuar lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave;
- marrin pjesë në veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë nevoja dhe dëshira bazë të individit pa pasur të qartë ndryshimin ndërmjet tyre;
- dallojnë elemente të lidhjes së të drejtave të njeriut me nevojat dhe dëshirat e tij;

- identifikojnë të drejtat dhe liritë themelore në dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut dhe në kushtetutën shqiptare;
- dallojnë raste të kufizimit të të drejtave në jetën e përditshme;
- flasin për rëndësinë e të drejtave të njeriut, për jetën e tij;
- marrin pjesë në diskutime lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave;
- mbështetin veprimet konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të tjerëve.

III. SHEMBUJ TË STANDARDEVE TË ARRITJES SIPAS LËNDËVE

1. STANDARDET E ARRITJES NË LËNDËN “UNË DHE SHOQËRIA” KLASAT 1-6

Në përfundim të klasës së 6-të:

Nxënësit analizojnë më mirë veten dhe procesin e rritjes, vlerësojnë rritjen e shëndetshme, kujdesen për veten në mënyrë të përgjegjshme e të pavarur, forcojnë vetëbesimin, vlerësojnë mëvetësinë e individit, duke respektuar dallimet dhe shmangin rreziqet e parandalojnë konfliktet dhe aksidentet. Ata ndërveprojnë me të tjerët për të krijuar marrëdhënie shoqërore të shëndetshme, duke i trajtuar ata me dinjitet e respekt dhe duke respektuar këndvështrimet, vlerat dhe besimet e të tjerëve. Nxënësit marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri, vlerësojnë të mirën e përbashkët dhe kontribuojnë në mbarëvajtjen e shkollës, të komunitetit dhe të shoqërisë. Ata respektojnë ndërvlerësinë shoqërore, politike, ekonomike e kulturore në shoqërinë globale, duke vlerësuar njëkohësisht trashëgiminë natyrore e kulturore të vendit të tyre.

LINJA 1. Unë

Standardi i të nxënës

Nxënësit analizojnë më mirë veten dhe procesin e rritjes, vlerësojnë rritjen e shëndetshme, kujdesen për veten në mënyrë të përgjegjshme e të pavarur,

forcojnë vetëbesimin, vlerësojnë mëvetësinë e individit, duke respektuar dallimet dhe shmangin rreziqet e parandalojnë konfliktet dhe aksidentet.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë përvojat e tyre jetësore në mënyrë kritike;
- ndjekin strategji për arritjen e objektivave që i caktojnë vetes;
- marrin vendime të mirinformuara;
- respektojnë mëvetësinë e individit;
- vlerësojnë larminë e personalitetit njerëzor;
- demonstrojnë vetëbesim;
- demonstrojnë sjellje të pavarura;
- formojnë qëndrime;
- analizojnë faktorët që ndikojnë në ndjenjat e tyre;
- analizojnë shkaqet dhe pasojat e abuzimit me substancat e ndryshme;
- analizojnë qëndrimet e tyre dhe të shoqërisë ndaj abuzuesve;
- mbajnë përgjegjësi për shëndetin e tyre duke ndjekur dietë të ekuilibruar;
- mbrohen nga sëmundjet e transmetueshme;
- shmangin sjelljet dhe situatat e rrezikshme;
- demonstrojnë sjellje të përgjegjshme për sigurinë rrugore për veten e të tjerët.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë përvojat e tyre jetësore;
- hartojnë strategji për arritjen e objektivave që i caktojnë vetes;
- marrin vendime;
- vlerësojnë rëndësinë e mëvetësisë së individit;
- përshkruajnë dallimet e personalitetit njerëzor;
- vlerësojnë rëndësinë e vetëbesimit;
- vlerësojnë rëndësinë e sjelljeve të pavarura;
- respektojnë qëndrimet e të tjerëve;
- analizojnë sesi faktorë të ndryshëm shkaktojnë ndjenja të ndryshme;

- përshkruajnë dëmet e abuzimit me substancat e ndryshme;
- dallojnë qëndrimet e tyre dhe të shoqërisë ndaj abuzuesve;
- njohin përbërësit e dietës së ekuilibruar dhe përgjegjësinë e gjithsecilit për të jetuar në mënyrë të shëndetshme;
- përshkruajnë shkaqet dhe pasojat e sëmundjeve të transmetueshme;
- dallojnë sjelljet dhe situatat e rrezikshme;
- dallojnë sjelljet e përgjegjshme për veten e të tjerët për sigurinë rrugore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë përvojat e tyre jetësore;
- caktojnë objektiva për veten;
- bëjnë zgjedhje për veten;
- dallojnë se individët janë të ngjashëm, por edhe të ndryshëm;
- emërtojnë ndjenjat e tyre;
- përshkruajnë disa nga rreziqet që shkaktajnë substancat e dëmshme për shëndetin;
- përshkruajnë disa nga përbërësit e dietës së ekuilibruar;
- përshkruajnë disa nga sëmundjet e transmetueshme;
- dallojnë sjelljet dhe situatat e rrezikshme;
- përshkruajnë disa nga rregullat e sigurisë rrugore.

LINJA 2. Unë dhe të tjerët

Standardi i të nxënit

Nxënësit ndërveprojnë me të tjerët për të krijuar marrëdhënie shoqërore të shëndetshme, duke i trajtuar ata me dinjitet e respekt dhe duke respektuar këndvështrimet, vlerat dhe besimet e të tjerëve.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë dobinë e përkatësisë në familje e shoqëri;
- analizojnë ndikimin e miqve në veprimet që ndërmarrin;
- vlerësojnë rolin e komunikimit në marrëdhëniet shoqërore;

- përballojnë ndryshimet që pësojnë marrëdhëniet familjare e shoqërore gjatë rritjes;
- analizojnë në mënyrë kritike portretizimin e familjes në media;
- vlerësojnë rolin e identitetit gjinor në marrëdhëniet familjare e shoqërore;
- analizojnë shkaqet e pasojat e problemeve me miqtë;
- parandalojnë dhe zgjidhin konfliktet në mënyrë paqësore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë konceptin e përkatësisë në familje e në shoqëri;
- analizojnë ndikimin e miqve në veprimet që ndërmarrin;
- analizojnë rolin që luan komunikimi në marrëdhëniet shoqërore;
- dallojnë ndryshimet që pësojnë marrëdhëniet familjare e shoqërore gjatë rritjes;
- krahasojnë portretizimin e familjes në media me atë të jetës së vërtetë;
- analizojnë rolin që luan identiteti gjinor në marrëdhëniet familjare e shoqërore;
- dallojnë problemet që kanë me miqtë;
- përshkruajnë teknika të parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve në mënyrë paqësore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë marrëdhëniet familjare, përfshi rolin dhe profesionin e secilit anëtar të familjes;
- përshkruajnë sesi marrëdhëniet në familje dhe ato shoqërore ndryshojnë gjatë rritjes;
- përshkruajnë problemet që kanë me miqtë;
- vlerësojnë rëndësinë e zgjidhjes në mënyrë paqësore të konflikteve.

LINJA 3. Unë dhe bota

Standardi i të nxënësve

Nxënësit marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri, vlerësojnë të mirën e përbashkët dhe kontribuojnë në mbarëvajtjen e shkollës, të komunitetit dhe

të shoqërisë. Ata respektojnë ndërvlerësinë shoqërore, politike, ekonomike e kulturore në shoqërinë globale, duke vlerësuar njëkohësisht trashëgiminë natyrore e kulturore të vendit të tyre

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë organizimin dhe funksionimin e komunitetit ku jetojnë;
- vlerësojnë larminë kulturore të komunitetit e të shoqërisë;
- respektojnë të drejtat dhe përgjegjësitë në shkollë, komunitet e më gjerë;
- analizojnë rolin që luan promovimi i paqes në arritjen e drejtësisë shoqërore;
- marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën shoqërore të shkollës, komunitetit e më gjerë;
- vlerësojnë historikun e komunitetit të tyre;
- analizojnë ndryshimet historike që ka pësuar komuniteti ku jetojnë;
- vlerësojnë trashëgiminë natyrore dhe atë shoqërore të Shqipërisë;
- vlerësojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e pasurive natyrore e kulturore të vendit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë organizimin dhe funksionimin e komunitetit ku jetojnë;
- respektojnë larminë kulturore të komunitetit e të shoqërisë;
- respektojnë të drejtat dhe përgjegjësitë në shkollë, komunitet e më gjerë;
- vlerësojnë rolin që luan promovimi i paqes në arritjen e drejtësisë shoqërore;
- vlerësojnë rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore të shkollës, komunitetit e më gjerë;
- përshkruajnë historikun e komunitetit të tyre;
- përshkruajnë ndryshimet historike që ka pësuar komuniteti ku jetojnë;
- përshkruajnë trashëgiminë natyrore dhe atë shoqërore të Shqipërisë;
- vlerësojnë dobinë e mbrojtjes dhe të zhvillimit të pasurive natyrore e kulturore të vendit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë disa nga organizmat dhe funksionet e tyre në komunitetin ku jetojnë;
- përshkruajnë larminë kulturore të komunitetit e shoqërisë;
- përshkruajnë disa nga të drejtat dhe përgjegjësitë në shkollë, komunitet e më gjerë;
- përshkruajnë historinë e komunitetit të tyre;
- përshkruajnë disa nga tiparet gjeografike të komunitetit të tyre;
- përshkruajnë ç'janë pasuritë natyrore e kulturore të vendit.

2. STANDARDET (NIVELET) E ARRITJES SË NXËNËSIT NË LËNDËN "QYTETARIA", NË PËRFUNDIM TË KLASËS SË 9-TË

Modeli i përshkrimit të arritjeve të nxënësve në tri nivele, në lëndën "Qytetaria"

Niveli bazë

Në këtë nivel arritjeje, nxënësi, në fund të klasës së nëntë:

- identifikon raste të ndikimeve të idealeve të shoqërisë, si: liria, barazia, drejtësia në jetën e shoqërisë;
- **identifikon** dhe **grumbullon** fakte ose informacione që lidhen me çështje publike;
- me **vështirësi merr pjesë** në forma të thjeshta diskutimesh; **ndjek** me **vështirësi** rregulla të domosdoshme për diskutimet që zhvillohen në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike;
- **identifikon** veprime të veçanta qytetare që mund të ndikojnë në vendimet e grupit ose të komunitetit; **dallon** elemente të ndikimit të veprimit qytetar në vendimet e grupit ose të komunitetit ku bën pjesë;
- **identifikon** dhe **rendit** elemente të veçanta të rolit që mund të luajnë aktorë të ndryshëm në politikën publike; **dallon** fusha të ndikimit të aktorëve të veçantë në procesin e vendimmarrjes;
- **dallon** forma të ndryshme të opinionit publik; **dallon** elemente të pjesshme të ndikimit të opinionit në çështje publike;
- **dallon** ndikimin e veprimeve ose të sjelljeve të caktuara të politikanëve në realizmin e idealeve të shoqërisë demokratike;

- **dallon, krahason** elemente të lidhjeve të veprimeve qytetare dhe interesave të përbashkëta;
- **dallon, krahason** lidhje të elementeve të veçanta të strategjive të paraqitura dhe të mirës së përbashkët; dallon elemente të ndikimit të tyre në çështjet e interesit të përbashkët.

Niveli mesatar

Në këtë nivel arrijteje, nxënësi, në fund të klasës së nëntë:

- **përshkruan** ndikimin e idealeve të shoqërisë demokratike, si: dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës;
- **grumbullon** dhe **organizon** informacion për çështje publike; dallon këndvështrimet e ndryshme për to;
- **praktikon** forma të thjeshta diskutimesh; **merr pjesë** në forma të thjeshta diskutimesh për çështje publike që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike;
- **përshkruan** veprime të ndryshme që qytetarët mund të marrin për të ndikuar në vendimet publike;
- **përshkruan** rolin që mund të luajnë aktorët kryesorë që veprojnë në sektorin publik dhe në shoqërinë civile dhe në procesin e vendimmarrjes;
- **përshkruan** format e ndryshme të opinionit publik;
- **përshkruan** rolin e tyre në çështje të ndryshme publike;
- **përshkruan** ndikimin e politikave publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike;
- **krahason** dhe **përshkruan** lidhjet ndërmjet politikave dhe veprimeve lidhur me çështjet në interes të përbashkët;
- **përshkruan** lidhjet ndërmjet strategjive të hartuara për të mirën e përbashkët dhe vetë të mirës së përbashkët.

Niveli i lartë

Në këtë nivel arrijteje, nxënësi, në fund të klasës së nëntë:

- **shqyrton dhe shpjegon** origjinën dhe ndikimin e vazhdueshëm të idealeve të shoqërisë demokratike, si: dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës;
- **shqyrton** dhe **interpretton** informacione për çështje të ndryshme publike; **shfrytëzon** informacione për çështje të veçanta publike;

- **praktikon** dhe **udhëheq** forma të thjeshta diskutimesh në përputhje me idealet e shoqërisë demokratike; **merr pjesë** në forma të ndryshme diskutimesh për çështje publike, që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike;
- **analizon** veprimet e ndryshme që qytetarët duhet të ndërmarrin për të ndikuar në vendimet e politikës publike dhe **shpjegon** arsyen e veprimeve të ndërmarra;
- **shpjegon** rolin që luajnë aktorët e ndryshëm politikë që veprojnë në sektorin publik, në shoqërinë civile, në hartimin dhe në modelimin e politikës publike dhe të procesit të vendimmarrjes;
- **analizon** ndikimin e formave të ndryshme të opinionit publik në zhvillimin e politikës dhe në procesin e vendimmarrjes për çështjet publike;
- **analizon** efektshmërinë e politikave të caktuara publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike;
- **shpjegon** marrëdhëniet ndërmjet politikave të shpallura dhe planit të veprimeve që përdoret për të trajtuar çështjet në interes të përbashkët;
- shqyrton, analizon, shpjegon strategjitë e hartuara për realizimin dhe fuqizimin e të mirës së përbashkët.

3. SHEMBUJ TË STANDARDEVE TË ARRITJES NË LËNDËN “QYTETARIA”, SIPAS LINJAVE TË STANDARDEVE TË TË NXËNIT PËR KLASAT 7-9

Lënda “Qytetaria”

Në përfundim të klasës 9-të

Nxënësit eksplorojnë dhe bëjnë pyetje për natyrën e kulturave të ndryshme dhe për zhvillimet e tyre në kohë dhe në hapësirë. Ata analizojnë aspekte të ndryshme të kulturës, si gjuha dhe besimet, si dhe ndikimin e tyre në sjelljen njerëzore.

Nxënësit vazhdojnë të zgjerojnë të kuptuarit e tyre për të kaluarën dhe bëhen gjithnjë e më të aftë të zbatojnë metodat e kërkimit që lidhen me hulumtimin historik. Ata demonstronë një nivel më të thelluar të të kuptuarit dhe të vlerësimit të këndvështrimeve të ndryshme të ngjarjeve

dhe zhvillimeve historike dhe pranojnë që interpretimet ndikohen nga përvojat individuale, nga burimet e zgjedhura, nga vlerat shoqërore dhe nga traditat kulturore. Ata janë më të aftë të përdorin burime të shumëfishta për të ndërtuar interpretimet e tyre për ngjarjet dhe epokat e së kaluarës.

Nxënësit eksplorojnë njerëz, popuj, vende dhe mjedise në vendin e tyre dhe në rajone të tjera të botës. Ata vlerësojnë çështje të tilla, si: rritja e popullsisë dhe ndikimi i saj, faktorët që i shtyjnë njerëzit të migrojnë nga një vend dhe ata faktorë që i tërheqin ata përsëri në vendin e origjinës, si dhe shkaqet dhe ndikimi i ndryshimeve mjedisore në nivel kombëtar dhe global.

Nxënësit përfitojnë nga njohuritë dhe përvojat e tyre për të shqyrtuar ndryshimin e institucioneve në kohë dhe hapësirë, si ato që nxitin konformizimin shoqëror dhe ushtrojnë ndikimin e tyre te kultura. Ata përdorin njohuritë e tyre për të sugjeruar të punojnë për ndryshimin e institucioneve për të mirën e përgjithshme.

Nga ekzaminimi i qëllimeve dhe i karakteristikave të sistemeve të ndryshme të qeverisjes, nxënësit shpjegojnë si grupet dhe kombet përpiqen të zgjidhin konfliktet dhe të vendosin rregull dhe siguri. Përmes studimit të marrëdhënieve dinamike midis të drejtave dhe përgjegjësive individuale, nevojave të grupeve sociale dhe koncepteve të një shoqërie të drejtë, nxënësit zgjidhin probleme dhe marrin vendime në mënyrë më efektive kur ju drejtohen çështjeve të përhershme dhe problemeve sociale që shtrohen në jetën publike.

Nxënësit analizojnë bashkëveprimin ndërmjet shteteve dhe kombeve bashkë me natyrën e ndërlikuar të kulturave të tyre, ndërkohë që shprehin dhe mendimin e tyre për ngjarjet dhe ndryshimet.

Nxënësit i kanë zgjeruar njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe analizojnë e vlerësojnë marrëdhëniet ndërmjet idealeve dhe praktikës së qytetarisë. Në këtë moshë ata shohin veten e tyre si qytetarë të një grupi shoqëror dhe mendojnë për rolin e tyre në të.

LINJA 1: Kultura (dimensioni kulturor)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje të kulturës dhe të llojshmërisë kulturore. Ata kuptojnë se si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë e përshtaten ndaj kulturës, vlerësojnë rolin e kulturës në modelimin e jetës dhe të shoqërisë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- krahasojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre;
- shpjegojnë se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë informacionet dhe përvojat;
- shpjegojnë dhe japin shembuj për mënyrën e ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës;
- shpjegojnë pse individët dhe grupet reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre;
- përshkruajnë ndikimin dhe bashkëveprimin e diversitetit kulturor, si dhe të kohezionit social brenda dhe ndërmjet grupeve.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- identifikojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre;
- dallojnë këndvështrimet e ndryshme të njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore për probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore;
- dallojnë dhe japin shembuj të ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës;
- përshkruajnë reagimet e ndryshme të individëve dhe të grupeve ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre;
- krahasojnë raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të diversitetit kulturor brenda dhe ndërmjet grupeve.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë ngjashmëri dhe ndryshime në mënyrën se si individë dhe grupe të ndryshme plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre;

- dallojnë faktin që njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme për probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore;
- dallojnë raste të ndikimit të gjuhës, të traditave dhe të sjelljeve në zhvillimin e kulturës;
- dallojnë elemente të lidhjeve ndërmjet reagimeve të ndryshme të individëve dhe të grupeve ndaj mjediseve shoqërore ose ndryshimeve dhe pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre;
- dallojnë raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore brenda dhe ndërmjet grupeve.

LINJA 2: Zhvillimi individual dhe identiteti

(dimensioni vetjak dhe shoqëror)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me zhvillimin individual dhe atë shoqëror. Ata mësojnë se identiteti vetjak formohet nga ndikimi i familjes, i grupit shoqëror, i kulturës dhe i institucioneve. Në këtë linjë studimi, nxënësit shqyrtojnë faktorët që ndikojnë në identitetin e tyre vetjak, në zhvillimin dhe në veprimet e tyre.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë lidhjet e tyre personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore;
- vlerësojnë ndikimet e kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale;
- shpjegojnë mënyrat se si familja, feja, gjinia, etnia, kombësia, statusi social-ekonomik, faktorë të tjerë kulturorë ose të grupeve ndikojnë ndaj zhvillimit të ndjenjës së identitetit personal;
- zbatojnë në mënyrë sistematike koncepte, metoda dhe teori për studimin e rritjes dhe zhvillimit njerëzor, si: zhvillimi fizik, të nxënës, motivimi, sjellja, perceptimi dhe personaliteti;
- analizojnë ndërveprimin e ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose situata të veçanta;
- analizojnë rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;

- vlerësojnë ndikimin që ushtrojnë stereotipat, konformizmi, altruizmi dhe sjellje të tjera tek individët dhe te grupet;
- shpjegojnë faktorët që ndikojnë në zhvillimin ose në dëmtimin e shëndetit mendor;
- analizojnë çështjet që lidhen me shëndetin mendor dhe me çrregullimet e sjelljes në shoqërinë bashkëkohore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë lidhjet e tyre personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore;
- përshkruajnë ndikimet e kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale;
- përshkruajnë mënyrat se si familja, feja, gjinia, etnia, kombësia, statusi social-ekonomik, faktorë të tjerë kulturorë ose të grupeve ndikojnë ndaj zhvillimit të ndjenjës së identitetit personal; përdorin koncepte të ndryshme për studimin e rritjes dhe zhvillimit njerëzor, si: zhvillimi fizik, të nxënës, motivimi, sjellja, perceptimi dhe personaliteti;
- përshkruajnë ndërveprimin e ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose në situata të veçanta;
- përshkruajnë rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;
- përshkruajnë ndikimin që ushtrojnë stereotipat, konformizmi, altruizmi dhe sjellje të tjera tek individët dhe te grupet;
- shqyrtojnë faktorët që ndikojnë në zhvillimin ose dëmtimin e shëndetit mendor;
- përshkruajnë çështjet që lidhen me shëndetin mendor dhe me çrregullimet e sjelljes në shoqërinë bashkëkohore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë elemente që shprehin lidhjet e tij personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore;
- identifikojnë raste të ndikimeve të kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale;
- dallojnë raste të ndikimit të familjes, gjinisë, fesë, statusit ekonomik dhe social etj., në zhvillimin e ndjenjës së identitetit personal;
- përdorin *me vështirësi* koncepte të ndryshme për studimin e rritjes

dhe zhvillimit njerëzor, si: zhvillimi fizik, të nxënës, motivimi, sjellja, perceptimi dhe personaliteti;

- dallojnë raste të ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose situata të veçanta;
- flasin për rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;
- dallojnë raste të ndikimit të sjelljeve konformiste, altruiste ose stereotipa të individëve dhe të grupet;
- identifikojnë faktorë që ndikojnë në zhvillimin ose dëmtimin e shëndetit mendor.

LINJA 3: Individë, grupe dhe institucione (dimensioni shoqëror)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me institucione të tilla, si: familja dhe organizatat qytetare, arsimore, qeveritare e fetare dhe me mënyrën se si ato ushtrojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë institucionet.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësi:

- zbatojnë *sistematikisht* koncepte të tilla, si: roli, statusi dhe klasa shoqërore për të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri;
- analizojnë ndikimin e grupeve dhe institucioneve të njerëzve, ngjarjet dhe elementet e ndryshme kulturore në të kaluarën dhe sot;
- shpjegojnë zhvillimin e institucioneve në kohë dhe në hapësirë; analizojnë shembuj të kontradiktave ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe përpjekjeve që bëhen për të nxitur konformizimin shoqëror nga grupet dhe institucionet;
- shqyrtojnë sistemet e besimeve që qëndrojnë në themel të traditave dhe ligjeve në shoqërinë e sotme dhe gjatë historisë;
- vlerësojnë rolin e institucioneve si në drejtim të trashëgimisë dhe vazhdimësisë, ashtu edhe në drejtim të ndryshimit;
- analizojnë shkallën në të cilën grupet dhe institucionet plotësojnë interesat e individëve dhe interesat e përbashkëta në shoqërinë e sotme dhe në atë të së kaluarës.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin koncepte të tilla, si: roli, statusi dhe klasa shoqërore për të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri;
- përshkruajnë ndikimin e grupeve dhe institucioneve te njerëzit, ngjarjet dhe elementet e ndryshme kulturore në të kaluarën dhe sot;
- përshkruajnë zhvillimin e institucioneve në kohë dhe në hapësirë;
- identifikojnë shembuj të kontradiktave ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe përpjekjeve që bëhen për të nxitur konformizimin shoqëror nga grupet dhe institucionet;
- përshkruajnë besimet që qëndrojnë në themel të traditave dhe ligjeve në shoqërinë e sotme dhe gjatë historisë;
- përshkruajnë rolin e institucioneve si në drejtim të trashëgimisë dhe vazhdimësisë, ashtu edhe në drejtim të ndryshimit;
- përshkruajnë me shembuj shkallën në të cilën grupe dhe institucionet plotësojnë interesat e individëve dhe interesat e përbashkëta në shoqërinë e sotme dhe në atë të së kaluarës.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përdorin me vështirësi koncepte të tilla, si: roli, statusi dhe klasa shoqërore për të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri;
- listojnë raste të ndikimit të grupeve dhe të institucioneve te njerëzit, ngjarjet dhe elementet e ndryshme kulturore në të kaluarën dhe sot;
- flasin për ndryshime të institucioneve në kohë dhe në hapësirë;
- dallojnë raste të përpjekjeve të grupeve dhe të institucioneve për të nxitur konformizmin shoqëror;
- dallojnë raste të ndikimit të besimeve në ligjet e shoqërisë së të kaluarës dhe të sotme;
- nxjerrin në pah raste të ndikimit të institucioneve në fushën e trashëgimisë dhe të ndryshimit shoqëror;
- tregojnë raste të plotësimit ose jo të interesave të individëve ose të interesave të përbashkëta nga institucionet dhe grupet shoqërore.

LINJA 4: Pushteti, autoriteti dhe qeverisja (dimensioni politik)**Standardi**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështjet që lidhen me zhvillimin historik dhe bashkëkohor të formave të pushtetit, të autoritetit dhe të qeverisjes. Ata kuptojnë qëllimet dhe funksionet e qeverisjes, fushën dhe kufizimet e autoritetit, si dhe ndryshimet ndërmjet sistemeve politike demokratike dhe jodemokratike.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- shpjegojnë qëllimin e qeverisjes;
- analizojnë rrugën se si fitohet, ushtrohet dhe justifikohet pushteti;
- shpjegojnë idetë dhe mekanizmin që duhet për plotësimin e nevojave dhe dëshirave të qytetarëve, për të rregulluar territorin, manaxhuar konfliktet, vendosur rendin dhe sigurinë dhe balancën e koncepteve për një shoqëri të drejtë;
- analizojnë mënyrën se si kombet dhe organizatat e ndryshme u përgjigjen konflikteve ndërmjet forcës së unitetit dhe të diversitetit;
- krahasojnë sistemet e ndryshme politike (ideologjitë, strukturën, institucionet, proceset dhe kulturat politike) me sistemin shqiptar;
- analizojnë dhe vlerësojnë kushtet, veprimet dhe motivimet që ndihmojnë në konfliktet dhe bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet kombeve;
- shpjegojnë dhe zbatojnë *sistematikisht* ide, teori dhe mënyra të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë qëllimet dhe funksionet kryesore të qeverisjes, si dhe rrugën e fitimit, ushtrimit dhe justifikimit të pushtetit;
- përshkruajnë mekanizmin me anë të të cilit qytetarët duhet të përdorin për plotësimin e disa prej nevojave dhe dëshirave të tyre etj.;
- përshkruajnë mënyrat se si kombet dhe organizatat e ndryshme u përgjigjen konflikteve ndërmjet forcës së unitetit dhe të diversitetit;

- përshkruajnë tiparet kryesore të sistemit politik shqiptar dhe i krahasojnë ato me tiparet e një sistemi tjetër politik;
- përshkruajnë kushtet, veprimet dhe motivimet që ndihmojnë në konfliktet dhe në bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet kombeve;
- zbatojnë mënyra të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përmendin disa nga funksionet e qeverisjes, si dhe rrugët e fitimit dhe ushtrimit të pushtetit;
- identifikojnë forma të ndryshme që qytetarët përdorin për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre;
- përmendin forma të ndryshme të reagimeve të kombeve dhe organizatave ndaj konflikteve;
- dallojnë elemente të përbashkëta të sistemit politik shqiptar me një sistem tjetër politik të dhënë;
- përmendin faktorë të veçantë që ndihmojnë në konfliktet brenda dhe ndërmjet kombeve;
- përdorin *me vështirësi* elemente të hulumtimit të shkencave politike, për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.

LINJA 5: Ndërvarësia (dimensioni europian dhe global)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje që lidhen me realitetet e ndërvarësisë rajonale dhe globale dhe rëndësinë, në rritje, të lidhjeve të ndryshme globale. Ata aftësohen të eksplorojnë çështje që lidhen ose janë pasojë e globalizimit.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përshkruajnë me shembuj ndikimin e kulturës në rritjen ose jo të mirëkuptimit global;
- përshkruajnë dhe analizojnë ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global;

- shqyrtojnë shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose të reja, si: shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit;
- shpjegojnë marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet mundësisë për të marrë vendime të pavarura në interesin kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla, si: territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë dhe mirëqenia e popujve;
- argumentojnë me shembuj ekzistencën e problemeve globale, si të drejtat e njeriut, ndotja e mjedisit, paqja etj., si dhe shprehin qëndrimin e tyre personal për pasojat e tyre për botën;
- përshkruajnë rolin e organizmave ndërkombëtarë dhe të organizatave ndërshtetërore dhe disa nga raportet që ato krijojnë me organizmat kombëtarë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë ndikimin e elementeve të veçanta kulturore (gjuha, besimet, arti etj.) në rritjen ose jo të mirëkuptimit në nivel kombëtar ose global;
- përshkruajnë ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global;
- përshkruajnë disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose të reja, si: shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit, si dhe disa prej pasojave të tyre;
- përshkruajnë disa prej rrjedhojave pozitive ose negative të marrëdhënieve ose kontradiktave të vendit me komunitetin ndërkombëtar, lidhur me çështje të tilla, si: territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë, mirëqenia e popujve etj.;
- përshkruajnë me shembuj disa nga çështjet më të njohura globale si të drejtat e njeriut, mjedisin, paqja etj.;
- përshkruajnë disa nga karakteristikat kryesore të organizmave kryesorë ndërkombëtarë dhe të organizatave ndërshtetërore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë raste ose elemente të veçanta kulturore që kanë luajtur dhe luajnë rol në mirëkuptimin ose jo në nivel kombëtar ose global;

- dallojnë raste, shembuj, të ndikimit të teknologjisë në komunitetin global;
- identifikojnë disa prej problemeve bashkëkohore ose të trashëguara, për shembull, në fushën e shëndetit, e mjedisit, e shpërndarjes së të ardhurave etj., dhe disa prej pasojave të tyre;
- dallojnë probleme të veçanta që lindin nga marrëdhëniet ndërmjet kombit me vendet e tjera lidhur me çështje të tilla, si: territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë, mirëqenia e popujve etj.;
- identifikojnë çështje të njohura globale, si: të drejtat e njeriut, mjedisi, paqja etj.;
- përmendin organizmat kryesorë ndërkombëtarë dhe të organizatave ndërshtetërore.

LINJA 6: Ideale dhe praktika të qytetarisë (dimensioni politik, i të drejtave të njeriut, i përgjegjësisë vetjake e shoqërore, i pjesëmarrjes qytetare)

Standardi

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështjet që lidhen me të kuptuarit e idealeve dhe të praktikave të qytetarisë, si faktorë të rëndësishëm e vendimtarë për një pjesëmarrje të plotë, të përgjegjshme, aktive e cilësore në shoqëri.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shqyrtojnë e shpjegojnë origjinën dhe ndikimin e vazhdueshëm të idealeve të shoqërisë demokratike, si: dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës;
- shqyrtojnë dhe interpretojnë informacione për çështje të ndryshme publike;
- shfrytëzojnë informacione për çështje të veçanta publike;
- praktikojnë dhe udhëheqin forma të thjeshta diskutimesh në përputhje me idealet e shoqërisë demokratike;
- marrin pjesë në forma të ndryshme diskutimesh për çështje publike, që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike;
- analizojnë veprimet e ndryshme që qytetarët duhet të ndërmarrin

për të ndikuar në vendimet e politikës publike, si dhe shpjegojnë arsyen e veprimeve të ndërmarra;

- shpjegojnë rolin që luajnë aktorët e ndryshëm politikë që veprojnë në sektorin publik dhe në shoqërinë civile në hartimin dhe në modelimin e politikës publike dhe të procesit të vendimmarrjes;
- analizojnë ndikimin e formave të ndryshme të opinionit publik në zhvillimin e politikës dhe në procesin e vendimmarrjes për çështjet publike;
- analizojnë efektshmërinë e politikave të caktuara publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike;
- shpjegojnë marrëdhëniet ndërmjet politikave të shpallura dhe planit të veprimeve që përdoret për të trajtuar çështjet në interes të përbashkët;
- shqyrtojnë, analizojnë, shpjegojnë strategjitë e hartuara për realizmin dhe fuqizimin e të mirës së përbashkët.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë ndikimin e idealeve të shoqërisë demokratike, si: dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës;
- grumbullojnë dhe organizojnë informacion për çështje publike; dallojnë këndvështrimet e ndryshme për to;
- marrin pjesë në forma të thjeshta diskutimesh për çështje publike që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike;
- përshkruajnë veprime të ndryshme që qytetarët mund të marrin për të ndikuar në vendimet publike;
- përshkruajnë rolin që mund të luajnë aktorët kryesorë që veprojnë në sektorin publik dhe në shoqërinë civile dhe në procesin e vendimmarrjes;
- përshkruajnë format e ndryshme të opinionit publik;
- përshkruajnë rolin e tyre në çështje të ndryshme publike; përshkruajnë ndikimin e politikave publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike;
- krahasojnë dhe përshkruajnë lidhjet ndërmjet politikave dhe veprimeve lidhur me çështjet në interes të përbashkët;
- përshkruajnë lidhjet ndërmjet strategjive të hartuara për të mirën e përbashkët.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë raste të ndikimeve të idealeve të shoqërisë, si: liria, barazia, drejtësia në jetën e shoqërisë;
- identifikojnë dhe grumbullojnë fakte ose informacione që lidhen me çështje publike;
- me vështirësi marrin pjesë në forma të thjeshta diskutimesh; ndjekin me vështirësi rregulla të domosdoshme për diskutimet që zhvillohen në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike;
- identifikojnë veprime të veçanta qytetare që mund të ndikojnë në vendimet e grupit ose të komunitetit;
- dallojnë elemente të ndikimit të veprimit qytetar në vendimet e grupit ose të komunitetit ku bëjnë pjesë;
- identifikojnë dhe renditin elemente të veçanta të rolit që mund të luajnë aktorë të ndryshëm në politikën publike;
- dallojnë fusha të ndikimit të aktorëve të veçantë në procesin e vendimmarrjes;
- dallojnë forma të ndryshme të opinionit publik;
- dallojnë elemente të pjesshme të ndikimit të opinionit në çështje publike;
- dallojnë ndikimin e veprimeve ose të sjelljeve të caktuara të politikanëve në realizmin e idealeve të shoqërisë demokratike;
- identifikojnë, dallojnë, krahasojnë elemente të lidhjeve të veprimeve qytetare dhe interesave të përbashkëta;
- dallojnë, krahasojnë lidhje të elementeve të veçanta të strategjive të paraqitura dhe të mirës së përbashkët;
- dallojnë elemente të ndikimit të tyre në çështjet e interesit të përbashkët.

LINJA 7: Dimensioni i të drejtave të njeriut**Standardi**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për çështje të kulturës dhe të llojshmërisë kulturore. Ata kuptojnë se si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë dhe përshtaten ndaj kulturës, vlerësojnë rolin e kulturës në modelimin e jetës dhe të shoqërisë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- përshkruajnë e klasifikojnë nevojat dhe dëshirat bazë të qenies njerëzore;
- shpjegojnë pse plotësimi i nevojave bazë të njeriut përbën një të drejtë që u takon si atij, ashtu edhe të tjerëve;
- përshkruajnë llojet kryesore të të drejtave dhe i grupojnë ato sipas veçorive në kategori të ndryshme, si: të drejtat personale, të drejtat civile dhe politike, të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, të drejtat për një mjedis të shëndetshëm; diskutojnë rreth ndryshimeve të tyre;
- shpjegojnë se të drejtat veprojnë në një fushë të caktuar dhe kanë kufizimet e tyre;
- argumentojnë se të drejtat kufizohen nga nevoja për të respektuar të drejtat e tij dhe të të tjerëve në emër të harmonisë shoqërore;
- shpjegojnë me shembuj rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për vete dhe për të tjerët;
- vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuara lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave;
- respektojnë dhe ndërmarrin veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- bëjnë dallimin ndërmjet nevojave dhe dëshirave të individit; përshkruajnë lidhjen ndërmjet të drejtave të njeriut dhe nevojave bazë të tij;
- bëjnë dallimin ndërmjet kategorive të ndryshme të të drejtave civile e politike, ekonomike, sociale dhe kulturore;
- përshkruajnë me shembuj kufizimin e të drejtave në jetën e përditshme, në familje, klasë etj., për shembull, e drejta për t'u shprehur dhe e drejta e njerëzve për të pasur jetën e tyre private pa ndërhyrje nga të tjerët;
- përshkruajnë rëndësinë që kanë të drejta të caktuara për jetën e individit;

- mbajnë qëndrim të caktuar lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave;
- marrin pjesë në veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë nevoja dhe dëshira bazë të individit pa pasur të qartë ndryshimin ndërmjet tyre;
- dallojnë elemente të lidhjes së të drejtave të njeriut me nevojat dhe dëshirat e tij;
- identifikojnë të drejtat dhe liritë themelore në dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut dhe në kushtetutën shqiptare;
- dallojnë raste të kufizimit të të drejtave në jetën e përditshme;
- flasin për rëndësinë e të drejtave të njeriut, për jetën e tij;
- marrin pjesë në diskutime lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave;
- mbështetin veprimet konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.

SHEMBUJ TË STANDARDEVE TË ARRITJES NË LËNDËN “HISTORIA” SIPAS LINJAVE TË STANDARDEVE TË TË NXËNIT PËR KLASAT 1-6-9

Në përfundim të klasës 6 – të:

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për historinë, fillimisht nëpërmjet njohjes dhe kuptimit të historisë personale e familjare, historisë së zonës, për t’u zgjeruar më pas në njohjen dhe kuptimin e historisë së vendit dhe atë të qytetërimeve botërore në antikitet dhe mesjetë, në mënyrë që të kuptojnë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvlerësinë ndërmjet tyre, duke përfshirë këto periudha të historisë: Njohuritë historike dhe rrënjët e tij, Qytetërimi në parahistori, Qytetërimet botërore në antikitet (mijëvjeçari IV pr. K. - 400 ps. K.) dhe Qytetërimet botërore në mesjetë (400 ps. K. - 1450).

Nxënësit pajisen me aftësinë e kërkimit, aftësinë e interpretimit historik, aftësinë e organizimit të njohurive dhe të komunikimit të tyre në mënyra të ndryshme.

Në përfundim të klasës 9 – të:

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për historinë e shqiptarëve dhe për historinë e qytetërimit botëror, në mënyrë që të kuptojnë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvlerësinë ndërmjet qytetërimeve, duke përfshirë këto periudha të historisë sipas linjës kronologjike: Parahistoria dhe Antikiteti në territoret shqiptare deri në shek. V; Territoret arbërore në mesjetë (shek. VI - XIV); Qytetërimet në fillimet e historisë moderne (1450-1650); Shqiptarët në periudhën moderne (shek. XV - XIX); Koha e ndryshimeve thelbësore (1650-1914); Rilindja kombëtare shqiptare; Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945); Qytetërimet bashkëkohore (1945-sot); Shteti shqiptar gjatë shekullit XX; Shqipëria gjatë periudhës bashkëkohore (1945-sot) dhe Shqiptarët jashtë kufijve politikë (1912 - sot).

Nxënësit, për ndërtimin e ngjarjes historike, përdorin kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik, mbështeten në burimet historike (burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik) dhe teknologjinë, për të nxjerrë përfundime të arsyetuara dhe logjike.

LINJA 1: Njohuritë historike dhe rrënjët e tij

Standardi i të nxënës

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime mbi historinë personale dhe familjare, historinë e shkollës, historinë e zonës dhe rajonit, duke analizuar në mënyrë kritike zhvillimin e këtyre marrëdhënieve nga e kaluara në të tashmen, për të kuptuar vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkaktuese.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë rrënjët e tyre historike dhe të familjes së tyre, për të kuptuar kronologjinë, ndryshimin dhe vazhdimësinë;
- argumentojnë ndryshimet në historinë e familjeve të tyre ose të komunitetit ku jetojnë nëpërmjet përdorimit të burimeve të thjeshta historike, si: fotografi, veshje etj;
- analizojnë origjinën e emrit të shkollës, si dhe vlerësojnë figura të shquara të shkollës në vite;

- krahasojnë fotografi, vizatime të zonës në të kaluarën me ato të tanishme, duke nxjerrë në pah ndryshimin dhe vazhdimësinë e tyre;
- analizojnë origjinën dhe traditat e disa festave dhe festimeve në Shqipëri dhe në vende të tjera.
- analizojnë historinë dhe origjinën e simboleve tona kombëtare;
- vlerësojnë ngjarje të rëndësishme historike të zonës dhe të vendit të tyre;
- analizojnë karakteristikat dhe mënyrat e jetesës në të kaluarën dhe të sotmen nëpërmjet përdorimit të burimeve të thjeshta historike (fotografi, veshje etj.);
- vlerësojnë kontributin e disa prej figurave të shquara kombëtare, si: Gjergj Kastriot Skënderbeu, Ismail Qemali, Nënë Tereza etj.;
- vlerësojnë elemente të trashëgimisë kulturore të zonës së tyre, duke argumentuar historikun e trashëgimisë së këtyre pasurive;
- analizojnë momentet kyçe dhe ngjarjet më të rëndësishme të zhvillimit historik të qarkut, duke vlerësuar rolin e kohës në ndryshueshmërinë e njerëzve dhe të shoqërisë;
- vendosin në linjën e kohës ngjarjet historike të zonës së tyre;
- analizojnë aspektet më të rëndësishme të jetës së njerëzve në të shkuarën, si: origjina, gjuha, banesat, komunitetet e para, besimi, veprimtaritë e para ekonomike, bujqësia, poçaria, endja, veshjet, ushqimi, emigrimet;
- vlerësojnë ngjarjet më të rëndësishme në jetën shoqërore, ekonomike, shkencore dhe kulturore të vendit të tyre dhe botës gjerë;
- analizojnë zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë me lindjen e qyteteve, zhvillimin e tyre urban, zhvillimin ekonomik, bujqësor, industrial dhe teknologjik, shkëmbimin, artin, kulturën dhe arsimin;
- vlerësojnë shpikjet më të rëndësishme, të cilat çuan përpara zhvillimin e shoqërisë njerëzore;
- analizojnë marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore në të shkuarën dhe në të tashmen, si: marrëdhëniet e skllavopronarit me skllavin, bujkrobit me feudalën dhe punëdhënësit me punëmarrësin sot;
- vlerësojnë disa nga ndryshimet që kanë pasur ndikim thelbësor në jetën njerëzore, duke krahasuar marrëdhëniet e sotme shoqërore me ato në të shkuarën.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë rrënjët e tyre historike dhe të familjes së tyre, për të kuptuar kronologjinë, ndryshimin dhe vazhdimësinë;
- evidentojnë ndryshimet në historinë e familjeve të tyre ose të komunitetit ku jetojnë nëpërmjet përdorimit të burimeve të thjeshta historike, si: fotografi, veshje etj.;
- tregojnë origjinën e emrit të shkollës, si dhe vlerësojnë figura të shquara të shkollës në vite;
- krahasojnë fotografi, vizatime të zonës në të kaluarën me ato të tanishme, duke identifikuar ndryshimin dhe vazhdimësinë ndërmjet tyre;
- tregojnë origjinën dhe traditat e disa festave dhe festimeve në Shqipëri dhe vende të tjera;
- përshkruajnë historinë dhe origjinën e simboleve tona kombëtare;
- përshkruajnë ngjarje të rëndësishme historike të zonës dhe të vendit të tyre;
- evidentojnë karakteristikat dhe mënyrat e jetesës në të kaluarën dhe të sotmen nëpërmjet përdorimit të burimeve të thjeshta historike (fotografi, veshje etj.);
- përshkruajnë kontributin e disa prej figurave të shquara kombëtare, si: Gjergj Kastriot Skënderbeu, Ismail Qemali, Nënë Tereza etj.;
- përshkruajnë elemente të trashëgimisë kulturore të zonës së tyre, duke argumentuar historikun e trashëgimisë së këtyre pasurive;
- tregojnë momentet kyçe dhe ngjarjet më të rëndësishme të zhvillimit historik të qarkut, duke vlerësuar rolin e kohës në ndryshueshmërinë e njerëzve dhe të shoqërisë;
- evidentojnë në linjën e kohës ngjarjet historike të zonës së tyre;
- tregojnë aspektet më të rëndësishme të jetës së njerëzve në të shkuarën, si: origjina, gjuha, banesat, komunitetet e para, besimi, veprimtaritë e para ekonomike, bujqësia, poçaria, endja, veshjet, ushqimi, emigrimet;
- përshkruajnë ngjarjet më të rëndësishme në jetën shoqërore, ekonomike, shkencore dhe kulturore të vendit të tyre dhe të botës;
- shpjegojnë zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë me lindjen e qyteteve, zhvillimin e tyre urban, ekonomik, bujqësor, industrial dhe teknologjik; shkëmbimin, artin, kulturën dhe arsimin;

- evidentojnë shpikjet më të rëndësishme, të cilat çuan përpara zhvillimin e shoqërisë njerëzore;
- evidentojnë marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore në të shkuarën dhe në të tashmen, si: marrëdhëniet e skllavopronarit me skllavin, bujkrobit me feudalin dhe punëdhënësit me punëmarrësin sot;
- përshkruajnë disa nga ndryshimet që kanë pasur ndikim thelbësor në jetën njerëzore, duke krahasuar marrëdhëniet e sotme shoqërore me ato në të shkuarën.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë rrënjët e tyre historike dhe të familjes së tyre, për të kuptuar kronologjinë, ndryshimin dhe vazhdimësinë;
- përcaktojnë ndryshimet në historinë e familjeve të tyre ose të komunitetit ku jetojnë nëpërmjet përdorimit të burimeve të thjeshta historike, si: fotografi, veshje etj.;
- përcaktojnë origjinën e emrit të shkollës, si dhe vlerësojnë figura të shquara të shkollës në vite;
- krahasojnë fotografi, vizatime të zonës në të kaluarën me ato të tanishme, duke identifikuar ndryshimin dhe vazhdimësinë e tyre;
- identifikojnë origjinën dhe traditat e disa festave dhe festimeve në Shqipëri dhe vende të tjera;
- përcaktojnë historinë dhe origjinën e simboleve tona kombëtare;
- përcaktojnë ngjarjet më të rëndësishme historike të zonës dhe të vendit të tyre;
- përcaktojnë karakteristikat dhe mënyrat e jetesës në të kaluarën dhe në të sotmen nëpërmjet përdorimit të burimeve të thjeshta historike (fotografi, veshje etj.);
- identifikojnë kontributin e disa prej figurave të shquara kombëtare, si: Gjergj Kastriot Skënderbeu, Ismail Qemali, Nënë Tereza etj.;
- identifikojnë elemente të trashëgimisë kulturore të zonës së tyre, duke argumentuar historikun e trashëgimisë së këtyre pasurive;
- dallojnë momentet kyçe dhe ngjarjet më të rëndësishme të zhvillimit historik të qarkut, duke identifikuar rolin e kohës në ndryshueshmërinë e njerëzve dhe të shoqërisë;
- identifikojnë në linjën e kohës ngjarjet historike të zonës së tyre;
- përcaktojnë aspektet më të rëndësishme të jetës së njerëzve në të

shkuarën, si: origjina, gjuha, banesat, komunitetet e para, besimi, veprimtaritë e para ekonomike, bujqësia, poçaria, endja, veshjet, ushqimi, emigrimet;

- përcaktojnë ngjarjet më të rëndësishme në jetën shoqërore, ekonomike, shkencore dhe kulturore të vendit të tyre dhe të botës;
- identifikojnë zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë me lindjen e qyteteve, zhvillimin e tyre urban, ekonomik, bujqësor, industrial dhe teknologjik; shkëmbimin, artin, kulturën dhe arsimin;
- identifikojnë shpikjet më të rëndësishme, të cilat çuan përpara zhvillimin e shoqërisë njerëzore;
- përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore në të shkuarën dhe në të tashmen, si: marrëdhëniet e skllavopronarit me skllavin, bujkrobit me feudalin dhe punëdhënësit me punëmarrësin sot;
- përcaktojnë disa nga ndryshimet që kanë pasur ndikim thelbësor në jetën njerëzore, duke dalluar marrëdhëniet e sotme shoqërore me ato në të shkuarën.

LINJA 2: Qytetërimi në parahistori

Standardi i të nxënit

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për shoqërinë në parahistori, veprimtarinë e njeriut mbi natyrën si një proces evolutiv, për besimin dhe artet, fundin e parahistorisë dhe fillimin e historisë së qytetërimeve. Nxënësit, gjithashtu, demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për organizimin kronologjik të historisë, ata kryejnë veprime për llogaritjen e kohës (pr. K., ps. K.) dhe mësojnë të punojnë si historianë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë organizimin kronologjik të historisë, me qëllim vendosjen e ngjarjeve dhe njerëzve në periudha të ndryshme historike;
- përdorin saktë konceptet: parahistori, histori, antikitet, mesjetë;
- vlerësojnë etapat historike dhe ndryshimet fizike, ekonomike, sociale dhe kulturore që pësoi shoqëria parahistorike dhe evoluimin e saj në kohëra;

- argumentojnë karakteristikat e shoqërisë sipas epokave parahistorike, ndryshimet që ndodhën në to dhe krijimin e komuniteteve paranjerëzore;
- vlerësojnë historinë si një shkencë humane dhe llojet e burimeve historike si një domosdoshmëri në punën e historianit;
- kryejnë veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas Krishtit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- tregojnë organizimin kronologjik të historisë, me qëllim vendosjen e ngjarjeve dhe njerëzve në periudha të ndryshme historike;
- përcaktojnë konceptet: parahistori, histori, antikitet, mesjetë;
- tregojnë etapat historike dhe ndryshimet fizike, ekonomike, sociale dhe kulturore që pësoi shoqëria parahistorike dhe evoluimin e saj në kohëra;
- përshkruajnë karakteristikat e shoqërisë sipas epokave parahistorike, ndryshimet që ndodhën në to dhe krijimin e komuniteteve paranjerëzore;
- përshkruajnë historinë si një shkencë humane dhe llojet e burimeve historike si një domosdoshmëri në punën e historianit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë organizimin kronologjik të historisë, me qëllim vendosjen e ngjarjeve dhe njerëzve në periudha të ndryshme historike;
- dallojnë konceptet: parahistori, histori, antikitet, mesjetë;
- dallojnë etapat historike dhe ndryshimet fizike, ekonomike, sociale dhe kulturore që pësoi shoqëria parahistorike dhe evoluimin e saj në kohëra;
- identifikojnë karakteristikat e shoqërisë sipas epokave parahistorike, ndryshimet që ndodhën në to dhe krijimin e komuniteteve paranjerëzore;
- dallojnë historinë si një shkencë humane dhe llojet e burimeve historike si një domosdoshmëri në punën e historianit.

LINJA 3: Qytetërimet botërore në antikitet**Standardi i të nxënit**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime mbi lindjen e qytetërimit në luginat lumore dhe tiparet e qytetërimeve të hershme në Mesopotami dhe në Egjipt, si dhe qytetërimet në brigjet e deteve: Greqi dhe Romë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- analizojnë konceptin qytetërim, duke evidentuar tiparet dhe shtrirjen e tij në kohë dhe hapësirë;
- vlerësojnë rolin e mjedisit gjeografik në evolucionin e qytetërimeve në Mesopotami dhe në Egjipt;
- analizojnë ndërtimin shoqëror, ekonomik dhe shtetëror në Mesopotami dhe në Egjipt, duke evidentuar të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre;
- vlerësojnë rolin e kodit të Hamurabit si fillesë e veprimit të ligjit në qytetërimet antike;
- analizojnë tiparet themelore të qytetërimit grek dhe romak;
- analizojnë krijimin e të drejtës romake si një prej fillesave të legjislacionit botëror.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë konceptin qytetërim, tiparet dhe shtrirjen e tij në kohë dhe në hapësirë;
- shpjegojnë rolin e mjedisit gjeografik në evolucionin e qytetërimeve në Mesopotami dhe në Egjipt;
- përshkruajnë ndërtimin shoqëror, ekonomik dhe shtetëror në Mesopotami dhe në Egjipt, duke evidentuar të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre;
- tregojnë rolin e Kodit të Hamurabit, si fillesë e veprimit të ligjit në qytetërimet antike;
- përshkruajnë tiparet themelore të qytetërimit grek dhe atij romak;
- evidentojnë krijimin e të Drejtës Romake, si një prej fillesave të legjislacionit botëror.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përcaktojnë konceptin qytetërim, tiparet dhe shtrirjen e tij në kohë dhe në hapësirë;
- përcaktojnë rolin e mjedisit gjeografik në evolucionin e qytetërimeve në Mesopotami dhe në Egjipt;
- dallojnë ndërtimin shoqëror, ekonomik dhe shtetëror në Mesopotami dhe në Egjipt;
- përcaktojnë rolin e Kodit të Hamurabit, si fillesë e veprimit të ligjit në qytetërimet antike;
- përcaktojnë tiparet më themelore të qytetërimit grek dhe atij romak;
- përcaktojnë krijimin e të Drejtës Romake, si një prej fillesave të legjislacionit botëror.

LINJA 4: Qytetërimet botërore në mesjetë**Standardi i të nxënit**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për tiparet e qytetërimit bizantin, si: organizimin shtetëror, ekonomik, kulturor dhe fetar, si dhe tiparet e qytetërimit arab. Gjithashtu, ata mësojnë rreth kushteve historike të lindjes së besimit islam, përhapjes dhe veçorive të tij.

Përshkrimi sipas niveleve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- analizojnë etapat kryesore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë mesjetare;
- gjykojnë mbi strukturat ekonomike dhe shoqërore të Europës mesjetare;
- vlerësojnë rolin e Kartës së Madhe të Lirive, si baza e parlamentarizmit botëror;
- analizojnë tiparet e qytetërimit bizantin dhe shkaqet e krijimit të tij;
- analizojnë kushtet historike të përhapjes së islamit dhe ndikimin e qytetërimit arab në Europë;
- analizojnë tiparet politike, ekonomike dhe shoqërore të Francës dhe të Anglisë;
- analizojnë tiparet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit në qytetërimet mesjetare;

- argumentojnë lidhjet si brenda, ashtu dhe ndër periudha e shoqëri të ndryshme, të respektojnë origjinën historike dhe të kuptojnë dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë;
- analizojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak-pasojë;
- ndërtojnë pyetje dhe gjejnë përgjigje, vlerësojnë burimet historike, analizojnë interpretime të ndryshme dhe gjykojnë duke u bazuar në argumente.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë etapat kryesore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë mesjetare;
- përshkruajnë strukturat ekonomike dhe shoqërore të Europës mesjetare;
- evidentojnë rolin e Kartës së Madhe të Lirive si baza e parlamentarizmit botëror;
- përshkruajnë tiparet e qytetërimit bizantin dhe shkaqet e krijimit të tij;
- përshkruajnë kushtet historike të përhapjes së islamit dhe ndikimin e qytetërimit arab në Europë;
- përshkruajnë tiparet politike, ekonomike dhe shoqërore të Francës dhe të Anglisë;
- përshkruajnë lidhjet si brenda, ashtu dhe ndër periudha e shoqëri të ndryshme, të respektojnë origjinën historike dhe të kuptojnë dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë;
- tregojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak-pasojë;
- evidentojnë pyetje dhe gjejnë përgjigje, evidentojnë burimet historike, përshkruajnë interpretime të ndryshme dhe gjykojnë duke u bazuar në argumente.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë etapat kryesore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë mesjetare;
- identifikojnë strukturat ekonomike dhe shoqërore të Europës mesjetare;

- dallojnë rolin e Kartës së Madhe të Lirive, si baza e parlamentarizmit botëror;
- dallojnë tiparet e qytetërimit bizantin dhe shkaqet e krijimit të tij;
- identifikojnë kushtet historike të përhapjes së islamit dhe ndikimin e qytetërimit arab në Europë;
- identifikojnë tiparet politike, ekonomike dhe shoqërore të Francës dhe të Anglisë;
- dallojnë lidhjet si brenda, ashtu dhe ndër periudha e shoqëri të ndryshme, të respektojnë origjinën historike dhe të kuptojnë dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë;
- dallojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak-pasojë;
- dallojnë pyetje dhe identifikojnë përgjigje, dallojnë burimet historike, identifikojnë interpretime dhe përgjigjen duke u bazuar në argumente.

LINJA 5: Njohuritë historike dhe rrënjët e tyre

Standardi i të nxënit

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për historinë e shqiptarëve në mënyrë që të kuptojnë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, si dhe lidhjen e tyre me të tashmen dhe të ardhmen sipas linjës kronologjike.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë tipat e burimeve historike, si një domosdoshmëri në punën e historianit;
- analizojnë rrënjët historike të shqiptarëve;
- ndërtojnë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike të shqiptarëve;
- analizojnë ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare;
- vlerësojnë ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore, përshpejtuan dhe thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në periudha të ndryshme historike të popullit shqiptar;
- vlerësojnë ndikimin e ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë tipat e burimeve historike, si një domosdoshmëri në punën e historianit;
- përshkruajnë rrënjët historike të shqiptarëve;
- vendosin në linjën e kohës periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike të shqiptarëve;
- përshkruajnë ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare;
- përshkruajnë ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore, përshpejtuan dhe thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në periudha të ndryshme historike të popullit shqiptar;
- përshkruajnë ndikimin e ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë tipat e burimeve historike, si një domosdoshmëri në punën e historianit;
- përcaktojnë rrënjët historike të shqiptarëve;
- evidentojnë në linjën e kohës periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike të shqiptarëve;
- dallojnë ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare;
- dallojnë ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore, përshpejtuan dhe thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në periudha të ndryshme historike të popullit shqiptar;
- dallojnë ndikimin e ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej.

LINJA 6: Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare**Standardi i të nxënit**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për periudhën parahistorike dhe avancimin e kulturave të para në territoret shqiptare dhe në Ballkanin Perëndimor, kushtet e jetesës së njerëzve në periudhën

e gurit, bronzit dhe hekurit, shtrirjen e qytetërimit ilir, mënyrat e jetesës, organizimin shtetëror, kulturën ilire dhe ndikimin e kulturave fqinje greke dhe romake në territorin ilir.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- argumentojnë, shoqëruar me shembuj konkretë, ekzistencën e kulturave parahistorike në territoret shqiptare;
- analizojnë qytetërimin ilir, shtrirjen, mënyrat e jetesës, organizimin shtetëror e kulturor ilir;
- analizojnë veçoritë kryesore të fiseve ilire dhe format e organizimit shtetëror në territoret ilire;
- vlerësojnë kontributin e dinastive kryesore ilire.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- tregojnë, shoqëruar me shembuj konkretë, ekzistencën e kulturave parahistorike në territoret shqiptare;
- përshkruajnë qytetërimin ilir, shtrirjen, mënyrat e jetesës, organizimin shtetëror e kulturor ilir;
- shpjegojnë veçoritë kryesore të fiseve ilire dhe format e organizimit shtetëror në territoret ilire;
- përshkruajnë kontributin e dinastive kryesore ilire.

Niveli bazë

- përcaktojnë ekzistencën e kulturave parahistorike në territoret shqiptare;
- përcaktojnë qytetërimin ilir, shtrirjen, mënyrat e jetesës, organizimin shtetëror e kulturor ilir;
- përcaktojnë veçoritë kryesore të fiseve ilire dhe format e organizimit shtetëror në territoret ilire;
- dallojnë kontributin e dinastive kryesore ilire.

LINJA 7: Territoret arbërore në mesjetë (shek. VI - XIV)**Standardi i të nxënit**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për territoret arbërore në mesjetë, vazhdimësinë ilire-arbërore-shqiptare, karakteristikat kryesore të principatave arbërore gjatë shek. XII- XIV (Principata e Arbrit, Balshajt, Topiajt, principatat e Shqipërisë së Poshtme); ndryshimet kryesore që solli zhvillimi i marrëdhënieve feudale në territoret arbërore

Përshkrimi sipas niveleve*Niveli i lartë*

- analizojnë karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare në territoret arbërore me kulturën, artin dhe shoqërinë;
- vlerësojnë rolin e principatave arbërore gjatë shek. XII-XIV;
- analizojnë të dhënat historike e arkeologjike në lidhje me vazhdimësinë ilire arbërore shqiptare;
- analizojnë ndërtimin shoqëror, ekonomik dhe shtetëror të Principatës së Arbrit dhe të Despotatit të Artës në shek. XII-XIV, duke evidentuar karakteristikat e tyre;
- analizojnë tiparet kryesore të administrimit të Perandorisë Bizantine në territoret arbërore.

Niveli mesatar

- përshkruajnë karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare në territoret arbërore me kulturën, artin dhe shoqërinë;
- përshkruajnë karakteristikat kryesore të principatave arbërore gjatë shek. XII-XIV;
- përshkruajnë të dhënat historike e arkeologjike në lidhje me vazhdimësinë ilire-arbërore-shqiptare;
- tregojnë ndërtimin shoqëror, ekonomik dhe shtetëror të Principatës së Arbrit dhe të Despotatit të Artës në shek. XII-XIV, duke evidentuar karakteristikat e tyre;
- përshkruajnë tiparet kryesore të administrimit të Perandorisë Bizantine në territoret arbërore.

Niveli bazë

- përcaktojnë karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare në territoret arbërore me kulturën, artin dhe shoqërinë;

- tregojnë karakteristikat kryesore të principatave arbërore gjatë shek. XII-XIV;
- përcaktojnë të dhënat historike e arkeologjike në lidhje me vazhdimësinë ilire-arbërore-shqiptare;
- dallojnë ndërtimin shoqëror, ekonomik dhe shtetëror të Principatës së Arbrit dhe të Despotatit të Artës në shek. XII-XIV, duke evidentuar karakteristikat e tyre;
- përcaktojnë tiparet kryesore të administrimit të Perandorisë Bizantin në territoret arbërore.

LINJA 8: Qytetërimet në fillimet e historisë moderne (1450-1650)

Standardi i të nxënit

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për ndryshimet në qytetërimet botërore në fillimet e historisë moderne, si shkak i lindjes së humanizmit dhe Rilindjes, ndikimin e saj në art, kulturë, shkencë e në shoqëri, zbulimeve gjeografike dhe pasojave të këtyre zbulimeve, ndryshimeve fetare në Europë, ndikimi i qytetërimit osman në Europë, si dhe shoqëria, kultura, arti, shkenca dhe arsimi në vitet 1450-1650.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- argumentojnë vlerat e humanizmin, duke evidentuar Italinë si qendrën e Rilindjes Europiane;
- gjykojnë mbi vlerat historike të periudhës së Rilindjes, duke analizuar kontributin e tyre në shoqërinë europiane;
- vlerësojnë ndikimin e zbulimeve gjeografike në zhvillimin e njerëzimit;
- nxjerrin përfundime lidhur me lëvizjet e mëdha sociale, kulturore dhe fetare në Europën e shek. XVI;
- argumentojnë rrugët dhe pasojat e lulëzimit dhe të rënies së Perandorisë Osmane.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë vlerat e humanizmit duke evidentuar Italinë si qendrën e Rilindjes Europiane;

- evidentojnë vlerat historike të periudhës së Rilindjes dhe përshkruajnë kontributin e tyre në shoqërinë europiane;
- evidentojnë ndikimin e zbulimeve gjeografike në zhvillimin e njerëzimit;
- përshkruajnë lëvizjet e mëdha sociale, kulturore dhe fetare në Europën e shek. XVI;
- shpjegojnë rrugët dhe pasojat e lulëzimit dhe të rënies së Perandorisë Osmane.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përcaktojnë rrugët dhe pasojat e lulëzimit dhe të rënies së Perandorisë Osmane;
- listojnë vlerat historike të periudhës së Rilindjes, duke përcaktuar kontributin e tyre në shoqërinë europiane;
- dallojnë vlerat e zbulimeve gjeografike në zhvillimin e njerëzimit;
- përcaktojnë lëvizjet e mëdha sociale, kulturore dhe fetare në Europën e shek. XVI;
- përkufizojnë humanizmin, duke përcaktuar karakteristikat e kësaj lëvizjeje.

LINJA 9: Shqiptarët në periudhën moderne (shek. XV - XIX)

Standardi i të nxënit

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për momentet kryesore të ardhjes së osmanëve në territoret arbërore dhe qëndrimin e princërve arbërorë, veprimtarinë e Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe rëndësinë historike që pati periudha e Skënderbeut për popullin shqiptar, si dhe situatën e Shqipërisë pas vdekjes së Skënderbeut.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë momentet kryesore të ardhjes së osmanëve në territoret arbërore dhe qëndrimin e princërve arbërorë;
- vlerësojnë figurën e Skënderbeut dhe aftësitë e tij në organizimin e shtetit;
- vlerësojnë përpjekjet shtet formuese të shqiptarëve brenda Perandorisë Osmane;

- analizojnë tiparet ekonomike dhe shoqërore të shqiptarëve nën sundimin osman.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- evidentojnë momentet kryesore të ardhjes së osmanëve në territoret arbërore dhe qëndrimin e princërve arbërorë;
- evidentojnë figurën e Skënderbeut dhe aftësitë e tij në organizimin e shtetit;
- shpjegojnë përpjekjet shtet formuese të shqiptarëve brenda Perandorisë Osmane;
- përshkruajnë tiparet ekonomike dhe shoqërore të shqiptarëve nën sundimin osman.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përcaktojnë momentet kryesore të ardhjes së osmanëve në territoret arbërore dhe qëndrimin e princërve arbërorë;
- portretizojnë figurën e Skënderbeut dhe aftësitë e tij në organizimin e shtetit;
- dallojnë përpjekjet shtet formuese të shqiptarëve brenda Perandorisë Osmane;
- përcaktojnë tiparet ekonomike dhe shoqërore të shqiptarëve nën sundimin osman.

LINJA 10: Koha e ndryshimeve thelbësore (1650-1914)

Standardi i të nxënit

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime mbi sistemin monarkik në Francë dhe në Angli, Revolucionin Anglez, Revolucionin Amerikan dhe Revolucionin Francez, Nacionalizmin në Europën e shekullit XIX, tkurrjen e Perandorisë Osmane, ndryshimin e jetës së njerëzve për shkak të revolucioneve industriale, fillesat e demokracisë liberale, si dhe sistemin kolonial në shekullin XIX.

Përshkrimi sipas niveleve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë rolin që patën revolucionet politike gjatë shek. XVII-XVIII në Angli, në Amerikë dhe në Francë;
- analizojnë ndryshimet e thella që pësoi shoqëria evropiane pas revolucioneve në Angli, në Francë dhe në Amerikë;
- vlerësojnë rrymat e mendimit në shek. XIX: iluminizmin, romantizmin e nacionalizmin dhe ndikimin e tyre në shoqëri;
- analizojnë ndryshimet që sollën në jetën ekonomike, sociale dhe politike Revolucion i Parë dhe i Dytë Industrial.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë rolin që patën revolucionet politike gjatë shek. XVII-XVIII në Angli, në Amerikë dhe në Francë;
- tregojnë ndryshimet e thella që pësoi shoqëria evropiane pas revolucioneve në Angli, në Francë dhe në Amerikë;
- tregojnë rrymat e mendimit në shek. XIX: iluminizmin, romantizmin dhe nacionalizmin dhe ndikimin e tyre në shoqëri;
- evidentojnë ndryshimet që sollën në jetën ekonomike, sociale dhe politike Revolucion i Parë dhe i Dytë Industrial.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përcaktojnë rolin që patën revolucionet politike gjatë shek. XVII-XVIII në Angli, në Amerikë dhe në Francë;
- përcaktojnë ndryshimet e thella që pësoi shoqëria evropiane pas revolucioneve në Angli, në Francë dhe në Amerikë;
- përkufizojnë rrymat e mendimit në shek. XIX: iluminizmin, romantizmin dhe nacionalizmin dhe dallojnë ndikimin e tyre në shoqëri;
- përcaktojnë ndryshimet që sollën në jetën ekonomike, sociale dhe politike Revolucion i Parë dhe i Dytë Industrial.

LINJA 11: Rilindja kombëtare shqiptare**Standardi i të nxënit**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për lëvizjen kombëtare shqiptare, rëndësinë e Lidhjen Shqiptare të Prizrenit; emancipimin kulturor dhe arsimor të shqiptarëve, kongreset kulturore-arsimore, kryengritjet e viteve 1911-1912, Luftën e Parë Ballkanike dhe shpalljen e Pavarësisë.

Përshkrimi sipas niveleve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare përballë ndryshimeve të reja politike në Perandorinë Osmane;
- analizojnë tiparet dalluese të Rilindjes Kombëtare;
- argumentojnë emancipimin politik, kulturor dhe arsimor të shqiptarëve, duke nxjerrë në pah rëndësinë e shpalljes së Pavarësisë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë lëvizjen kombëtare shqiptare dhe ndryshimet e reja politike në Perandorinë Osmane;
- evidentojnë tiparet dalluese të Rilindjes Kombëtare;
- shpjegojnë emancipimin politik, kulturor dhe arsimor të shqiptarëve, duke nxjerrë në pah rëndësinë e shpalljes së Pavarësisë;

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe ndryshimet e reja politike në Perandorinë Osmane;
- përcaktojnë tiparet dalluese të Rilindjes Kombëtare;
- përcaktojnë rëndësinë e shpalljes së Pavarësisë për popullin shqiptar.

LINJA 12: Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)**Standardi i të nxënit**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për shkaqet, pretekstin e luftës, përfundimin dhe pasojat e luftërave botërore.

Përshkrimi sipas niveleve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- analizojnë shkaqet e fillimit të dy luftërave botërore dhe nxjerrin përfundime për pasojat që patën ato për njerëzimin;
- analizojnë sistemet kryesore politike midis dy luftërave botërore në Europë;
- analizojnë treguesit e krizës ekonomike botërore në vitet 1929-1933, si dhe shpjegojnë rrugët që shfrytëzuan shtetet për të dalë nga kjo krizë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- evidentojnë shkaqet e fillimit të dy luftërave botërore dhe përcaktojnë pasojat që ato patën për njerëzimin;
- përshkruajnë sistemet kryesore politike midis dy luftërave botërore në Europë;
- evidentojnë treguesit e krizës ekonomike botërore në vitet 1929-1933 dhe tregojnë rrugët që shfrytëzuan shtetet për të dalë nga kjo krizë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- listojnë shkaqet e fillimit të dy luftërave botërore dhe dallojnë pasojat që patën ato për njerëzimin;
- përkufizojnë sistemet kryesore politike midis dy luftërave botërore në Europë;
- përcaktojnë treguesit e krizës ekonomike botërore në vitet 1929-1933 dhe identifikojnë rrugët që shfrytëzuan shtetet për të dalë nga kjo krizë.

LINJA 13: Shteti shqiptar gjatë shekullit XX**Standardi i të nxënës**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime mbi përpjekjet për krijimin e shtetit kombëtar, Shqipërinë në Luftën e Parë Botërore, zhvillimet politike të shtetit shqiptar 1920-1924, Kongresin e Lushnjës, ndryshimet në jetën shoqërore dhe ekonomike në shtetin shqiptar 1920-1924, organizimin

politik të shtetit shqiptar nën drejtimin e Ahmet Zogut dhe periudhën e Luftës së Dytë Botërore.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë sfidat e shtetit të pavarur shqiptar dhe ndryshimet në jetën shoqërore dhe ekonomike në shtetin shqiptar 1920-1924;
- analizojnë përpjekjet e shtetit shqiptar për ruajtjen e tërësisë tokësore dhe domosdoshmërisë së thirrjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës;
- analizojnë vendimet e Kongresit të Lushnjës;
- analizojnë tiparet kryesore të organizimit politik të shtetit shqiptar nën drejtimin e Ahmet Zogut nga republika në monarki;
- vlerësojnë qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë sfidat e shtetit të pavarur shqiptar dhe ndryshimet në jetën shoqërore dhe ekonomike në shtetin shqiptar 1920-1924;
- përshkruajnë përpjekjet e shtetit shqiptar për ruajtjen e tërësisë tokësore dhe domosdoshmërisë së thirrjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës;
- përshkruajnë vendimet e Kongresit të Lushnjës;
- përshkruajnë tiparet kryesore të organizimit politik të shtetit shqiptar nën drejtimin e Ahmet Zogut nga republika në monarki;
- përshkruajnë qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përcaktojnë sfidat e shtetit të pavarur shqiptar dhe ndryshimet në jetën shoqërore dhe ekonomike në shtetin shqiptar 1920-1924;
- përcaktojnë përpjekjet e shtetit shqiptar për ruajtjen e tërësisë tokësore dhe domosdoshmërisë së thirrjes së Kongresit kombëtar të Lushnjës;
- përcaktojnë vendimet e Kongresit të Lushnjës;

- përcaktojnë tiparet kryesore të organizimit politik të shtetit shqiptar nën drejtimin e Ahmet Zogut nga republika në monarki;
- përcaktojnë qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

LINJA 14: Qytetërimet bashkëkohore (1945-Sot)

Standardi i të nxënit

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime mbi rimëkëmbjen e ekonomisë europiane pas Luftës së Dytë Botërore, Luftën e Ftohtë dhe veçoritë e organizimit të bllokut perëndimor dhe atij komunist, ndikimin e Revolucionin të Tretë Industrial në zhvillimet ekonomike e shoqërore botërore; shoqërinë, artin, kulturën dhe arsimin në Europën e viteve 1945-1990, shndërrimet në Bashkimin Sovjetik, shembjen e Murit të Berlinit dhe revolucionet demokratike në shtetet e Europës Qendrore dhe Lindore dhe hapat e mëtejshëm drejt integritetit europian, si dhe prirjet e qytetërimeve sot.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë arsyet e dypolarizimit të botës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore dhe pasojat e saj në zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore;
- vlerësojnë krijimin e organizatave botërore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në drejtimin politik, ekonomik e social, si: OKB, UNRRA, Plani Marshall;
- krahasojnë tiparet kryesore të organizimit ekonomik të shteteve perëndimore me ato lindore;
- analizojnë arsyet dhe rrugët drejt integritetit të shteteve të bllokut perëndimor, si dhe zgjerimin e procesit të integriteteve euroatlantike në shtetet ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore;
- vlerësojnë ndryshimet që solli në jetën ekonomike dhe shoqërore Revolucionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
- argumentojnë se shoqëritë janë të ndryshme dhe me kalimin e kohës janë ndryshuar dhe kanë evoluar;
- argumentojnë se si shkenca, teknologjia dhe aktiviteti ekonomik janë zhvilluar, ndryshuar dhe evoluar dhe kanë prekur shoqërinë në kohëra;

- shpjegojnë se si institucionet politike janë zhvilluar dhe ndryshuar në kohë;
- ndërtojnë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike;
- analizojnë ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike, brenda dhe përtej periudhave historike;
- analizojnë ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë;
- kërkojnë duke vlerësuar burimet alternative për ndërtimin e ngjarjes historike;
- argumentojnë se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë arsyet e dy polarizimit të botës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore dhe pasojat e saj në zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore;
- evidentojnë krijimin e organizatave botërore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në drejtimin politik, ekonomik e social, si: OKB, UNRRA, Plani Marshall;
- përshkruajnë tiparet kryesore të organizimit ekonomik të shteteve perëndimore dhe lindore;
- përshkruajnë arsyet dhe rrugët drejt integritetit të shteteve të bllokut perëndimor, si dhe zgjerimin e procesit të integriteteve euroatlantike në shtetet ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore;
- përshkruajnë ndryshimet që solli në jetën ekonomike dhe shoqërore Revolucioni i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
- përshkruajnë se shoqëritë janë të ndryshme dhe me kalimin e kohës janë ndryshuar dhe kanë evoluar;
- përshkruajnë se si shkenca, teknologjia dhe aktiviteti ekonomik janë zhvilluar, ndryshuar dhe evoluar dhe kanë prekur shoqërinë në kohëra;
- përshkruajnë se si institucionet politike janë zhvilluar dhe ndryshuar në kohë;
- vendosin në linjën e kohës periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike;
- përshkruajnë ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike, brenda dhe përtej periudhave historike;

- përshkruajnë ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë;
- kërkojnë burime alternative për ndërtimin e ngjarjes historike;
- përshkruajnë se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përcaktojnë arsyet e dy polarizimit të botës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore dhe pasojat e saj në zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore;
- përcaktojnë krijimin e organizatave botërore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në drejtimin politik, ekonomik e social, si: OKB, UNRRA, Plani Marshall;
- dallojnë tiparet kryesore të organizimit ekonomik të shteteve perëndimore dhe lindore;
- përcaktojnë arsyet dhe rrugët drejt integritit të shteteve të bllokut perëndimor, si dhe zgjerimin e procesit të integritimeve euroatlantike në shtetet ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore;
- përcaktojnë ndryshimet që solli në jetën ekonomike dhe shoqërore Revolucioni i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
- dallojnë se shoqëritë janë të ndryshme dhe me kalimin e kohës janë ndryshuar dhe kanë evoluar;
- identifikojnë se si shkenca, teknologjia dhe aktiviteti ekonomik janë zhvilluar, ndryshuar dhe evoluar dhe kanë prekur shoqërinë në kohëra;
- evidentojnë se si institucionet politike janë zhvilluar dhe ndryshuar në kohë;
- përcaktojnë në linjën e kohës periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike;
- dallojnë ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike, brenda dhe përtej periudhave historike;
- përcaktojnë ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë;
- identifikojnë burime alternative për ndërtimin e ngjarjes historike;
- evidentojnë se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme.

LINJA 15: Shqipëria gjatë periudhës bashkëkohore (1945-Sot)**Standardi i të nxënit**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime mbi masat politike dhe ekonomike që shoqëruan vendosjen e regjimit antidemokratik dhe atij komunist në Shqipëri, tiparet e jetës politike dhe ekonomike gjatë regjimit komunist, kolektivizimin dhe industrializimin e vendit, luftën e klasave dhe shkeljen e të drejtave të njeriut, si tipar i vazhdueshëm i regjimit komunist, qëndresën e forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj regjimit, marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë gjatë regjimit komunist, rënien e regjimit komunist në Shqipëri dhe fitoren e demokracisë, integrimin në strukturat euroatlantike dhe sfidat e shoqërisë shqiptare sot.

Përshkrimi sipas niveleve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- analizojnë masat politike, ekonomike e shoqërore në vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri;
- analizojnë dukuritë më tipike të politizimit dhe të idealizimit të skajshëm të jetës së vendit gjatë regjimit komunist;
- analizojnë pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut si tipar i regjimit komunist;
- analizojnë disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste;
- vlerësojnë lëvizjen demokratike në të gjithë vendin dhe ndryshimet politike, ekonomike dhe shoqërore që ato patën për Shqipërinë;
- vlerësojnë përpjekjet e shtetit shqiptar për integrimin në strukturat euroatlantike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- listojnë masat politike, ekonomike e shoqërore në vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri;
- përshkruajnë dukuritë më tipike të politizimit dhe të idealizimit të skajshëm të jetës së vendit gjatë regjimit komunist;
- përshkruajnë pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut si tipar i regjimit komunist;
- përshkruajnë disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste;

- përshkruajnë rolin e lëvizjeve demokratike në të gjithë vendin dhe ndryshimet politike, ekonomike dhe shoqërore që ato patën për Shqipërinë;
- përshkruan përpjekjet e shtetit shqiptar për integrimin në strukturat euroatlantike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përcaktojnë masat politike, ekonomike e shoqërore në vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri;
- përcaktojnë dukuritë më tipike të politizimit dhe të idealizimit të skajshëm të jetës së vendit gjatë regjimit komunist;
- përcaktojnë pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut si tipar i regjimit komunist;
- përcaktojnë disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste;
- dallojnë rolin e lëvizjeve demokratike në të gjithë vendin dhe ndryshimet politike, ekonomike dhe shoqërore që ato patën për Shqipërinë;
- përcaktojnë përpjekjet e shtetit shqiptar për integrimin në strukturat euroatlantike.

LINJA 16: Shqiptarët jashtë kufijve politikë (1912 - Sot)

Standardi i të nxënit

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për shqiptarët jashtë kufijve politikë të Shqipërisë: 1912 deri në ditët e sotme, gjendjen ekonomike dhe politike të shqiptarëve në Serbi e në Jugosllavi nga liberalizimi në mohimin e të drejtave nga shpërbërja e Jugosllavisë në Pavarësinë e Kosovës, gjendjen ekonomike dhe politike të shqiptarëve në Greqi, si dhe kontributin e shoqërisë shqiptare sot, për ndërkombëtarizim.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë format e dhunës të territorit serb-malazez e grek që shkaktuan rezistencën shqiptare;

- analizojnë luftën antifashiste në Çamëri dhe gjendjen ekonomike, politike dhe qëndresën e shqiptarëve në Jugosllavi;
- analizojnë faktorët që çuan në Pavarësinë e Kosovës;
- analizojnë procesin e luftës në Kosovë për pavarësinë dhe rolin ndërkombëtar në këtë proces;
- vlerësojnë rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën;
- vlerësojnë kontributin e shoqërisë shqiptare sot për ndërkombëtarizimin e problemit çam dhe zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Kosovës sot.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë format e dhunës të territorit serb-malazez e grek, që shkaktuan rezistencën shqiptare;
- përshkruajnë luftën antifashiste në Çamëri dhe gjendjen ekonomike, politike dhe qëndresën e shqiptarëve në Jugosllavi;
- përshkruajnë faktorët që çuan në Pavarësinë e Kosovës;
- përshkruajnë procesin e luftës në Kosovë për pavarësinë dhe rolin ndërkombëtar në këtë proces;
- shpjegojnë rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën;
- shpjegojnë kontributin e shoqërisë shqiptare sot për ndërkombëtarizimin e problemit çam dhe zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Kosovës sot.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përcaktojnë format e dhunës të territorit serb-malazez e grek që shkaktuan rezistencën shqiptare;
- përcaktojnë luftën antifashiste në Çamëri dhe gjendjen ekonomike, politike dhe qëndresën e shqiptarëve në Jugosllavi;
- përcaktojnë faktorët që çuan në Pavarësinë e Kosovës;
- përcaktojnë procesin e luftës në Kosovë për pavarësinë dhe rolin ndërkombëtar në këtë proces;
- përcaktojnë rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën;
- përcaktojnë kontributin e shoqërisë shqiptare sot për ndërkombëtarizimin e problemit çam dhe zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Kosovës sot.

SHEMBUJ TË STANDARDEVE TË ARRITJES NË LËNDËN "GJEOGRAFI" SIPAS LINJAVE TË STANDARDEVE TË TË NXËNIT

GJEOGRAFI

Në përfundim të klasës së 9-të:

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për veçoritë e përbërësve të gjeosistemit, lidhjen dhe bashkëveprimin ndërmjet tyre, pasojat e këtij bashkëveprimi, për tiparet fizike dhe humane të rajoneve dhe të nënrajoneve të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, rajoneve dhe vendeve të ndryshme në botë, ndërvarësinë ndërmjet tyre, për ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjellat, në nivel vendor, kombëtar, rajonal e global. Nxënësit përdorin mjetet gjeografike dhe teknologjinë për lokalizimin e tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane, si dhe për grumbullimin, përpunimin dhe komunikimin e informacionit.

LINJA 1: Sistemet fizike

Standardi i të nxënit

- Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për veçoritë e përbërësve të gjeosistemit, lidhjen dhe bashkëveprimin ndërmjet tyre, pasojat e këtij bashkëveprimi, si dhe ndikimin e tij në tiparet fizike të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, të rajoneve dhe vendeve të ndryshme të botës.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë veçoritë e përbërësve të gjeosistemit (atmosferës, hidrosferës, litosferës, biosferës), lidhjen dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre;
- analizojnë, shoqëruar me shembuj konkretë, pasojat e proceseve fizike në modelet dhe sistemet e Tokës, si dhe në mjedisin human;
- analizojnë dhe vlerësojnë karakteristikat e përgjithshme fiziko-gjeografike të vendlindjes, rajoneve të Shqipërisë dhe të trevave të tjera shqiptare, si dhe rajoneve të ndryshme të botës.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë veçoritë e përbërësve të gjeosistemit (atmosferës, hidrosferës, litosferës, biosferës), lidhjen dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre;
- shpjegojnë, përmes shembujve të dhënë, pasojat e proceseve fizike në modelet dhe sistemet e Tokës, si dhe në mjedisin human;
- shpjegojnë karakteristikat e përgjithshme fiziko-gjeografike të vendlindjes, rajoneve të Shqipërisë dhe të trevave të tjera shqiptare, si dhe rajoneve të ndryshme të botës.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë veçoritë e përbërësve të gjeosistemit (atmosferës, hidrosferës, litosferës, biosferës), lidhjen dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre;
- identifikojnë pasojat e proceseve fizike në modelet dhe sistemet e Tokës, si dhe në mjedisin human;
- dallojnë karakteristikat e përgjithshme fiziko-gjeografike të vendlindjes, rajoneve të Shqipërisë dhe të trevave të tjera shqiptare, si dhe rajoneve të ndryshme të botës.

LINJA 2: Sistemet humane**Standardi i të nxënit**

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për karakteristikat demografike, ekonomike, sociale, kulturore e politike të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, të rajoneve e vendeve të ndryshme të botës, si dhe për kompleksitetin e tyre.

Përshkrimi sipas niveleve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- analizojnë karakteristikat demografike dhe modelet e shpërndarjes së popullsisë, si dhe shkaqet e kësaj shpërndarjeje;
- analizojnë, përmes shembujve konkretë, vendndodhjen dhe karakteristikat gjeografike të vendbanimeve urbane dhe rurale dhe mënyrën si kanë ndryshuar në kohë;

- analizojnë, në këndvështrimin gjeografik, veçoritë e zhvillimit ekonomik, politik e kulturor të rajoneve e vendeve të ndryshme të botës.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shpjegojnë modelet e shpërndarjes së popullsisë, të lidhura ngushtë me shkaqet e kësaj shpërndarjeje;
- përshkruajnë, përmes shembujve të dhënë, vendndodhjen dhe karakteristikat gjeografike të vendbanimeve urbane dhe rurale dhe mënyrën si kanë ndryshuar në kohë;
- përshkruajnë veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik, politik e kulturor të rajoneve e vendeve të ndryshme të botës.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë modelet e shpërndarjes së popullsisë dhe shkaqet e kësaj shpërndarjeje;
- identifikojnë vendndodhjen dhe karakteristikat gjeografike të vendbanimeve urbane dhe rurale dhe mënyrën si kanë ndryshuar në kohë;
- evidentojnë, në këndvështrimin gjeografik, veçoritë e zhvillimit ekonomik, politik e kulturor të rajoneve e vendeve të ndryshme të botës.

LINJA 3: Vendet dhe rajonet

Standardi i të nxënit

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për tiparet fizike dhe humane të rajoneve dhe nënrajoneve të botës, të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, ndërvarësinë ndërmjet tyre, ndikimin e këtyre tipareve në fizionominë e rajoneve dhe nënrajoneve.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë përmes shembujve, duke evidentuar shkaqet, ngjashmëritë dhe ndryshimet midis karakteristikave fizike dhe humane të

rajoneve të ndryshme të Shqipërisë dhe trevave shqiptare, rajoneve dhe vendeve të tjera të botës,

- vlerësojnë kompleksitetin dhe ndërvarësinë midis rajoneve dhe vendeve të ndryshme.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë përmes shembujve, ngjashmëritë dhe ndryshimet midis karakteristikave fizike dhe humane të rajoneve të ndryshme të Shqipërisë dhe trevave shqiptare, rajoneve dhe vendeve të tjera të botës;
- përshkruajnë kompleksitetin dhe ndërvarësinë midis rajoneve dhe vendeve të ndryshme.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë disa nga ngjashmëritë dhe ndryshimet midis karakteristikave fizike dhe humane të rajoneve të ndryshme të Shqipërisë dhe trevave shqiptare, rajoneve dhe vendeve të tjera të botës;
- evidentojnë kompleksitetin dhe ndërvarësinë midis rajoneve dhe vendeve të ndryshme.

LINJA 4: Ndërveprimi njeri/mjedis

Standardi i të nxënit

Nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime për ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjellas në nivel vendor, kombëtar, rajonal e global.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- argumentojnë, përmes shembujve konkretë, ndërveprimin e veprimtarisë njerëzore me mjedisin natyror, duke evidentuar lidhjet shkak-pasojë të këtij ndërveprimi;
- vlerësojnë rëndësinë e burimeve natyrore dhe rolin e njeriut në mirëpërdorimin e tyre;

- propozojnë dhe argumentojnë zgjidhje të mundshme situatash të ndryshme mjedisore në Shqipëri, rajon e më gjerë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë ndërveprimin e veprimtarisë njerëzore me mjedisin natyror, duke evidentuar lidhjet shkak-pasojë të këtij ndërveprimi;
- përshkruajnë rëndësinë e burimeve natyrore dhe rolin e njeriut në mirëpërdorimin e tyre;
- diskutojnë mbi zgjidhje të mundshme të situatave të ndryshme mjedisore në Shqipëri, rajon e më gjerë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë ndërveprimin e veprimtarisë njerëzore me mjedisin natyror, duke evidentuar lidhjet shkak-pasojë të këtij ndërveprimi;
- dallojnë rëndësinë e burimeve natyrore dhe rolin e njeriut në mirëpërdorimin e tyre;
- listojnë zgjidhje të mundshme të situatave të ndryshme mjedisore në Shqipëri, rajon e më gjerë.

LINJA 5: Mjetet gjeografike dhe vendndodhja

Standardi i të nxënit

Nxënësit përdorin mjetet gjeografike (harta, glob, fotografi etj.) dhe teknologjinë në lokalizimin e tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane, për grumbullimin, përpunimin dhe komunikimin e informacionit.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përdorin, në mënyrë të pavarur, mjetet gjeografike (harta, globin, fotografite ajrore, imazhet satelitore etj.), për lokalizimin e vendndodhjes së tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane të Shqipërisë e trevave të tjera shqiptare, rajoneve e vendeve të ndryshme të botës;
- përdorin në mënyrë të pavarur, aftësitë gjeografike për të hulumtuar rreth shpërndarjes hapësinore të modeleve fizike e humane;

- sugjerojnë përfundime dhe prezantojnë gjetjet e tyre, duke përdorur me lehtësi fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin, me ndihmë, mjetet gjeografike (harta, globin, fotografitë ajrore, imazhet satelitore etj.) për lokalizimin e vendndodhjes së tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane të Shqipërisë e trevave të tjera shqiptare, rajoneve e vendeve të ndryshme të botës;
- përdorin me ndihmë, aftësitë gjeografike për të hulumtuar rreth shpërndarjes hapësinore të modeleve fizike e humane;
- shpjegojnë gjetjet e tyre, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë mjetet gjeografike (harta, globin, fotografitë ajrore, imazhet satelitore etj.) si mjete për lokalizimin e vendndodhjes së tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane të Shqipërisë e trevave të tjera shqiptare, rajoneve e vendeve të ndryshme të botës;
- demonstrojnë elemente të aftësive gjeografike, për të hulumtuar rreth shpërndarjes hapësinore të modeleve fizike e humane;
- prezantojnë gjetjet e tyre, duke përdorur fjalor të thjeshtë gjeografik.

STANDARDET E ARRITJEVE

Fusha:

EDUKIM PËR SIPËRMARRJEN

Lënda: Edukim për karrierën

Cikli: 9-Vjeçar

Koordinatorë:

Mirela ANDONI

Grupi i punës:

Merita SHUKA

Alqi MUSTAFAI

Luljeta MINAROLLI

1. HYRJE

Standardet e arritjes të fushës “Edukimi për sipërmarrjen” janë hartuar bazuar në standardet e të nxënit të fushës.

Standardet e arritjes së fushës “Edukimi për sipërmarrjen” përcaktojnë sa mirë nxënësit demonstrojnë përvetësimin e standardeve të të nxënit sipas cikleve të shkollimit dhe referuar tri niveleve të arritjes.

Standardet e arritjes janë hartuar për çdo cikël të arsimit bazë, që nënkuptojnë Arsimin Fillor klasat 1- 6 dhe Arsimin e Mesëm të Ulët, klasat 7- 9.

Standardet e arritjes referuar tri niveleve të arritjes janë hartuar bazuar në çdo standard të nxëni të fushës dhe të lëndës.

Nivelet e arritjeve janë hartuar në tri shkallë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë, që korrespondojnë përkatësisht me grup notat: 5- 6; 7- 8 dhe 9- 10.

2. KËRKESA PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE TË ARRITJES

Standardet e arritjes janë një dokument kurrikular që lehtëson vlerësimin e arritjeve të nxënësve, si dhe siguron cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies.

Standardet e arritjes shërbejnë si dokument orientues për të hartuar instrumente për vlerësimin e nxënësve në të dy ciklet e Arsimit Bazë. Ato ju drejtohen mësuesve, drejtuesve të shkollave, inspektorëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme të edukimit.

Instrumentet për vlerësimin e arritjeve të të nxënit duhet të përmbajnë të tri nivelet e kërkuara të arritjeve që janë parashikuar për çdo standard.

Niveli bazë i arritjes përshkruan kriteret që përcaktojnë një zotërim bazik të përmbajtjes së standardeve të të nxënit.

Niveli mesatar i arritjes përshkruan kriteret që përcaktojnë një zotërim mesatar të qëndrueshëm të përmbajtjes së standardeve të të nxënës.

Niveli i lartë i arritjes përshkruan kriteret që përcaktojnë një zotërim në nivel të lartë të përmbajtjes së standardeve të të nxënës.

3. PËRMBLEDHJE E STANDARDEVE TË ARRITJES PËR FUSHËN

Në përfundim të klasës së 6-të:

Nxënës të zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin për sipërmarrje në shtëpi dhe komunitet, zbulojnë aftësitë personale, dëshirat, nevojat, krijojnë premisa për të kthyer idetë në veprime konkrete, zhvillojnë mendimin krijues, marrin përsipër rreziqe gjatë nismave të ndryshme të realizuara në mënyrë të mbikëqyrur apo të pavarur. Ata zbulojnë natyrën dhe llojet e punëve, të sipërmarrjeve dhe sipërmarrësve, mënyrën e fitimit, kursimit dhe përdorimit të parasë. Gjatë punëve konkrete praktike në shkollë, shtëpi dhe komunitet, nxënës të demonstrojnë aftësi për të komunikuar, prezantuar, planifikuar, drejtuar, analizuar, buxhetuar, për të punuar individualisht dhe në grup si aftësi bazë për një sipërmarrje.

Në përfundim të klasës së 9-të:

Nxënës të dallojnë aftësitë, prirjet, dëshirat personale dhe planifikojnë ide konkrete për karrierën personale, duke marrë parasysh kushtet financiare, rreziqet e mundshme, si dhe zhvillimet e tregut të punës. Ata evidentojnë veçoritë e punëve dhe profesioneve, organizimin e biznesit, zhvillimet e tregut rajonal dhe analizojnë rrugët e sipërmarrësve apo sipërmarrjeve të suksesshme në rajon. Gjatë këtyre viteve nxënës të mësojnë të planifikojnë karrierën personale duke respektuar hapat, duke përfshirë hartimin dhe zbatimin e një plani të thjeshtë biznesi për sipërmarrjet personale. Kjo i ndihmon ata të marrin vendime për karrierën personale (shkollimin/trajnimin) përmes demonstrimit të shembujve konkretë të përdorimit të financave personale, bursave apo burimeve të tjera në dispozicion.

4. STANDARDET E ARRITJES SIPAS LINJAVE TË FUSHËS

KLASA 6

LINJA 1: Zhvillimi personal

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin si bazë për të kryer sipërmarrje.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë cilësitë, dëshirat dhe nevojat personale, duke i krahasuar ato me modele nga jeta reale, me synim nxitjen e ideve sipërmarrëse.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë cilësitë, dëshirat dhe nevojat personale, me synim nxitjen e ideve sipërmarrëse.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë cilësitë, dëshirat, nevojat personale, me qëllim nxitjen e ideve sipërmarrëse për vete, komunitetin dhe shtëpinë.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit zbulojnë aftësitë personale, dëshirat, nevojat dhe krijojnë premisa për të kthyer idetë në veprime konkrete.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë idetë për sipërmarrje për vete, komunitetin dhe ekonominë shtëpiake bazuar në aftësitë personale, dëshirat, nevojat dhe mundësitë, si dhe renditin hapat për t'i kthyer idetë në veprime konkrete.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë ide për sipërmarrje për vete, komunitetin dhe ekonominë shtëpiake bazuar në aftësitë personale, dëshirat, nevojat dhe mundësitë, si dhe renditin hapat për t'i kthyer idetë në veprime konkrete.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë ide për sipërmarrje për vete, komunitetin dhe ekonominë shtëpiake bazuar në aftësitë personale, dëshirat, nevojat dhe mundësitë, si dhe përshkruajnë hapat për t'i kthyer idetë në veprime konkrete.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit zhvillojnë mendimin krijues, marrin përsipër rreziqe gjatë nismave të ndryshme të realizuara në mënyrë të mbikëqyrur apo të pavarur.

Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- vlerësojnë rreziqet e mundshme gjatë nismave të ndryshme në sipërmarrje për vete, komunitetin, ekonominë shtëpiake, të realizuara në mënyrë të mbikëqyrur apo të pavarur.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë rreziqet e mundshme gjatë nismave të ndryshme në sipërmarrje për vete, komunitetin, ekonominë shtëpiake, të realizuara në mënyrë të mbikëqyrur apo të pavarur.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë rreziqet e mundshme gjatë nismave të ndryshme në sipërmarrje për vete, komunitetin, ekonominë shtëpiake, të realizuara në mënyrë të mbikëqyrur apo të pavarur.

LINJA 2: Bota e punës dhe e biznesit**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit zbulojnë natyrën dhe llojet e punëve të sipërmarrjeve dhe sipërmarrësit, mundësitë për karrierë dhe mundësitë për të kryer sipërmarrje.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë ide për mundësitë për sipërmarrje personale në komunitet dhe ekonominë shtëpiake, referuar natyrës, llojeve të punëve, të bizneseve dhe veçoritë e sipërmarrësit të analizuara nga shembuj konkretë në familje, komunitet dhe rajonin ku jetojnë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë natyrën, llojet e punëve, të bizneseve dhe veçoritë e sipërmarrësit, duke iu referuar shembujve në familje dhe modeleve në rajonin ku jetojnë, si dhe paraqesin ide për mundësitë për sipërmarrje personale, në komunitet dhe ekonominë shtëpiake.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë natyrën, llojet e punëve, të bizneseve dhe veçoritë e sipërmarrësit, duke iu referuar shembujve në familje dhe modeleve në rajonin ku jetojnë.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit zbulojnë mënyrën e fitimit, kursimit dhe përdorimit të parasë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë ide në lidhje me përdorimin e parave për çështje konkrete në familje, klasë dhe komunitet.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë mënyrën e fitimit, kursimit dhe përdorimit të parasë, referuar shembujve në familje dhe komunitet, si dhe zhvillojnë ide në lidhje me përdorimin e parave për çështje konkrete në familje, klasë dhe komunitet.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë mënyrën e fitimit, kursimit dhe përdorimit të parasë, referuar shembujve në familje dhe komunitet.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit zbulojnë mënyrat e organizimit, funksionimit të biznesit dhe zhvillimet ekonomike të rajonit.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë rolin e bankave në zhvillimin ekonomik të rajonit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë mënyrën e funksionimit të biznesit dhe ndikimin që ka në zhvillimin ekonomik të rajonit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë mënyrat e organizimit të qarkut, të institucioneve kryesore, funksionimit të biznesit, si dhe zhvillimet ekonomike të rajonit.

LINJA 3: Aftësitë sipërmarrëse**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit, gjatë punëve konkrete praktike në shkollë, shtëpi dhe komunitet, demonstrojnë aftësi për të komunikuar, prezantuar, planifikuar, drejtuar, analizuar, buxhetuar, për të punuar individualisht dhe në grup, si aftësi bazë për një sipërmarrës.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë punët individuale dhe të grupit në sipërmarrje të thjeshta personale, në ekonominë familjare dhe në komunitet.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- drejtojnë dhe analizojnë punën për të hartuar planin dhe për të buxhetuar sipërmarrje të thjeshta në klasë, në ekonominë familjare dhe në komunitet.

Niveli bazë

Nxënësit:

- planifikojnë dhe prezantojnë punë konkrete individuale apo të grupit të realizuara në klasë, në ekonominë familjare dhe në komunitet.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit eksplorojnë mundësi për të ndërmarrë nisma që përfshijnë edhe ato për karrierën, duke respektuar hapat për hapjen e një biznesi, që gjithashtu përfshin hartimin dhe zbatimin e një plani të thjeshtë biznesi

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë dhe prezantojnë nisma për vete, ekonominë familjare dhe komunitetin, si dhe tregojnë hapat (planin) për t'i bërë realitet idetë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë cilësitë e sipërmarrësve dhe sipërmarrjeve të suksesshme sociale dhe ato të biznesit, si dhe rrugën që kanë ndjekur.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë sipërmarrës dhe sipërmarrje të suksesshme, duke marrë shembuj nga familja dhe komuniteti.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit demonstrojnë mënyra të ndryshme sesi të menaxhojnë paratë dhe financat personale në rastet e sipërmarrjeve në shkollë, shtëpi, komunitet dhe për karrierën.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- zbatojnë hapat për të marrë vendime në lidhje me menaxhimin e buxhetit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë mënyrën e shpenzimit të buxhetit në rastet e sipërmarrjeve në shkollë, shtëpi, komunitet.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë mënyrën e llogaritjes së kostonë në punë të thjeshta në ekonominë familjare dhe komunitet.

KLASA 9

STANDARDET E ARRITJES SIPAS LINJAVE TË FUSHËS

LINJA 1: Zhvillimi personal

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin si bazë për të kryer sipërmarrje.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë cilësitë, dëshirat, nevojat personale, mundësitë dhe rrisqet me qëllim vendimmarrjen për sipërmarrjet që lidhen me shkollimin dhe karrierën personale.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë cilësitë, dëshirat, nevojat personale, mundësitë dhe rrisqet, me qëllim vendimmarrjen për sipërmarrjet që lidhen me shkollimin dhe karrierën personale.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë cilësitë, dëshirat, nevojat personale, mundësitë dhe rrisqet, me qëllim vendimmarrjen për sipërmarrjet, që lidhen me shkollimin dhe karrierën personale.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit zbulojnë aftësitë personale, dëshirat, nevojat dhe krijojnë premisa për të kthyer idetë në veprime konkrete.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë ide për sipërmarrje për karrierën personale (shkollimin, trajnimin) bazuar në aftësitë personale, dëshirat, nevojat, mundësitë,

buxhetin, analizojnë rrisqet, si dhe planifikojnë hapat për të kthyer idetë në veprime konkrete.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë ide për sipërmarrje për karrierën personale (shkollimin, trajnimin) bazuar në aftësitë personale, dëshirat, nevojat, mundësitë, buxhetin, analizojnë rrisqet, si dhe planifikojnë hapat për të kthyer idetë në veprime konkrete.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë ide për sipërmarrje për karrierën personale (shkollimin, trajnimin) bazuar në aftësitë personale, dëshirat, nevojat, mundësitë, buxhetin, analizojnë rrisqet, si dhe planifikojnë hapat për të kthyer idetë në veprime konkrete.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit zhvillojnë mendimin krijues, marrin përsipër rreziqe gjatë nismave të ndryshme të realizuara në mënyrë të mbikëqyrur apo të pavarur.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë rreziqet e mundshme gjatë nismave të ndryshme, referuar planit për sipërmarrje konkrete për karrierën personale.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë rreziqet e mundshme në nismat e ndryshme, referuar planit për sipërmarrje konkrete për karrierën personale.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë rreziqet e mundshme në nismat e ndryshme, referuar planit për sipërmarrje konkrete për karrierën personale.

LINJA 2: Bota e punës dhe e biznesit**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit zbulojnë natyrën dhe llojet e punëve të sipërmarrjeve dhe sipërmarrësit, mundësitë për karrierë dhe mundësitë për të kryer sipërmarrje.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë të dhënat e marra nga analiza në lidhje punën, profesionet, bizneset dhe sipërmarrësit, si dhe paraqesin ide konkrete për mundësitë për sipërmarrje në lidhje me karrierën personale.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë të dhënat e marra nga këqyrja, intervistat dhe analiza për natyrën, llojet e punëve, profesioneve, bizneseve dhe veçoritë e sipërmarrësit, si dhe paraqesin ide konkrete për mundësitë për sipërmarrje në lidhje me karrierën personale.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë natyrën, llojet e punëve, profesioneve, të bizneseve dhe veçoritë e sipërmarrësit, duke iu referuar këqyrjes, intervistave dhe analizës së shembujve në familje dhe bizneseve në rajonin ku jetojnë.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit zbulojnë mënyrën e fitimit, kursimit dhe përdorimit të parasë.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë efektivitetin e investimit (buxhetit që do të përdoret), referuar planit për karrierën personale për shkollim/trajnim.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë mënyra të gjetjes së buxheteve, bursave për të realizuar planin për karrierën personale për shkollim/trajnim.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë mënyrën e përdorimit të buxhetit personal, mundësitë për bursa, referuar planit për karrierën personale për shkollim/trajnim.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit zbulojnë mënyrat e organizimit, funksionimit të biznesit dhe zhvillimet ekonomike të rajonit.

Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- vlerësojnë prirjet për punë, profesione dhe sipërmarrje, referuar analizës së zhvillimit ekonomik të rajonit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë punët, profesionet dhe mundësitë për punësim, referuar zhvillimeve ekonomike të rajonit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë punët dhe profesionet në biznese të ndryshme dhe prirjet e zhvillimit ekonomik të rajonit.

LINJA 3: Aftësitë sipërmarrëse**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit, gjatë punëve konkrete praktike në shkollë, shtëpi dhe komunitet, demonstrojnë aftësi për të komunikuar, prezantuar, planifikuar, drejtuar,

analizuar, buxhetuar, për të punuar individualisht dhe në grup, si aftësi bazë për një sipërmarrës.

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë sa real dhe i mundshëm është plani për karrierën personale, referuar të dhënave nga analiza e kryer.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- realizojnë intervista me profesione apo sipërmarrës dhe analizojnë planin dhe vendimmarrjet personale.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë mënyrat për kërkimin e punës, si dhe kërkesat për shkollim dhe punësim, duke marrë shembuj nga sipërmarrës në familje dhe komunitet.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit eksplorojnë mundësi për të ndërmarrë nisma që përfshijnë edhe ato për karrierën, duke respektuar hapat për hapjen e një biznesi, që gjithashtu përfshin hartimin dhe zbatimin e një plani të thjeshtë biznesi

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë dhe prezantojnë efektivitetin e planit personal të karrierës, duke u mbështetur në shembuj konkretë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë mundësitë, rrisqet për realizimin e planit për karrierën personale (shkollimin dhe punësimin), duke marrë shembuj nga sipërmarrës/sipërmarrje të suksesshme në familje dhe komunitet.

Niveli bazë

Nxënësit:

- hartojnë planin për shkollimin dhe punësimin.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit demonstrojnë mënyra të ndryshme sesi të menaxhojnë paratë dhe financat personale në rastet e sipërmarrjeve në shkollë, shtëpi, komunitet dhe për karrierën.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

- Nxënësit marrin vendim për buxhetin për karrierën.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë mundësitë për të gjetur dhe përdorur buxhetin për karrierën.

Niveli bazë

Nxënësit:

- hartojnë buxhetin e nevojshëm për karrierën (shkollimin/trajnimin).

LËNDA EDUKIMI PËR KARRIERËN**LINJA 1: Vetëvlerësimi****Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit gjykojnë dhe përgatitin informacionin për vetveten, duke marrë parasysh edhe ndikimet e mjedisit mbi ta.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë:*

Nxënësit:

- vlerësojnë CV-në dhe zhvillimin ekonomik të rajonit për vendimmarrjen për karrierën.

Niveli mesatar:

Nxënësit:

- analizojnë mundësitë për Karrierën (shkollim/ trajnim të mëtejshëm), referuar CV-së personale.

Niveli bazë:

Nxënësit:

- hartojnë CV-në personale sipas një modeli të dhënë.

Standardi i të nxënit 2*Nxënësit gjykojnë për aftësitë e nevojshme për t'u punësuar.***Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë aftësitë personale për karrierat e përzgjedhura.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë aftësitë personale me aftësitë e duhura për profesionet e pëlqyera.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë aftësitë e nevojshme për kryerjen e punëve të pëlqyera.

Standardi i të nxënit 3*Nxënësit krahasojnë dhe gjykojnë për aftësitë e transferueshme në profesione të ndryshme.***Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë*

Nxënësit:

- planifikojnë rrugën për zhvillimin e aftësive të transferueshme në profesione të ndryshme.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë përshtatjen e aftësive personale për profesione të ndryshme.

Niveli bazë:

Nxënësit:

- përshkruajnë aftësitë e transferueshme në profesione të ndryshme.

LINJA 2: Bota e punës dhe e biznesit**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit demonstrojnë aftësi për të hulumtuar në sistemin e arsimit, trajnimit, si dhe në botën e punës.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë shkollat e përzgjedhura referuar planit të karrierës.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë dhe listojnë shkollat e parapëlqyera për karrierën personale.

Niveli bazë

Nxënësit:

- hulumtojnë në sistemin e arsimit dhe trajnimit për planifikimin e karrierës.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit demonstrojnë aftësi për të dalluar mes punës, profesionit dhe karrierës.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë dhe listojnë 3 profesione më të pëlqyera.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë punët dhe profesionet e parapëlqyera për karrierën e personale.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë punë, profesione të parapëlqyera për karrierën personale.

Standardi i të nxënit 3*Nxënësit demonstrojnë aftësi për të kërkuar punë.***Përshkrimi i niveleve të arritjes***Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë kërkesat në shpalljen e vendeve të lira të punës.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin media të ndryshme për kërkimin e punës.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë mënyrat kryesore të kërkimit të punës.

LINJA 3: Planifikimi/Vendimmarrja për karrierën**Standardi i të nxënit 1***Nxënësit demonstrojnë aftësi të hartojnë dhe të përshtatin planin personal për shkollimin trajnimin e mëtejshëm.*

Përshkrimi i niveleve të arritjes

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë dhe përshtatin planin personal për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë mundësitë, duke përfshirë dhe ato financiare, si dhe rreziqet për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm.

Niveli bazë

Nxënësit:

- hartojnë planin personal për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit demonstrojnë aftësi për të reflektuar mundësitë ekonomike, bursat dhe financat personale në planin personal të zhvillimit të karrierës.

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë mundësitë financiare për realizimin e planit të karrierës.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë financat personale, mundësitë për bursë apo rrugë të tjera për realizimin e planit personal të zhvillimit të karrierës.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë koston e planit personal të zhvillimit të karrierës.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit demonstrojnë vendimmarrjen për shkollimin dhe trajnimin e mëtejshëm bazuar në planin e karrierës.

Përshkrimi i niveleve të arritjes*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- marrin vendim për shkollimin e mëtejshëm.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë shkollat, buxhetin, mundësitë e tjera për vendimmarrjen.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë shkollat e mundshme për realizimin e karrierës.

STANDARDET E ARRITJEVE

Fusha:

ARTE

Lënda: Art pamor, Muzikë, Kërcim dhe Teatër

Për klasat: 1-6 dhe 7-9

Koordinatorë:

Majlinda HALA

Grupi i punës:

Petrit MALAJ

Besnik BISHA

Julika SIMO

Majlinda HALA

Shpëtim KËRÇUKU

Joli ELENİ GJOVREKU

Aneta MALAJ

Mehmet XHELILI

Ani THEODHOSI

HYRJE

Fusha e arteve dhe përkatësisht lëndët: *Art pamor, Muzikë, Kërcim dhe Teatër*, është një fushë e rëndësishme e kurrikulës, e cila lidhet ngushtë me zhvillimin intelektual, social, kulturor dhe afektiv të nxënësve. Artet kanë qenë dhe janë pjesë e rëndësishme e përvojës njerëzore, që lejojnë të gjithë njerëzit të provojnë dhe shprehin ndjenjat dhe emocionet, duke i lidhur njohuritë e tyre me njohuritë e reja që marrin rreth kulturave të ndryshme edhe nëpërmjet edukimit. Ato ndihmojnë në krijimin e lidhjeve të individëve me përvoja të ndryshme artistike.

Standardet e arritjes në fushën e arteve sigurojnë mundësinë e zbatimit të niveleve të pritura ose të dallueshme të aftësive të nxënësve, në kuadrin e vlerësimit të një detyre të dhënë në bazë të standardeve të të nxënësve. Këto rezultate të arritjes përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet në përdorimin e njohurive mbi artet, të mjeteve, të teknikave, të materialeve dhe të një fjalori të thjeshtë artistik, për çdo disiplinë arti.

Zakonisht standardet e arritjes gjenden në tre nivele, pa llogaritur nivelin pakalues

1. Niveli i lartë
2. Niveli mesatar
3. Niveli bazë

1. KËRKESA PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE TË ARRITJES

Standardet e arritjes janë një dokument kurrikular në ndihmë dhe mbështetje të vlerësimit të arritjes në të nxënësve. Standardet e arritjes duhet të shërbejnë si dokument orientues në fushat kurrikulare për të hartuar instrumente adekuate të vlerësimit të arritjes të nxënësve në të dy ciklet e Arsimit Bazë. Ato ju drejtohen mësuesve, vlerësuesve, inspektorëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme të edukimit. Hartimi i instrumenteve të vlerësimit të arritjes në të nxënësve duhet kryer duke u mbështetur në nivelet e arritjes, që janë parashikuar për çdo standard arritjeje.

2. PËRMBLEDHJE E STANDARDEVE TË ARRITJES PËR FUSHËN E ARTEVE

Në fund të klasës së 9-të:

Nxënësit komunikojnë përmes katër lëndëve artistike që përbëjnë fushën e arteve: *artit pamor, muzikës, kërcimit dhe teatrit*, duke zhvilluar aftësitë dhe shprehitë e tyre për të krijuar punë artistike muzikore, skenike apo figurative. Ata, përmes përdorimit të elementeve dhe parimeve të arteve, përdorin mjete, teknika dhe materiale të përshtatshme për realizimin e punëve artistike individuale dhe me të tjerë, në art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër. Gjithashtu, ata analizojnë dhe vlerësojnë vepra të ndryshme arti, duke përfshirë veprat e artit shqiptar dhe botëror, si dhe përfaqësuesit e tyre, të krijuara në periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike, po kështu ata zhvillojnë vetëdijen kombëtare nëpërmjet trajtimit historik të vlerave artistike kombëtare. Nxënësit lidhin njohuritë artistike brenda disiplinave në fushën e arteve dhe me fusha të tjera të të nxënit.

3. STANDARDET E ARRITJES NË BAZË FUSHE: ARTET (ART PAMOR, MUZIKË, KËRCIM DHE TEATËR), PËR ARSIMIN FILLOR (KLASAT 1-6)

LINJA 1: Kuptimi dhe zbatimi i njohurive artistike

Standardi i të nxënit

Nxënësit përdorin duke ndërthurur konceptet e artit, për të zbatuar proceset artistike, krijuar punët e tyre artistike origjinale, duke u bazuar në ide, përvoja artistike, histori dhe opinione të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- zbatojnë përmes njohurive artistike punët e tyre artistike (origjinale) në mënyrë krijuese, në *art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër*, vetëm dhe me të tjerë;

- realizojnë përmes proceseve artistike punët e tyre artistike (origjinale) në mënyrë krijuese, në *art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër*, vetëm dhe me të tjerë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- zbatojnë përmes njohurive artistike punët e tyre artistike (origjinale) sipas modelit të ofruar në *art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër*, vetëm dhe me të tjerë;
- realizojnë përmes zbatimit të proceseve artistike në *art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër*, punët e tyre artistike (origjinale) në mënyrë të udhëhequr vetëm dhe me të tjerë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë përmes njohurive artistike punët e tyre artistike, sipas modeleve të ofruara në *art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër*;
- kryejnë udhëzimet e mësuesit gjatë procesit artistik në punët e tyre artistike *art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër*.

LINJA 2: Elemente dhe parime

Standardi i të nxënës

Nxënësit zbatojnë elementet dhe parimet e arteve, duke përdorur veçoritë e secilit prej tyre.

- Arti pamor-elementet janë: linja, forma, hapësira, vlera, cilësia, ngjyra, koha dhe lëvizja; parimet janë: theksi, balanca, proporcioni, modeli, përsëritja dhe variacioni, ritmi dhe uniteti.
- Muzika - elementet janë: gjatësia, lartësia, dinamika, timbri, harmonia, forma.
- Kërcimi - elementet janë: trupi, hapësira, koha, energjia dhe marrëdhënia.
- Teatri - elementet janë: besimi, koha dhe vendi, roli dhe karakteri, veprimi, marrëdhënia.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shpjegojnë qartë dhe në mënyrë të pavarur, përmes një vepre

artistike, elementet dhe parimet artistike, p.sh., lëvizjen e ritmit, të melodisë, raportin hije-dritë, ndryshimin e tonalitetit të zërit në një poezi, marrëdhënien e lëvizjes trupore me hapësirën etj.;

- zbatojnë në mënyrë korrekte *elementet dhe parimet* në një vepër apo punë arti, si: ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjetet, emocionin etj.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shpjegojnë përmes një vepre artistike, elementet dhe parimet artistike, p.sh., lëvizjen e ritmit, të melodisë, raportin hije-dritë, ndryshimin e tonalitetit të zërit në një poezi, marrëdhënien e lëvizjes trupore me hapësirën etj.;
- zbatojnë sipas modeleve të dhëna *elementet dhe parimet* në një vepër apo punë arti, si: ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjetet, emocionin etj.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë në një vepër artistike *elementet dhe parimet artistike*, p.sh., lëvizjen e ritmit, të melodisë, raportin hije-dritë, ndryshimin e tonalitetit të zërit në një poezi, marrëdhënien e lëvizjes trupore me hapësirën etj.;
- përdorin nën udhëheqjen e mësuesit *elementet dhe parimet* në një vepër apo punë arti, si: ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjetet, emocionin etj.

LINJA 3: Historia e artit

Standardi i të nxënit

Nxënësit vlerësojnë rolin e zhvillimit të historisë së arteve dhe të veprave artistike të krijuara në kontekste të ndryshme sociale, politike, fetare dhe kulturore, gjeografike nga artistë të ndryshëm.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë disa nga veprat e artit kombëtar dhe atij botëror, përmes njohurive që kanë për këto vepra, duke argumentuar dhe analizuar qartë një vepër artistike shqiptare apo të huaj (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër) me një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë disa nga veprat e artit kombëtar dhe atij botëror, përmes njohurive që kanë për këto vepra, duke përshkruar një vepër artistike shqiptare apo të huaj (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër) me një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë disa vepra të artit kombëtar dhe atij botëror, përmes njohurive që kanë për këto vepra, duke veçuar një vepër artistike shqiptare apo të huaj (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër) dhe duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

LINJA 4: Krijimi, analiza dhe vlerësimi**Standardi i të nxënit**

Nxënësit zbatojnë aftësitë krijuese për të realizuar një pjesë të thjeshtë artistike, analizojnë dhe vlerësojnë krijimet e tyre dhe të të tjerëve (në art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër), duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike dhe vlerësuar rolin e arteve në jetën e përditshme dhe në komunitet.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- performojnë në mënyrë korrekte vetëm dhe me të tjerë në (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër) këngë e melodi, ritmizojnë vargje, luajnë në instrument muzikor, vallëzojnë sipas muzikës së dëgjuar, realizojnë në mënyrë të kompletuar rolin e caktuar në lojën teatrale etj.;

- krahasojnë në mënyrë të pavarur dy vepra arti të të njëjtës disiplinë arti apo të arteve të tjera, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike;
- vlerësojnë në mënyrë kritike krijimet artistike individuale dhe të tjerëve (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër) sipas prirjeve dhe aftësisë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- krijojnë vetëm apo me të tjerë në (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër) këngë e melodi, ritmizojnë vargje, luajnë në instrument muzikor, vallëzojnë sipas muzikës së dëgjuar, realizojnë në mënyrë të saktë rolin e caktuar në lojën teatrale etj.;
- analizojnë dy vepra arti të të njëjtës disiplinë arti apo të arteve të tjera, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike;
- vlerësojnë krijimet artistike individuale dhe të të tjerëve (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër) sipas prirjeve dhe aftësisë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- krijojnë vetëm apo me të tjerë në (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër): këngë e melodi, mund të luajnë në instrument muzikor, vallëzojnë me vesh, realizojnë rolin e caktuar në lojën teatrale etj.;
- flasin mbi dy vepra arti të të njëjtës disiplinë arti apo të arteve të tjera, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike;
- vlerësojnë ndonjëherë ndonjë krijim artistik individual apo të të tjerëve (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër) sipas prirjeve dhe aftësisë.

LINJA 5: Lidhja me artet e tjera

Standardi i të nxënit

Nxënësit bëjnë lidhjen e njohurive të një disiplinë të caktuar arti me disiplina të tjera të artit dhe me fusha të tjera të të nxënit.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përjetojnë dhe lidhin njohuritë e një arti me artet e tjera, duke

u shprehur përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë etj.; përmes dëgjimit muzikor vizatojnë dhe ngjyrosin për të shprehur përjetimin e veprës;

- përdorin në mënyrë të pavarur një nga format shprehëse artistike (këngën, vallëzimin, vizatimin, dramatizimin etj.), për t'u shprehur për ndonjë temë të caktuar nga fusha të tjera të të nxëni apo çështje (p.sh., mjedisi, paqja etj.);
- lidhin saktë njohuritë artistike me fusha të tjera të të nxëni.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- lidhin saktë njohuritë e një arti me artet e tjera, duke u shprehur përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë etj.; përmes dëgjimit muzikor vizatojnë dhe ngjyrosin për të shprehur përjetimin e veprës;
- përdorin me udhëheqjen e mësuesit një nga format shprehëse artistike (këngën, vallëzimin, vizatimin, dramatizimin etj.), për t'u shprehur për ndonjë temë të caktuar nga fusha të tjera të të nxëni apo çështje (p.sh., ambienti, paqja etj.);
- lidhin njohuritë artistike me fusha të tjera të të nxënit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- arrijnë të lidhin njohuritë e një arti me artet e tjera, duke u shprehur përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë etj.; përmes dëgjimit muzikor vizatojnë dhe ngjyrosin për të shprehur përjetimin e veprës;
- përdorin vetëm me ndihmë një nga format shprehëse artistike (këngën, vallëzimin, vizatimin, dramatizimin etj.), për t'u shprehur për ndonjë temë të caktuar nga fusha të tjera të të nxëni apo çështje (p.sh., ambienti, paqja etj.);
- lidhin me vështirësi njohuritë artistike me fusha të tjera të të nxënit.

4. STANDARDET E ARRITJES NË BAZË FUSHE: (ART PAMOR DHE MUZIKË) PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT (KLASAT 7-9)

LINJA 1: Kuptimi dhe zbatimi i njohurive artistike

Standardi i të nxënit

Nxënësit përdorin duke ndërthurur konceptet e artit, për të zbatuar proceset artistike, krijuar punët e tyre artistike origjinale, duke u bazuar në ide, përvoja artistike, histori dhe opinione të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- krijojnë në mënyrë të pavarur përmes njohurive artistike punët e tyre artistike (origjinale), në *art pamor dhe muzikë*, vetëm ose me të tjerë;
- realizojnë punët e tyre artistike (origjinale), vetëm dhe me të tjerë, duke shpjeguar rrugën e ndjekur përmes proceseve artistike në *art pamor dhe muzikë*.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- zbatojnë njohuritë artistike që kanë marrë në punët e tyre artistike (origjinale) sipas modelit të ofruar në *art pamor dhe muzikë*, vetëm ose me të tjerë;
- realizojnë punët e tyre artistike (origjinale), vetëm ose me të tjerë, me ndihmën e mësuesit dhe shpjegojnë rrugën e ndjekur përmes proceseve artistike në *art pamor dhe muzikë*.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë përmes njohurive artistike punët e tyre artistike, sipas modeleve të ofruara në *art pamor dhe muzikë*;
- zbatojnë udhëzimet e mësuesit për kryerjen e proceseve artistike në realizimin e punëve të tyre artistike në *art pamor dhe muzikë*.

LINJA 2: Elemente dhe parime

Standardi i të nxënit

- Nxënësit përdorin dhe zbatojnë elementet dhe parimet e arteve, duke përdorur veçoritë e secilit.
- Arti pamor - *elementet* janë: linja, forma, hapësira, vlera, cilësia, ngjyra, koha dhe lëvizja; *parimet* janë: theksi, balanca, proporcioni, modeli, përsëritja dhe variacioni, ritmi dhe uniteti.
- Muzika - *elementet* janë: gjatësia, lartësia, dinamika, timbri, harmonia, forma.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- krijojnë në mënyrë të pavarur, duke përdorur në punët e tyre njohuritë mbi elementet dhe parimet e artit, p.sh: parimet e ndërtimit të melodisë, harmonisë, ritmit etj., parimin e kontrastit, raportit hije-dritë në vizatim;
- zbatojnë në mënyrë korrekte *elementet dhe parimet* në një punë arti, p.sh: vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe krijuese, në tema të caktuara;
- krijojnë melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- krijojnë saktë, duke përdorur në punët e tyre njohuritë mbi elementet dhe parimet e artit, p.sh: parimet e ndërtimit të melodisë, harmonisë, ritmit etj., parimin e kontrastit, raportit hije-dritë në vizatim;
- zbatojnë saktë *elementet dhe parimet* në një punë arti, p.sh: vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe krijuese në tema të caktuara;
- krijojnë melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.

Niveli bazë

Nxënësit:

- krijojnë me ndihmë, duke përdorur në punët e tyre njohuritë mbi

elementet dhe parimet e artit p.sh: parimet e ndërtimit të melodisë, harmonisë, ritmit etj., parimin e kontrastit, raportit hije-dritë në vizatim;

- përshkruajnë *elementet dhe parimet* në një punë arti, p.sh: 2-3 dimensionale, me tematikë të caktuar;
- krijojnë me ndihmë melodi në ritme të ndryshme.

LINJA 3: Historia e artit

Standardi i të nxënit

Nxënësit vlerësojnë rolin e zhvillimit të historisë së arteve dhe të veprave artistike të krijuara në kontekste të ndryshme sociale, politike, fetare dhe kulturore, gjeografike nga artistë të ndryshëm.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- zotërojnë njohuri të plota mbi kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror (p.sh., Simfonia e nëntë e Bethovenit, opera “Skënderbeu” e P.Jakova, “Mona Liza” e L. Da Vinçi, “Liqeni i mjellmave” Çajkovski, Kësulëkuqja etj.);
- analizojnë dhe nxjerrin përfundime përmes një eseje për zhvillimet shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile);
- vlerësojnë krijimet artistike të vetat dhe të të tjerëve, duke analizuar format, elementet shprehëse dhe teknikat e përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- zotërojnë njohuri mbi kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror (p.sh., Simfonia e nëntë e Bethovenit, opera “Skënderbeu” e P.Jakova, “Mona Liza” e L. Da Vinçi, “Liqeni i mjellmave” Çajkovski, Kësulëkuqja etj.);
- analizojnë dhe nxjerrin përfundime personale, për zhvillimet shoqërore

në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile);

- vlerësojnë me ndihmë krijimet artistike të vetat dhe të të tjerëve, duke analizuar format, elementet shprehëse dhe teknikat e përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë disa nga kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror (p.sh., Simfonia e nëntë e Bethovenit, opera “Skënderbeu” e P.Jakova, “Mona Liza” e L. Da Vinçi, “Liçeni i mjellmave” Çajkovski, Kësulëkuqja etj.);
- përshkruajnë disa zhvillime shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj, dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile);
- flasin për krijimet artistike të vetat dhe të të tjerëve në mënyrë të përgjithshme.

LINJA 4: Krijimi, analiza dhe vlerësimi

Standardi i të nxënit

Nxënësit zbatojnë aftësitë krijuese për të realizuar një pjesë të thjeshtë artistike, analizojnë dhe vlerësojnë krijimet e tyre dhe të të tjerëve (në art pamor dhe muzikë), duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike. Ata vlerësojnë rolin e arteve në jetën e përditshme dhe në komunitet.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- krijojnë punë të vetat në muzikë apo art pamor në mënyrë të lirshme dhe krijuese mbi një temë të caktuar, p.sh: punë dy dhe tredimensionale etj, improvizim mbi melodi e ritme të njohura më parë dhe shoqërime instrumentale në zhanre të ndryshme (popullore, artistike, argëtuese);

- interpretojnë në mënyrë shprehëse këngët, vallet kombëtare edhe të popujve të tjerë në muzikë dhe përdorin saktë motive figurative kombëtare apo të kulturave të tjera në punët e veta;
- krahasojnë në mënyrë të pavarur dy vepra arti të të njëjtës disiplinë arti apo të arteve të tjera, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike;
- vlerësojnë në mënyrë kritike krijimet artistike individuale dhe të tjerëve (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër) sipas prirjeve dhe aftësisë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- krijojnë punë të vetat në muzikë apo art pamor saktë mbi një temë të caktuar, p.sh: punë dy dhe tredimensionale etj, improvizim mbi melodi e ritme të njohura më parë dhe shoqërime instrumentale në zhanre të ndryshme (popullore, artistike, argëtuese);
- interpretojnë saktë dhe pa gabime këngët, vallet kombëtare edhe të popujve të tjerë dhe përdorin saktë motive figurative kombëtare apo të kulturave të tjera në punët e veta;
- krahasojnë me ndihmën e mësuesit dy vepra arti të të njëjtës disiplinë arti apo të arteve të tjera, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike;
- vlerësojnë në mënyrë të drejtë krijimet artistike individuale dhe të tjerëve (art pamor dhe muzikë) sipas prirjeve dhe aftësisë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- krijojnë punë të vetat në muzikë apo art pamor mbi një temë të caktuar me ndihmën e mësuesit, p.sh: punë dy dhe tredimensionale etj., improvizim mbi ritme të njohura më parë;
- këndojnë këngët, vallet kombëtare edhe të popujve të tjerë dhe përdorin motive figurative kombëtare apo të kulturave të tjera në punët e veta;
- përshkruajnë me ndihmën e mësuesit dy vepra arti të të njëjtës disiplinë arti apo të arteve të tjera, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike;
- përshkruajnë krijimet artistike individuale dhe të tjerëve (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër).

LINJA 5: Lidhja me artet e tjera

Standardi i të nxënit

Nxënësit bëjnë lidhjen e njohurive të një disiplinë të caktuar arti me disiplina të tjera të artit dhe me fusha të tjera të të nxënit.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përjetojnë dhe ndërthurin njohuritë e një arti me artet e tjera, duke u shprehur përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë etj.; përmes dëgjimit muzikor vizatojnë dhe ngjyrosin për të shprehur përjetimin e veprës;
- përdorin në mënyrë të pavarur një nga format shprehëse artistike (artin pamor apo muzikën) për t'u shprehur mbi një temë të caktuar nga fusha të tjera të të nxënit apo çështje (p.sh., ambienti, paqja etj.);
- ndërthurin saktë njohuritë artistike me fusha të tjera të të nxënit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- ndërthurin saktë njohuritë e një arti me artet e tjera, duke u shprehur përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë etj.; përmes dëgjimit muzikor, vizatojnë dhe ngjyrosin për të shprehur përjetimin e veprës;
- përdorin me udhëheqjen e mësuesit një nga format shprehëse artistike (artin pamor apo muzikën), për t'u shprehur për ndonjë temë të caktuar nga fusha të tjera të të nxënit apo çështje (p.sh., ambienti, paqja etj.);
- kuptojnë lidhjen e artit me fusha të tjera të të nxënit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- arrijnë të lidhin njohuritë e një arti me artet e tjera, duke u shprehur përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë etj.; përmes dëgjimit muzikor, vizatojnë dhe ngjyrosin për të shprehur përjetimin e veprës;
- përdorin vetëm me ndihmë një nga format shprehëse artistike (artin pamor apo muzikën) për t'u shprehur për ndonjë temë të

caktuar nga fusha të tjera të të nxënit apo çështje (p.sh., ambienti, paqja etj.);

- ndërthurin me vështirësi njohuritë artistike me fusha të tjera të të nxënit.

5. STANDARDET E ARRITJES NË BAZË LËNDE

STANDARDET E ARRITJEVE PËR LËNDËN ART PAMOR, PËR KLASAT 1-6

Në fund të klasës së 6-të:

Nxënësit komunikojnë ndjenja, ide dhe mendime duke zbatuar procesin krijues për të prodhuar punime të ndryshme arti të formës dy dhe tredimensionale, si edhe multimediale. Ata krijojnë, duke përdorur elementet dhe parimet e artit nëpërmjet një sërë teknikash të larmishme, si: teknikat e vizatimit, pikturës, skulpturës, konstruksionet, endjen. Gjithashtu ata analizojnë dhe vlerësojnë vepra të ndryshme arti, duke përfshirë veprat e artit shqiptar dhe botëror, si dhe përfaqësuesit e tyre, të krijuara në periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike. Ata kuptojnë një shumëllojshmëri formash në art, stile dhe teknika nga e shkuara dhe e tashmja. Nxënësit lidhin njohuritë artistike në lëndën e Artit pamor me lëndët e tjera brenda fushës së arteve dhe me fusha të tjera të të nxënit.

LINJA 1: Arti dydimensional

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit përdorin materialet, teknikat dhe proceset artistike dydimensionale për të krijuar punime arti origjinale (të vetat), duke u bazuar në ide, përvoja, dhe opinione të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shpjegojnë se si materialet, teknikat dhe proceset artistike dydimensionale krijojnë efekte të ndryshme që i dallojnë nga njëra-tjetra;
- përdorin materiale, teknika dhe procese të ndryshme artistike dydimensionale, në mënyrë të sigurt dhe të pavarur, për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përzgjedhin materiale, teknika dhe proceset artistike dydimensionale për të krijuar efekte të ndryshme në punimet e tyre;
- përdorin materiale, teknika dhe procese të ndryshme artistike dydimensionale, në mënyrë të sigurt, për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë me vështirësi ndryshimin midis materialeve, teknikave dhe proceseve dydimensionale;
- përdorin me ndihmë materiale, teknika dhe procese të ndryshme artistike dydimensionale, sipas udhëzimeve të mësuesit, për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Standardi i të nxënit 2*Nxënësit përdorin elementet dhe parimet e artit në veprat dydimensionale.***Përshkrimi i niveleve të arritjeve***Niveli i lartë*

Nxënësit:

- përshkruajnë se si përdorimi dhe organizimi i elementeve dhe parimeve të artit në mënyra të ndryshme në veprat dydimensionale, krijojnë efekte të ndryshme (jep rezultate të ndryshme);
- krijojnë punime arti dydimensionale, duke përdorur elementet dhe parimet në mënyrë të efektshme dhe krijuese për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shpjegojnë elementet dhe parimet e artit dhe mënyrat e përdorimit të tyre në vepra të ndryshme arti dydimensionale;
- krijojnë punime arti dydimensionale, duke përdorur elementet dhe parimet sipas modeleve të dhëna për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë me vështirësi ndryshimin midis karakteristikave vizuale të elementeve dhe parimeve në veprat dydimensionale;
- krijojnë punime arti dydimensionale, duke përdorur elementet dhe parimet sipas udhëzimeve të mësuesit, për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit reflektojnë mbi krijimet dydimensionale të veta dhe të të tjerëve, duke përshkruar, analizuar, interpretuar dhe vlerësuar ato.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve**Niveli i lartë**

Nxënësit:

- shpjegojnë se si përvojat artistike njerëzore ndikojnë në zhvillimin e veprave dydimensionale të artit;
- vlerësojnë në mënyrë kritike krijimet artistike dydimensionale individuale dhe të të tjerëve sipas prirjeve dhe aftësisë;
- krahasojnë në mënyrë të pavarur dy vepra arti dydimensionale të të njëjtës periudhë ose të periudhave të ndryshme me të njëjtën tematikë, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë që rezultatet janë të ndryshme në vepra të ndryshme dydimensionale;
- vlerësojnë krijimet artistike dydimensionale individuale dhe të të tjerëve sipas prirjeve dhe aftësisë;
- analizojnë dy vepra arti dydimensionale të të njëjtës periudhë ose të periudhave të ndryshme me të njëjtën tematikë, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë me vështirësi që ka mënyra të ndryshme për të krijuar një vepër dydimensionale;
- vlerësojnë ndonjëherë ndonjë krijim artistik dydimensional individual apo të të tjerëve sipas prirjeve dhe aftësisë;

- flasin mbi dy vepra arti dydimensionale të të njëjtës periudhë ose të periudhave të ndryshme me të njëjtën tematikë, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit kuptojnë rolin që ka luajtur arti figurativ në të shkuarën dhe të tashmen, duke shpjeguar zhvillimin, karakteristikat e veprave dhe përfaqësuesit.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shpjegojnë se si historia, kultura dhe arti pamor ndikojnë te njëritjetrin në krijimin dhe studimin e veprave dydimensionale të artit;
- vlerësojnë disa nga veprat e artit kombëtar dhe atij botëror përmes njohurive që kanë për këto vepra, duke argumentuar dhe analizuar qartë një vepër artistike shqiptare apo të huaj (dydimensionale) me një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë vepra arti dydimensionale të ndryshme, që i përkasin një kulture, periudhe dhe vendi të caktuar;
- analizojnë disa nga veprat e artit kombëtar dhe atij botëror,
- përmes njohurive që kanë për këto vepra, duke përshkruar një vepër artistike shqiptare apo të huaj (dydimensionale) me një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë me vështirësi që arti pamor ka historinë e tij dhe një lidhje të veçantë me kultura të ndryshme;
- identifikojnë disa vepra të artit kombëtar dhe atij botëror, përmes njohurive që kanë për këto vepra.

LINJA 2: Arti tredimensional

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit përdorin materialet, teknikat dhe proceset artistike tredimensionale, për të krijuar punime arti origjinale (të vetat), duke u bazuar në ide, përvoja dhe opinione të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shpjegojnë se si materialet, teknikat dhe proceset artistike tredimensionale krijojnë efekte të ndryshme që i dallojnë nga njëra-tjetra;
- përdorin materiale, teknika dhe procese të ndryshme artistike tredimensionale, në mënyrë të sigurt dhe të pavarur, për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përzgjedhin materiale, teknika dhe procese artistike tredimensionale për të krijuar efekte të ndryshme në punimet e tyre;
- përdorin materiale, teknika dhe procese të ndryshme artistike tredimensionale në mënyrë të sigurt, për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë me vështirësi ndryshimin midis materialeve, teknikave dhe proceseve tredimensionale;
- përdorin materiale, teknika dhe procese të ndryshme artistike tredimensionale, sipas udhëzimeve të mësuesit, për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit përdorin elementet dhe parimet e artit në veprat tredimensionale.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përshkruajnë se si përdorimi dhe organizimi i elementeve dhe

parimeve të artit në mënyra të ndryshme, në veprat tredimensionale, krijon efekte të ndryshme (jep rezultate të ndryshme);

- krijojnë punime arti tredimensionale, duke përdorur elementet dhe parimet në mënyrë të efektshme dhe krijuese, për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shpjegojnë elementet dhe parimet e artit dhe mënyrat e përdorimit të tyre në vepra të ndryshme arti tredimensionale;
- krijojnë punime arti tredimensionale, duke përdorur elementet dhe parimet sipas modeleve të dhëna për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Niveli bazë

Nxënësit:

- dallojnë ndryshimin midis karakteristikave vizuale të elementeve dhe parimeve në veprat tredimensionale;
- krijojnë punime arti tredimensionale, duke përdorur elementet dhe parimet sipas udhëzimeve të mësuesit, për të komunikuar ide, përvoja dhe opinione.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit reflektojnë mbi krijimet tredimensionale të veta dhe të të tjerëve, duke përshkruar, analizuar dhe vlerësuar ato.

Përshkrimi sipas niveleve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- përshkruajnë se si përvojat artistike njerëzore ndikojnë në zhvillimin e veprave tredimensionale të artit;
- vlerësojnë në mënyrë kritike krijimet artistike tredimensionale individuale dhe të të tjerëve sipas prirjeve dhe aftësisë;
- krahasojnë në mënyrë të pavarur dy vepra arti tredimensionale të së njëjtës periudhë ose të periudhave të ndryshme me të njëjtën tematikë, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë që rezultatet janë të ndryshme në vepra të ndryshme tredimensionale;
- vlerësojnë krijimet artistike tredimensionale individuale dhe të të tjerëve sipas prirjeve dhe aftësisë;
- analizojnë dy vepra arti dydimensionale të të njëjtës periudhë ose të periudhave të ndryshme me të njëjtën tematikë, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë me vështirësi që ka mënyra të ndryshme për të krijuar një vepër tredimensionale;
- vlerësojnë ndonjëherë ndonjë krijim artistik tredimensional individual apo të të tjerëve sipas prirjeve dhe aftësisë;
- flasin mbi dy vepra arti tredimensionale të të njëjtës periudhë ose të periudhave të ndryshme me të njëjtën tematikë, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit kuptojnë rolin që ka luajtur arti figurativ në të shkuarën dhe të tashmen, duke shpjeguar zhvillimin, karakteristikat e veprave dhe përfaqësuesit.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- shpjegojnë se si historia, kultura dhe arti pamor ndikojnë te njëri-tjetrin në krijimin dhe studimin e veprave tredimensionale të artit;
- vlerësojnë disa nga veprat e artit kombëtar dhe atij botëror, përmes njohurive që kanë për këto vepra, duke argumentuar dhe analizuar qartë një vepër artistike shqiptare apo të huaj (tredimensionale) me një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë vepra arti dydimensionale të ndryshme, që i përkasin një kulture, kohe dhe vendi specifik;

- analizojnë disa nga veprat e artit kombëtar dhe atij botëror, përmes njohurive që kanë për këto vepra, duke përshkruar një vepër artistike shqiptare apo të huaj (tredimensionale) me një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë me vështirësi, se arti pamor ka historinë e tij dhe një lidhje të veçantë me kultura të ndryshme;
- identifikojnë disa vepra të artit kombëtar dhe atij botëror, përmes njohurive që kanë për këto vepra.

6. STANDARDET E ARRITJES PËR LËNDËN E MUZIKËS

6.1. STANDARDET E ARRITJES PËR LËNDËN E MUZIKËS, KLASA 1-6

Në fund të klasës së 6-të:

Nxënësit njohin dhe përdorin shkrimin muzikor, duke krijuar përmes ritmeve muzikore dy, tre dhe me katër goditje, kuptojnë ndryshimet muzikore që krijohen gjatë dëgjimit të një pjesë vokale apo instrumentale: shpejtësia (tempi), karakteri, ngjyrimi i zërit dhe i instrumenteve, gjatë dëgjimit, evidentojnë llojin e muzikës për fëmijë, populllore, klasike etj., këndojnë këngë dhe lojëra muzikore për fëmijë, didaktike, të kultivuara dhe populllore, të përshtatshme për nga karakteri, përmbajtja, shtrirja, me dhe pa shoqërim instrumental, luajnë në fyell ushtrime dhe pjesë shumë të thjeshta për fëmijë, krijojnë ushtrime ritmike apo melodike në kohët e thjeshta, 2-3-4-kohore, krijojnë dhe vlerësojnë krijimet muzikore të vetat apo të të tjerëve.

Standardet e arritjeve sipas linjave

LINJA 1: Dëgjimi muzikor

Standardi i të nxënës 1

Nxënësit përdorin elementet muzikore, gjatë krijimit, interpretimit ose reflektimit të pjesëve muzikore.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- zbatojnë në mënyrë të pavarur dhe krijuese elementet muzikore, si *kohët e thjeshta, notat, intervalet muzikore, shkallët muzikore, shenjat e përsëritjes* etj., gjatë krijimit, interpretimit apo reflektimit të pjesëve muzikore;
- shpjegojnë saktë elementet muzikore dhe përdorimin e tyre, duke i konkretizuar ato në një këngë apo pjesë muzikore vokale ose instrumentale.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin saktë elementet muzikore, si *kohët e thjeshta, notat, intervalet muzikore, shkallët muzikore, shenjat e përsëritjes* etj., gjatë krijimit, interpretimit apo reflektimit të pjesëve muzikore, sipas një modeli të ofruar.
- shpjegojnë me ndihmën e mësuesit elementet muzikore, duke i konkretizuar ato në një këngë apo pjesë muzikore vokale ose instrumentale.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përdorin me vështirësi elementet muzikore, si *kohët e thjeshta, notat, intervalet muzikore, shkallët muzikore, shenjat e përsëritjes* etj., gjatë krijimit, interpretimit apo reflektimit të pjesëve muzikore;
- përshkruajnë me vështirësi elementet muzikore në një këngë apo pjesë muzikore vokale dhe instrumentale, duke ndjekur udhëzimet e mësuesit.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit lexojnë dhe krijojnë në ritme të ndryshme muzikore.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- krijojnë ushtrime ritmike dhe melodike saktë dhe në mënyrë të pavarur, në ritmet e thjeshta muzikore $2/4$, $3/4$, $4/4$, duke shpjeguar çdo element muzikor të përdorur;

- shpjegojnë krijimet e tyre në ritmet e thjeshta muzikore $2/4$, $3/4$, $4/4$, duke krahasuar punën e vet me të tjerët, me argumente logjike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- krijojnë ushtrime ritmike apo melodike saktë sipas një modeli të dhënë, në ritmet e thjeshta muzikore $2/4$, $3/4$, $4/4$, duke shpjeguar elementet muzikore të përdorura;
- shpjegojnë krijimet e tyre, në ritmet e thjeshta muzikore $2/4$, $3/4$, $4/4$, me argumente logjike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- krijojnë ushtrime ritmike apo melodike me ndihmën e mësuesit, në ritmet e thjeshta muzikore $2/4$, $3/4$, $4/4$;
- përshkruajnë punën e tyre, bazuar në ritmet e thjeshta muzikore $2/4$, $3/4$, $4/4$, me ndihmën e mësuesit.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit demonstrojnë njohjen e zhvillimit të muzikës në kohë dhe hapësirë, nga kultura të vendeve të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë muzikën e dëgjuar, vokale apo instrumentale, duke mbajtur një qëndrim të vetin dhe përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- krahasojnë në mënyrë të pavarur, duke nxjerrë karakteristikat e zhvillimit të muzikës në vende dhe kultura të ndryshme.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shpjegojnë muzikën e dëgjuar, vokale apo instrumentale, duke përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- identifikojnë karakteristikat e zhvillimit të muzikës në vende dhe kultura të ndryshme në mënyrë të pavarur, sipas një modeli të ofruar.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë me ndihmën e mësuesit, për muzikën e dëgjuar vokale apo instrumentale, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike;
- përcaktojnë disa karakteristika të zhvillimit të muzikës në vende dhe kultura të ndryshme, me ndihmën e mësuesit.

Standardi i të nxënit 4

Nxënësit demonstrojnë njohjen e zhvillimit të muzikës shqiptare, vokale dhe instrumentale dhe përfaqësuesve të saj.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- vlerësojnë duke mbajtur një qëndrim të vetin për muzikën e dëgjuar shqiptare, vokale e instrumentale dhe përfaqësuesve të saj e përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- krahasojnë dhe nxjerrin në mënyrë të pavarur, karakteristikat e zhvillimit të muzikës shqiptare, veprave vokale e instrumentale dhe përfaqësuesve të saj.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë saktë muzikën e dëgjuar, shqiptare, vokale e instrumentale dhe përfaqësuesve të saj, duke përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- identifikojnë sipas një modeli të ofruar, karakteristikat e zhvillimit të muzikës shqiptare, veprave vokale e instrumentale dhe përfaqësuesve të saj.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë me ndihmën e mësuesit, muzikën e dëgjuar shqiptare, vokale e instrumentale dhe përfaqësuesve të saj dhe përdorin një gjuhë të thjeshtë artistike;
- identifikojnë vetëm me ndihmën e mësuesit, karakteristikat e zhvillimit të muzikës shqiptare, veprave vokale e instrumentale dhe përfaqësuesve të saj.

LINJA 2: Kënga dhe instrumenti

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit këndojnë shumëllojshmëri këngësh, vetëm dhe me të tjerët.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- këndojnë saktë në ritëm dhe intonacion, vetëm dhe me të tjerë, të gjitha këngët e mësuara;
- interpretojnë me ndjenjë dhe në mënyrë shprehëse, pavarësisht përmbajtjes tekstuale të këngëve.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- këndojnë saktë me ndihmën e mësuesit, vetëm dhe me të tjerë, në ritëm dhe intonacion të gjitha këngët e mësuara;
- interpretojnë këngët vetëm dhe me të tjerë, sipas një modeli të dëgjuar, përmbajtjen tekstuale të këngëve.

Niveli bazë

Nxënësit:

- këndojnë disa këngë të mësuara, vetëm dhe me të tjerë;
- këndojnë pavarësisht përmbajtjes tekstuale të këngëve, vetëm dhe me të tjerë.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit luajnë në instrumente të ndryshme muzikore ORF melodike dhe ritmike, fyell, vetëm dhe me të tjerët.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shoqërojnë saktë ritmiku me instrumentet me goditje dhe ato ORF, vetëm dhe me të tjerë, këngët, lojërat muzikore ose krijojnë ritme të ndryshme;
- luajnë saktë në instrumentin e fyellit, vetëm dhe me të tjerë, të gjitha ushtrimet dhe pjesët e mësuara;

- interpretojnë në instrumentin e fyellit me ndjenjë dhe në mënyrë shprehëse, të gjitha ushtrimet dhe pjesët e mësuara.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shoqërojnë me vështirësi ritmikusht me instrumentet me goditje dhe ato ORF, këngët, lojërat muzikore ose krijojnë ritme të ndryshme;
- luajnë me ndihmën e mësuesit në *instrumentin e fyellit*, ushtrimet dhe pjesët e mësuara;

Niveli bazë

Nxënësit:

- shoqërojnë ritmikusht me ndihmë, këngët, lojërat muzikore me instrumentet me goditje dhe ato ORF;
- luajnë me vështirësi në instrumentin e fyellit, ushtrimet dhe pjesët e mësuara.

LINJA 3: Krijimi dhe reflektimi

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit krijojnë dhe analizojnë punën e tyre dhe të të tjerëve, bazuar mbi elementet muzikore të përdorura.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- ritmizojnë në mënyrë të pavarur vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole ose krijojnë melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik;
- krijojnë në mënyrë të pavarur ose me të tjerë melodi të thjeshta muzikore dhe i përdorin në veprimtari të ndryshme shkollore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- ritmizojnë saktë, vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole ose krijojnë melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik;

- krijojnë me ndihmë, melodi të thjeshta muzikore dhe i përdorin në veprimtari të ndryshme shkollore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- ritmizojnë me vështirësi sipas një modeli të dhënë, vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole, ose krijojnë me vështirësi sipas një modeli të dhënë, melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik;
- krijojnë me vështirësi melodi të thjeshta muzikore për t'i përdorur ato në veprimtari të ndryshme shkollore.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit dëgjojnë, përshkruajnë dhe analizojnë pjesë muzikore vokale apo instrumentale, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë, duke analizuar në mënyrë të pavarur pjesë të ndryshme muzikore dhe demonstruar shprehi të zhvilluara të qëndrimit kritik, muzikës që luhet ose këndohet;
- përfytyrojnë vetëm apo me të tjerë një vepër muzikore, duke u shprehur përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë, vizatimit etj.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- vlerësojnë me ndihmë, pjesë të ndryshme muzikore, duke demonstruar shprehi të zhvilluara të qëndrimit kritik, muzikës që luhet ose këndohet;
- përfytyrojnë vetëm apo me të tjerë një vepër muzikore, duke u shprehur me kujdes përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë, vizatimit etj.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë ndonjë pjesë muzikore, duke demonstruar ndonjë shprehi të qëndrimit kritik, muzikës që luhet ose këndohet;

- përjetojnë vetëm apo me të tjerë një vepër muzikore, dhe me ndihmën e mësuesit arrijnë të shprehën përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë, vizatimit etj.

Standardi i të nxënës 3

Nxënësit vlerësojnë rolin e muzikës në jetën e përditshme dhe komunitet.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë saktë rëndësinë dhe rolin e veprimtarive artistike që zhvillohen në komunitet ose në jetën e tyre të përditshme, duke shprehur me fjalë të thjeshta emocionet që krijojnë këto veprimtari.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë rëndësinë dhe rolin e veprimtarive artistike që zhvillohen në komunitet ose në jetën e tyre të përditshme, duke shprehur me fjalë të thjeshta emocionet që krijojnë këto veprimtari.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë rolin e veprimtarive që zhvillohen në komunitet ose në jetën e tyre të përditshme, duke shprehur me fjalë të thjeshta emocionet që krijojnë këto veprimtari.

6.2. STANDARDET E ARRITJES PËR LËNDËN E MUZIKËS, KLASA 7-9

Në fund të klasës së 9-të:

Nxënësit krijojnë, këndojnë dhe luajnë në kohët e përbëra dhe të përziera, duke përdorur edhe vlerat 1/8 dhe 1/16; dallojnë intervalet dhe shenjat e shartimit në muzikë; zbatojnë masën e paplotësuar, lidhjen vlerëse dhe shprehëse, koronën, sinkopën në shembujt muzikorë; dallojnë format e thjeshta muzikore A-B; A-B-A në pjesë të ndryshme vokale, instrumentale, vokale-instrumentale; dallojnë llojet e orkestrave; luajnë në fyell; këndojnë këngë tematike për fëmijë (të rinj), këngë popullore, këngë të huaja, pjesë të vogla (me një ose dy zëra); kanone; vlerësojnë zhvillimin e muzikës popullore shqiptare, këngët, vallet dhe muzika instrumentale; shpjegojnë zhvillimin e muzikës së kultivuar

shqiptare, duke renditur disa nga përfaqësuesit kryesorë; vlerësojnë zhvillimin dhe rolin e kulturës muzikore shqiptare dhe botërore dhe të veprave artistike të krijuara në kontekste të ndryshme sociale, politike, fetare dhe kulturore nga artistë të ndryshëm; vlerësojnë zhvillimin e muzikës moderne përmes rrymave bluz, xhaz, rok.

STANDARDET E ARRITJES SIPAS LINJAVE

LINJA 1: Dëgjimi muzikor

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet muzikore gjatë krijimit, interpretimit apo reflektimit të pjesëve muzikore

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- zbatojnë në mënyrë të pavarur dhe krijuese elementet muzikore kohët thjeshta kohët e përbëra dhe të përziera, masën e paplotësuar, lidhjen vlerëse dhe lidhjen shprehëse, koronën, sinkopën etj., gjatë krijimit, interpretimit ose reflektimit të pjesëve muzikore;
- shpjegojnë saktë elementet muzikore dhe përdorimin e tyre, duke konkretizuar ato në një këngë apo pjesë muzikore vokale dhe instrumentale, shqiptare dhe të huaja.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përdorin saktë elementet muzikore kohët e thjeshta, kohët e përbëra dhe të përziera, masën e paplotësuar, lidhjen vlerëse dhe lidhjen shprehëse, koronën, sinkopën etj., gjatë krijimit, interpretimit apo reflektimit të pjesëve muzikore, sipas një modeli të ofruar;
- shpjegojnë me ndihmën e mësuesit elementet muzikore, duke i konkretizuar ato në një këngë apo pjesë muzikore vokale dhe instrumentale shqiptare dhe të huaja.

Niveli bazë

Nxënësit:

- identifikojnë me vështirësi elementet muzikore kohët e thjeshta, kohët e përbëra dhe të përziera, masën e paplotësuar, lidhjen vlerëse dhe lidhjen

shprehëse, koronën, sinkopën etj., gjatë krijimit, interpretimit apo reflektimit të pjesëve muzikore;

- përshkruajnë me vështirësi elementet muzikore në një këngë apo pjesë muzikore vokale dhe instrumentale shqiptare dhe të huaja, duke ndjekur udhëzimet e mësuesit.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit lexojnë dhe krijojnë me notat muzikore në ritme të ndryshme muzikore.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- krijojnë ushtrime ritmike dhe melodike saktë dhe në mënyrë të pavarur, në ritmet muzikore 3/8, 6/8, 5/8, 7/8, 9/8, duke shpjeguar çdo element muzikor të përdorur;
- shpjegojnë krijimet e tyre në ritmet muzikore 3/8, 6/8, 5/8, 7/8, 9/8, duke krahasuar punën e vet me të tjerëve, me argumente logjike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- krijojnë ushtrime ritmike apo melodike saktë sipas një modeli të dhënë, në ritmet muzikore 3/8, 6/8, 5/8, 7/8, 9/8, duke shpjeguar elementet muzikore të përdorura;
- shpjegojnë krijimet e tyre, në ritmet muzikore 3/8, 6/8, 5/8, 7/8, 9/8, me argumente logjike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- krijojnë me vështirësi ushtrime ritmike apo melodike me ndihmën e mësuesit, në ritmet muzikore 3/8, 6/8, 5/8, 7/8, 9/8;
- përshkruajnë punën e vet, bazuar në ritmet muzikore 3/8, 6/8, 5/8, 7/8, 9/8, me ndihmën e mësuesit.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit demonstrojnë njohjen e zhvillimit të muzikës në kohë dhe hapësirë nga kultura të vendeve të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë zhvillimin e muzikës, vokale apo instrumentale, në kohë dhe hapësirë nga kultura të vendeve të ndryshme, duke mbajtur një qëndrim të vetin dhe përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- evidentojnë në mënyrë të pavarur dhe shpjegojnë mënyrën e ndërtimit të formës së veprave muzikore në stile të ndryshme (fuga, sonata etj., e në zhanre të ndryshme, si këngë popullore, muzikë e lehtë, rok, pop, jaz etj.).

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë zhvillimin e muzikën, vokale apo instrumentale në kohë dhe hapësirë nga kultura të vendeve të ndryshme, duke përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- shpjegojnë mënyrën e ndërtimit të formës së veprave muzikore në stile të ndryshme (fuga, sonata etj.) e në zhanre të ndryshme (këngë popullore, muzikë e lehtë, rok, pop, jaz etj.), sipas një modeli të dhënë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë me ndihmën e mësuesit, zhvillimin e muzikës vokale apo instrumentale, në kohë dhe hapësirë nga kultura të vendeve të ndryshme, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike;
- shpjegojnë me ndihmën e mësuesit, mënyrën e ndërtimit të formës së veprave muzikore, në stile të ndryshme (fuga, sonata etj.) e në zhanre të ndryshme (këngë popullore, muzikë e lehtë, rok, pop, jaz etj.) sipas një modeli të dhënë.

Standardi i të nxënës 4

Nxënësit demonstrojnë njohjen e zhvillimit të muzikës shqiptare, vokale dhe instrumentale dhe përfaqësuesve të saj.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë duke mbajtur një qëndrim të vetin për muzikën popullore të Shqipërisë së Jugut, të Mesme dhe të Veriut, duke dhënë

disa karakteristika të saj mbi *këngët, vallet popullore* dhe elementet kryesore që i përbëjnë ato, apo *muzikën e kultivuar dhe përfaqësuesit e tyre*, duke përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;

- krahasojnë dhe nxjerrin në mënyrë të pavarur për muzikën popullore të Shqipërisë së Jugut, të Mesme dhe të Veriut, duke dhënë disa karakteristika të saj mbi *këngët, vallet popullore* dhe elementet kryesore që i përbëjnë ato, apo *muzikën e kultivuar dhe përfaqësuesit e tyre*.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë saktë muzikën popullore të Shqipërisë së Jugut, të Mesme dhe të Veriut, duke dhënë disa karakteristika të saj mbi *këngët, vallet popullore* dhe elementet kryesore që i përbëjnë ato, apo *muzikën e kultivuar dhe përfaqësuesit e tyre*, duke përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- përshkruajnë sipas një modeli të ofruar, karakteristikat e zhvillimit të muzikës popullore të Shqipërisë së Jugut, të Mesme dhe të Veriut, duke dhënë disa karakteristika të saj mbi *këngët, vallet popullore* dhe elementet kryesore që i përbëjnë ato, apo *muzikën e kultivuar dhe përfaqësuesit e tyre*.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë vetëm me ndihmën e mësuesit karakteristikat e muzikës popullore të Shqipërisë së Jugut, të Mesme dhe të Veriut, duke dhënë disa shpjegime mbi *këngët, vallet popullore* dhe elementet kryesore që i përbëjnë ato, apo *muzikën e kultivuar dhe përfaqësuesit e tyre* dhe përdorin një gjuhë të thjeshtë artistike;

LINJA 2: Kënga dhe instrumenti

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit këndojnë shumëllojshmëri këngësh, vetëm dhe me të tjerët.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- këndojnë saktë në ritëm dhe intonacion, vetëm dhe me të tjerë, të gjitha

këngët e mësuara për fëmijë (të rinj), popullore, të huaja, moderne të rrymave të ndryshme, pjesë të vogla (me një ose dy zëra) etj;

- interpretojnë me ndjenjë dhe në mënyrë shprehëse, pavarësisht përmbajtjes tekstuale të këngëve të mësuara.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- këndojnë vetëm dhe me të tjerë, në ritëm dhe intonacion të gjitha këngët e mësuara, për fëmijë (të rinj), popullore, të huaja, moderne të rrymave të ndryshme, pjesë të vogla (me një ose dy zëra) etj;
- interpretojnë këngët vetëm dhe me të tjerë, sipas një modeli të dëgjuar, përmbajtjen tekstuale të këngëve të mësuara.

Niveli bazë

Nxënësit:

- këndojnë përgjithësisht këngët e mësuara, vetëm dhe me të tjerë për fëmijë (të rinj), popullore, të huaja, moderne të rrymave të ndryshme, pjesë të vogla (me një ose dy zëra) etj;
- këndojnë pavarësisht përmbajtjes tekstuale të këngëve, vetëm dhe me të tjerë, të mësuara.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit luajnë në instrumente të ndryshme muzikore ORF melodike dhe ritmike, fyell, vetëm dhe me të tjerët.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- shoqërojnë saktë ritmikisht me instrumentet ORF, vetëm dhe me të tjerë, këngët e mësuara në ritme të ndryshme;
- luajnë saktë në *instrumentin e fyellit*, vetëm dhe me të tjerë, të gjitha ushtrimet dhe pjesët e mësuara;
- interpretojnë në instrumentin e fyellit me ndjenjë dhe në mënyrë shprehëse, të gjitha ushtrimet dhe pjesët e mësuara.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shoqërojnë ritmikisht me instrumentet ORF, vetëm dhe me të tjerë, këngët e mësuara në ritme të ndryshme;

- luajnë me ndihmën e mësuesit në *instrumentin e fyellit*, vetëm dhe me të tjerë, ushtrimet dhe pjesët e mësuara;
- luajnë në *instrumentin e fyellit* me ndjenjë dhe në mënyrëshprehëse, ushtrimet dhe pjesët e mësuara.

Niveli bazë

Nxënësit:

- shoqërojnë ritmíkisht me ndihmë këngët me instrumentet ORF;
- luajnë në *instrumentin e fyellit*, disa ushtrime dhe pjesë të mësuara;
- luajnë me vështirësi në *instrumentin e fyellit*, në mënyrë shprehëse, ushtrimet dhe pjesët e mësuara.

LINJA 3: Krijimi dhe reflektimi

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit krijojnë dhe analizojnë punën e tyre dhe të të tjerëve, bazuar mbi elementet muzikore të përdorura.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- krijojnë në mënyrë të pavarur, vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole ose krijojnë melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik;
- analizojnë krijimet e veta apo të të tjerëve, me argumente logjike, duke u mbështetur në njohuritë muzikore që kanë marrë përgjatë 9 viteve;
- krijojnë në mënyrë të pavarur melodi të thjeshta muzikore dhe i përdorin në veprimtari të ndryshme shkollore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- krijojnë vargje ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole ose krijojnë melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik;
- analizojnë krijimet e veta apo të të tjerëve, duke u mbështetur në njohuritë muzikore që kanë marrë përgjatë 9 viteve;
- krijojnë me ndihmë, melodi të thjeshta muzikore dhe i përdorin në veprimtari të ndryshme shkollore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- krijojnë sipas një modeli të dhënë vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor, me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik;
- përshkruajnë me vështirësi për krijimet e veta apo të të tjerëve, duke u mbështetur në njohuritë muzikore që kanë marrë përgjatë 9 viteve;
- krijojnë me vështirësi melodi të thjeshta muzikore për t'i përdorur ato në veprimtari të ndryshme shkollore.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit dëgjojnë, përshkruajnë dhe analizojnë pjesë muzikore vokale apo instrumentale, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë duke analizuar në mënyrë të pavarur, pjesë të ndryshme muzikore dhe demonstruar shprehi të zhvilluara të qëndrimit kritik, ndaj muzikës që luhet ose këndohet;
- përjetojnë një vepër muzikore, duke u shprehur përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë, vallëzimit, vizatimit etj.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- vlerësojnë me ndihmë, pjesë të ndryshme muzikore, duke demonstruar shprehi të zhvilluara të qëndrimit kritik, muzikës që luhet ose këndohet;
- përjetojnë një vepër muzikore, duke u shprehur me kujdes përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë, vizatimit etj.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë, ndonjë pjesë muzikore, duke demonstruar ndonjë shprehi të qëndrimit kritik, muzikës që luhet ose këndohet;
- përjetojnë një vepër muzikore, me ndihmën e mësuesit duke arritur të shprehen përmes të folurit, shkrimit (esesë), poezisë, vizatimit etj.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit vlerësojnë rolin e muzikës në jetën e përditshme dhe komunitet.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë saktë duke shprehur me fjalë të thjeshta, rëndësinë dhe rolin e veprimtarive artistike që zhvillohen në komunitet ose në jetën e tyre të përditshme, si dhe emocionet që krijojnë këto veprimtari.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- analizojnë rëndësinë dhe rolin e veprimtarive artistike që zhvillohen në komunitet ose në jetën e tyre të përditshme, si dhe emocionet që krijojnë këto veprimtari.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë rolin e veprimtarive që zhvillohen në komunitet ose në jetën e tyre të përditshme, duke shprehur me fjalë të thjeshta.

7. STANDARDET E ARRITJES PËR LËNDËN KËRCIM, KLASAT 2-3

Në fund të klasës së 3-të:

Nxënësit mësojnë kërcime të thjeshta, përmes elementëve të kërcimit: *hapësirës*, që ka të bëjë me drejtimin, nivelin, amplitudën, fokusin, grupin dhe formën; *ritmit*, që ka të bëjë me tempin, kohëzgjatjen, theksin dhe ritmin muzikor; *dinamikës*, që ka të bëjë me forcën ose energjinë, tensionin dhe relaksin; *lëvizjes*, që ka të bëjë me zhvendosjen nga vendi, duke përfshirë ecjen, vrapin, kërcimin, rrëshqitjen, kapërcimin dhe galopin; *gjestit*, që ka të bëjë me një lëvizje që nuk ka ngarkesë dhe që mund të jetë një rrotullim, përkulje, zgjatje dhe dridhje; *motivit*, që ka të bëjë me një pjesë të kërcimit që mund të paraqitet në mënyra të ndryshme, si e shpejtë ose e ngadaltë, me shumë ose me pak forcë, përmes lëvizjeve. Nxënësit kuptojnë mënyra të ndryshme të lëvizjes në hapësirë nën ritme të ndryshme muzikore; dallojnë

gjatë dëgjimit dhe lëvizjeve zhanret kryesore të muzikës (marsh, këngë, vals) etj.; kuptojnë dallimin midis ritmeve 2, 3 dhe me 4 rrahje, përmes shembujve të ndryshëm me hapa të thjeshtë; realizojnë lëvizje të thjeshta të valsit, të polkës, bazuar në nivelin moshor; realizojnë lëvizjet në mënyrë emocionale, duke u orientuar në hapësirë dhe në nivele të ndryshme: shtrirë, në këmbë, në ajër; improvizojnë kërcime të thjeshta, me një partner ose në grup; vlerësojnë kërcimet e veta apo të nxënësve të tjerë të ekzekutuara, me fjalë të thjeshta.

STANDARDET E ARRITJEVE SIPAS LINJAVE

LINJA 1: Zbulojmë nëpërmjet procesit krijues

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit demonstrojnë aftësitë lëvizore, elementet e lëvizjes (hapësira, koha, energjia forca, dhe forma) dhe cilësitë e lëvizjes.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- kërcejnë në mënyrë të pavarur dhe krijuese *elementet bazë* që përbëjnë një kërcim *hapësira, ritmi, dinamika, lëvizja, gjesti, motivi* etj., dhe të ushtrimeve, gjatë kërcimeve të thjeshta dhe valleve popullore;
- shpjegojnë saktë elementet kërcyese dhe përdorimin e tyre, duke i konkretizuar ato gjatë një kërcimi të thjeshtë, etydi ritmik, marshi, vals, polka apo valle popullore.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- kërcejnë saktë *elementet bazë* që përbëjnë një kërcim *hapësira, ritmi, dinamika, lëvizja, gjesti, motivi* dhe të ushtrimeve, gjatë kërcimeve të thjeshta dhe valleve popullore;
- shpjegojnë saktë *elementet bazë* që përbëjnë një kërcim dhe përdorimin e tyre, në një etyd ritmik, marsh, vals, polkë apo valle popullore.

Niveli bazë

Nxënësit:

- kërcejnë me vështirësi *elementet bazë* që përbëjnë një kërcim *hapësira, ritmi, dinamika, lëvizja, gjesti, motivi* gjatë kërcimeve të thjeshta dhe valleve popullore;
- përshkruajnë me ndihmën e mësuesit *elementet bazë* që përbëjnë një kërcim të thjeshtë apo valle popullore.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit kuptojnë se vallja është një formë artistike për të komunikuar dhe për të shprehur gjendje të ndryshme emocionale.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- kërcejnë në mënyrë korrekte kërcime të thjeshta në ritëm, temp dhe dinamikë, duke i shoqëruar ato me përplasje duarsh ose këmbësh sipas ritmit dhe kohës që ata dëgjojnë, duke i ndërthurur ato me lëvizjen (lëvizje të thjeshta, hapa të vegjël, të gjerë etj.);
- zbatojnë në mënyrë korrekte rregullat për mbajtjen e duarve dhe të trupit në kërcimet përkatëse.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- kërcejnë me ndihmën e mësuesit kërcime të thjeshta në ritëm, temp dhe dinamikë, duke i shoqëruar ato me përplasje duarsh ose këmbësh sipas ritmit dhe kohës që ata dëgjojnë, duke i ndërthurur ato me lëvizjen (lëvizje të thjeshta, hapa të vegjël, të gjerë etj.);
- zbatojnë me ndihmën e mësuesit rregullat për mbajtjen e duarve dhe të trupit në kërcimet përkatëse.

Niveli bazë

Nxënësit:

- kërcejnë me vështirësi kërcime të thjeshta në ritëm, temp dhe dinamikë, duke i shoqëruar ato me përplasje duarsh ose këmbësh sipas ritmit dhe kohës që ata dëgjojnë, duke i ndërthurur ato me lëvizjen (lëvizje të thjeshta, hapa të vegjël, të gjerë etj.);
- zbatojnë me vështirësi rregullat për mbajtjen e duarve dhe të trupit në kërcimet përkatëse.

Standardi i të nxënës 3

Nxënësit kuptojnë rolin e kërcimit në periudha të ndryshme historike dhe kultura të ndryshme.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- vlerësojnë çdo kërcim, p.sh: valsin, polkën, vallen popullore shqiptare etj., përmes përmbajtjes, karakterit dhe stilit të tyre, dhe shpjegojnë rolin e kërcimeve të ndryshme, në periudha të ndryshme historike dhe në kultura të ndryshme, duke përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- krahasojnë në mënyrë të pavarur karakteristikat midis dy kërcimeve të thjeshta të vendit apo të huaja, p.sh: vallja e Napolonit dhe vallja Pogonishte ose valsi dhe polka.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- përshkruajnë çdo kërcim, p.sh: valsin, polkën, vallen popullore shqiptare etj., përmes përmbajtjes, karakterit dhe stilit të tyre, dhe përshkruajnë rolin e kërcimeve të ndryshme në periudha të ndryshme historike dhe në kultura të ndryshme, duke përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- evidentojnë me ndihmë, karakteristikat midis dy kërcimeve të thjeshta të vendit apo të huaja, p.sh: vallja e Napolonit dhe vallja Pogonishte ose valsi dhe polka.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë me vështirësi kërcime të tilla, si p.sh: valsin, polkën, vallen popullore shqiptare etj., përmes përmbajtjes, karakterit dhe stilit të tyre, dhe përshkruajnë me vështirësi rolin e kërcimeve të ndryshme në periudha të ndryshme historike dhe në kultura të ndryshme;
- evidentojnë me vështirësi karakteristikat midis dy kërcimeve të thjeshta të vendit apo të huaja, p.sh: vallja e Napolonit dhe vallja Pogonishte ose valsi dhe polka.

LINJA 2: Krijojmë dhe bashkëpunojmë përmes kërcimit

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit demonstrojnë elemente të ndryshme të lëvizjes, të lidhura së bashku në hapësirë dhe kohë.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- kërcëjnë saktë dhe në ritëm me hapa të thjeshtë fragmente shumë të shkurtra muzikore, duke e përdorur hapin në mënyra të ndryshme: *duke ecur, duke rrëshqitur, duke u hedhur, duke vrapuar* etj;
- shpjegojnë në mënyrë të pavarur ndryshimet në karakterin e këtyre kërcimeve, duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- kërcëjnë me ndihmë në ritëm me hapa të thjeshtë fragmente shumë të shkurtra muzikore, duke e përdorur hapin në mënyra të ndryshme: *duke ecur, duke rrëshqitur, duke u hedhur, duke vrapuar* etj;
- kërcëjnë me ndihmë, duke realizuar lëvizjet e valsit në vend; hapin bazë të valsit duke u zhvendosur para dhe mbrapa; hapin bazë të valsit me rrotullim;
- kërcëjnë me ndihmën e mësuesit, duke realizuar *hapin bazë* të polkës në vend, *anash, me rrotullim dhe në çift*;
- shpjegojnë me ndihmë, ndryshimet në karakterin e këtyre kërcimeve, duke përdorur një fjalor artistik me fjalë të thjeshta.

Niveli bazë

Nxënësit:

- kërcëjnë me vështirësi në ritëm me hapa të thjeshtë fragmente shumë të shkurtra muzikore, duke e përdorur hapin në mënyra të ndryshme: *duke ecur, duke rrëshqitur, duke u hedhur, duke vrapuar* etj;
- kërcëjnë me vështirësi, duke realizuar lëvizjet e valsit në vend; hapin bazë të valsit, duke u zhvendosur para dhe mbrapa; hapin bazë të valsit me rrotullim;
- kërcëjnë me vështirësi, duke realizuar *hapin bazë* të polkës në vend, *anash, me rrotullim dhe në çift*;

- shpjegojnë me vështirësi ndryshimet në karakterin e këtyre kërcimeve, duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit zbatojnë aftësitë krijuese për të realizuar një kërcim të thjeshtë.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- kërcejnë saktë duke realizuar lëvizjet e valsit në vend; hapin bazë të valsit duke u zhvendosur para dhe mbrapa; hapin bazë të valsit me rrotullim;
- kërcejnë saktë duke realizuar *hapin bazë* të polkës në *vend, anash, me rrotullim* dhe në *çift*.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- kërcejnë me ndihmë, duke realizuar lëvizjet e valsit në vend; hapin bazë të valsit duke u zhvendosur para dhe mbrapa; hapin bazë të valsit me rrotullim;
- kërcejnë me ndihmë, duke realizuar *hapin bazë* të polkës në *vend, anash, me rrotullim* dhe në *çift*.

Niveli bazë

Nxënësit:

- kërcejnë me vështirësi, duke realizuar lëvizjet e valsit në vend; hapin bazë të valsit, duke u zhvendosur para dhe mbrapa; hapin bazë të valsit me rrotullim;
- kërcejnë me vështirësi, duke realizuar *hapin bazë* të polkës në *vend, anash, me rrotullim* dhe në *çift*.

LINJA 3: Reflektojmë përmes kërcimit

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit mbajnë qëndrim ndaj kërcimeve që realizojnë vetë apo ndaj kërcimeve të realizuara nga të tjerët.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- analizojnë gjatë diskutimeve të hapura në mënyrë të pavarur përdorimin e elementeve kërcyese gjatë një kërcimi apo debutimi në shkollë apo shfaqje, duke argumentuar qëndrimin e tyre ndaj realizimit kërcyes të vetit apo të të tjerëve;
- zhvillojnë idetë mbi ecurinë e tyre artistike, në këtë disiplinë artistike, gjë që do t'i motivojë ata më tej për t'u përfshirë në mënyrë aktive në jetën shoqërore, artistike dhe kulturore të shkollës apo dhe të komunitetit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shpjegojnë me ndihmë përdorimin e elementeve kërcyese gjatë një kërcimi, debutimi në shkollë duke shpjeguar qëndrimin e tyre ndaj realizimit kërcyes të vetit apo të të tjerëve;
- zhvillojnë disa ide mbi ecurinë e tyre artistike, në këtë fushë, gjë që mund t'i motivojë ata për t'u përfshirë në mënyrë aktive në jetën shoqërore, artistike dhe kulturore të shkollës apo dhe të komunitetit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë me vështirësi gjatë diskutimeve të hapura, përdorimin e elementeve dramatike në një shfaqjeje, duke shprehur qëndrimin e tyre ndaj realizimit kërcyes të vetit apo të të tjerëve;
- zhvillojnë me vështirësi disa ide mbi ecurinë e tyre artistike, në këtë fushë

8. STANDARDET E ARRITJES PËR LËNDËN TEATËR, KLASAT 5-6

Në fund të klasës së 6-të:

Nxënësit bëhen të ndjeshëm të marrin njohuri, të zhvillojnë ide, kryesisht nëpërmjet lojërave, ushtrimeve dhe veprimtarive teatrale në klasë; për

elementet dhe parimet bazë të artit të teatrit përdorin elementet dhe parimet bazë për zhvillimin e artit të teatrit, krijojnë një lidhje të përhershme midis lojërave *me sikur* dhe teatrit si formë artistike, kuptojnë gjithashtu lidhjen midis lojës, gjuhës, mendimit dhe jetës, që të zhvillojnë në këtë mënyrë aftësitë e tyre krijuese, shprehëse dhe komunikuese, përfshihen në mënyrë të hapur, të vullnetshme dhe emocionalisht me të tjerët gjatë këtyre lojërave dhe realizimeve krijuese, bëhen të vetëdijshëm nëpërmjet një procesi bashkëpunimi dhe bashkëveprimi për hapat e realizimit të një shfaqjeje teatrale, duke filluar nga krijimi i materialit letrar-skenik nëpërmjet dramatizimit, duke vijuar me punën për realizimin e roleve dhe më tej me gjithë hapat e tjerë që çojnë drejt *realizimit të shfaqjes*; njohin rolin e tyre individual dhe rolin e shokëve në një pjesë artistike, aftësohen në një përballje publike, aftësohen të shprehen bukur, rrjedhshëm dhe pa drojë, ndërgjegjësohen për forcën që kanë mjete të tjera komunikimi, si gjuha e gjesteve, gjuha e trupit dhe shprehjet mimike të fytyrës, shprehen në mënyrë të kulturuar në gjuhën amtare.

STANDARDET E ARRITJES SIPAS LINJAVE

LINJA 1: Zbulojmë nëpërmjet procesit krijues

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit kuptojnë rolin e aktrimit nëpërmjet elementeve të teatrit.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- realizojnë në mënyrë të pavarur, në dramatizime përrallash, poezish, tregimesh, nga folklori apo legjendat *elementet bazë të proceseve teatrale*, si: *aktrimi* (roli, karakteri, sikuri, të besuarit, marrëdhënia me partnerin, veprimi fizik dhe psikik, veprimi me anë të fjalës, veprimi me anë të gjestit, veprimi me mimikë, përqendrimi, të dëgjuarit, të shikuarit etj.), *drama* (subjekti, karakteret, veprimi, dialogu etj.), *shfaqja* (aktorët, spektatorët, hapësira dhe koha skenike, kostumet, muzika etj.).

Niveli mesatar

Nxënësit:

- realizojnë me ndihmë, në dramatizime përrallash, poezish, tregimesh, nga folklori apo legjendat *elementet bazë të proceseve teatrale*, si: *aktrimi* (rol, karakteri, sikuri, të besuarit, marrëdhënia me partnerin, veprimi fizik dhe psikik, veprimi me anë të fjalës, veprimi me anë të gjestit, veprimi me mimikë, përqendrimi, të dëgjuarit, të shikuarit etj.), *drama* (subjekti, karakteret, veprimi, dialogu etj.), *shfaqja* (aktorët, spektatorët, hapësira dhe koha skenike, kostumet, muzika etj.).

Niveli bazë

Nxënësit:

- zbatojnë me vështirësi në dramatizime përrallash, poezish, tregimesh, nga folklori apo legjendat, *elementet bazë të proceseve teatrale*, si: *aktrimi* (rol, karakteri, sikuri, të besuarit, marrëdhënia me partnerin, veprimi fizik dhe psikik, veprimi me anë të fjalës, veprimi me anë të gjestit, veprimi me mimikë, përqendrimi, të dëgjuarit, të shikuarit etj.), *drama* (subjekti, karakteret, veprimi, dialogu etj.), *shfaqja* (aktorët, spektatorët, hapësira dhe koha skenike, kostumet, muzika etj.).

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit zbatojnë aftësitë aktruese konkretisht në një përrallë, tregim, histori, përmes elementeve të dramës, si: besimi, koha, roli dhe karakteri, veprimi etj.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve**Niveli i lartë**

Nxënësit:

- zbatojnë në mënyrë të pavarur në dramatizime të ndryshme, konkretisht një monolog, përrallë, tregim, histori *elemente të dramës*, si: besimi, koha, roli dhe karakteri, veprimi etj., vetëm dhe me të tjerë.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- zbatojnë saktë në dramatizime të ndryshme, konkretisht një monolog, përrallë, tregim, histori *elemente të dramës*, si: besimi, koha, roli dhe karakteri, veprimi etj., vetëm dhe me të tjerë.

Niveli bazë

Nxënësit:

- zbatojnë me vështirësi në dramatizime të ndryshme konkretisht një monolog, përrallë, tregim, histori *elemente të dramës*, si: besimi, koha, roli dhe karakteri, veprimi etj., vetëm dhe me të tjerë.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit kuptojnë rolin e teatrit në lidhje me kulturën dhe historinë, përmes veprave teatrale dhe përfaqësuesve të tyre.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- vlerësojnë duke mbajtur një qëndrim të vetin mbi rolin e teatrit dhe zhvillimin e tij në vende dhe kultura të ndryshme dhe përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike;
- krahasojnë në mënyrë të pavarur, një monolog, përrallë, tregim, histori, duke nxjerrë në pah karakteristikat e tyre dhe përdorur saktë një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- vlerësojnë me ndihmën e mësuesit rolin e teatrit dhe zhvillimin e tij në vende dhe kultura të ndryshme dhe përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike;
- krahasojnë me ndihmën e mësuesit një monolog, përrallë, tregim, histori duke nxjerrë në pah karakteristikat e tyre dhe duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike.

Niveli bazë

Nxënësit:

- vlerësojnë me vështirësi rolin e teatrit dhe zhvillimin e tij në vende dhe kultura të ndryshme;
- krahasojnë me vështirësi një monolog, përrallë, tregim, histori dhe nxjerrin në pah ndonjë karakteristikë të tyre.

LINJA 2: Krijojmë dhe bashkëpunojmë përmes teatrit

Standardi i të nxënit 1

Nxënësit zotërojnë vetveten kur përballen me publikun, duke rritur vetëbesimin.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- zotërojnë të gjitha aftësitë të ndërgjegjësohen për rolin shumë të madh që luan të qenit i lirshëm në proceset krijuese, dhe përballjes me publikun duke rritur vetëbesimin.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- zotërojnë disa aftësi për t'u ndërgjegjësuar ndaj rolit shumë të madh që luan të qenit i lirshëm në proceset krijuese, dhe përballjes me publikun duke rritur vetëbesimin.

Niveli bazë

Nxënësit:

- zotërojnë pak aftësi për t'u ndërgjegjësuar ndaj rolit shumë të madh që luan të qenit i lirshëm në proceset krijuese dhe përballjes me publikun, duke rritur vetëbesimin.

Standardi i të nxënit 2

Nxënësit zbatojnë aftësitë krijuese për të realizuar një pjesë të thjeshtë dramatike.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve

Niveli i lartë

Nxënësit:

- zhvillojnë me lirshmëri marrëdhënie imagjinare, nëpërmjet veprimit të ndërsjellë me karakteret e tjera në skenë, në grupe të vogla ose në të gjithë klasën;
- luajnë me lirshmëri, sa herë t'u kërkohet, për partnerët, në një skenë që është krijuar në punë paralele me grupe të vogla;
- luajnë në mënyrë spontane për partnerët e tjerë në grup një skenë nga dramatizimi ose ndajnë, me pjesën tjetër të klasës, një skenë që është krijuar në punën paralele në grupe të vogla.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- zhvillojnë me ndihmën e mësuesit marrëdhënie imagjinare nëpërmjet veprimit të ndërsjellë me karakteret e tjera në skena me grupe të vogla ose në të gjithë klasën;
- luajnë sa herë t'u kërkohet për partnerët në një skenë që është krijuar në punë paralele me grupe të vogla;
- luajnë me ndihmë me partnerët e tjerë në grup një skenë nga dramatizimi ose të ndajnë me pjesën tjetër të klasës një skenë, që është krijuar tashmë në punën paralele në grupe të vogla.

Niveli bazë

Nxënësit:

- zhvillojnë me vështirësi marrëdhënie imagjinare nëpërmjet veprimit të ndërsjellë me karakteret e tjera në skena me grupe të vogla ose në të gjithë klasën;
- luajnë me vështirësi sa herë t'u kërkohet për partnerët në një skenë që është krijuar në punë paralele me grupe të vogla;
- luajnë me vështirësi me partnerët e tjerë në grup një skenë nga dramatizimi ose të ndajnë me pjesën tjetër të klasës një skenë, që është krijuar tashmë në punën paralele në grupe të vogla.

Standardi i të nxënit 3

Nxënësit bashkëpunojnë me njëri - tjetrin gjatë aktrimit të një vepre dramatike.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve*Niveli i lartë*

Nxënësit:

- zotërojnë të gjitha aftësitë për bashkëpunim në krijimin e materialeve dramatike të kërkuara për t'u realizuar në grupe të vogla apo si klasë si nëpërmjet rolit të gjithsecilit, ashtu edhe jashtë rolit;
- zhvillojnë të gjitha aftësitë e tyre, pavarësisht nga roli që kanë në një dramatizim, të komunikojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët për të ndihmuar në formësimin e materialit skenik ose në procesin e dramatizimit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- zotërojnë disa aftësi për bashkëpunim në krijimin e materialeve dramatike të kërkuara për t'u realizuar në grupe të vogla apo si klasë si nëpërmjet rolit të gjithsecilit, ashtu edhe jashtë rolit;
- zhvillojnë disa aftësi, pavarësisht nga roli që kanë në një dramatizim, të komunikojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët për të ndihmuar në formësimin e materialit skenik ose në procesin e dramatizimit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- zotërojnë pak aftësi për bashkëpunim në krijimin e materialeve dramatike të kërkuara për t'u realizuar në grupe të vogla apo si klasë si nëpërmjet rolit të gjithsecilit, ashtu edhe jashtë rolit;
- zhvillojnë disi aftësitë e tyre, pavarësisht nga roli që kanë në një dramatizim, të komunikojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët për të ndihmuar në formësimin e materialit skenik ose në procesin e dramatizimit.

LINJA 3: Reflektojmë përmes teatrit**Standardi i të nxënit 1**

Nxënësit analizojnë dhe mbajnë qëndrim kritik ndaj krijimeve dramaturgjike (të vetat ose të të tjerëve) bazuar në aftësitë e tyre.

Përshkrimi i niveleve të arritjeve***Niveli i lartë***

Nxënësit:

- analizojnë gjatë diskutimeve të hapura në mënyrë të pavarur përdorimin e elementeve dramatike gjatë një shfaqjeje, duke argumentuar qëndrimin e tyre;
- zhvillojnë ide mbi ecurinë e tyre artistike në këtë fushë, gjë që do t'i motivojë ata për t'u përfshirë në mënyrë aktive në jetën shoqërore, artistike dhe kulturore të shkollës apo dhe të komunitetit.

Niveli mesatar

Nxënësit:

- shpjegojnë me ndihmë gjatë diskutimeve të hapura, përdorimin e elementeve dramatike në një shfaqjeje, duke shpjeguar qëndrimin e tyre;
- zhvillojnë disa ide mbi ecurinë e tyre artistike në këtë fushë, gjë që mund t'i motivojë ata për t'u përfshirë në mënyrë aktive në jetën shoqërore, artistike dhe kulturore të shkollës apo dhe të komunitetit.

Niveli bazë

Nxënësit:

- përshkruajnë me vështirësi gjatë diskutimeve të hapura, përdorimin e elementeve dramatike në një shfaqjeje, duke shprehur qëndrimin e tyre;
- zhvillojnë disa ide mbi ecurinë e tyre artistike, në këtë fushë, gjë që mund t'i motivojë ata për t'u përfshirë në mënyrë aktive në jetën shoqërore, artistike dhe kulturore të shkollës apo edhe të komunitetit.